

Mehmet Bislimi, mendoj unë se, nuk ka hapur thjesht vetëm një portë. Unë mendoj se ai ka hapur njëkohsisht disa porta. Po ashtu ai ka bërë edhe një punë tjetër: ka biografizuar jetën dhe luftën e një njeriu, duke dhënë një vepër të dobishme. Më tej se kaq: një vepër të nevojshme. Edhe më tej: një vepër e cila ka qenë e domosdoshme të shkruhet. Fakti që ajo del në dritë në 23 vjetorin e rënies së Tahir Mehës, nuk do të thotë se ajo nuk ka qenë e punuar prej kohësh në mendimin e autorit. Do të thotë se mosngutja e deritanishme ka bërë që të kemi një libër të mirë, i cili, në se kthehem në fillimin e idesë sime, ka hapur disa porta.

Bedri ISLAMI – publicist



Mehmet Bislimi

Mehmet Bislimi, publicist dhe poet nga Prekazi, i burgosur dhe i përndjekur politik emigroi në Zvicër më 1994. Deri më tani ka botuar:

1. *"Anekdota popullore dhe satira autoriale"*, Prishtinë 2002
 2. *"Trëndafila maji"*, Prishtinë 2002
 3. *"Fjalë dhe gurë"*, Prishtinë 2003
- "Këtu i thonë Drenicë"* është libri i tij i katërt.

Mehmet Bislimi

KËTU I THONË DRENICË

Tahir Meha – Monografi



Mehmet Bislimi

Këtu i thonë Drenicë

Tahir Meha – Monografi

Mehmet Bislimi
KËTU I THONË DRENICË
Tahir Meha – Monografi

Mehmet Bislimi

Këtu i thonë Drenicë
Tahir Meha – Monografi

Redaktor:

Kadri REXHA

Lektor:

Avni DEHARI

Desing & Layout

Adnan ASLLANI

Përkujdesja për botim:

Shoqata Kulturore Shqiptare "Mëmëdheu"
St. Gallen – Zvicër

Botues:

MKRSDÇJ

- Departamenti i Çështjeve Jorezidente i Kosovës

U shtyp në shtypshkronjën
"Shkrola" – Prishtinë

Copyright © 2004

Autori & botuesi

Mehmet Bislimi

KËTU I THONË
DRENICË

Tahir Meha – Monografi

Prishtinë, 2004

*Jeta e një populli ka kuptim
vetëm duke qenë i lirë.
E tërë filozofia e të qenit të
lirë, s'është asgjë tjetër përveç
guximit dhe vendosmërisë për
t'iu kundërvënë pushtuesit!*

Autori

MEHMET BISLIMI HAP PORTAT E BIOGRAFISË SË TAHIR MEHËS

Në fillim të librit të tij të ri "Këtu i thonë Drenicë" publicisti i njohur Mehmet Bislimi, në mënyrë tepër modeste, thotë se me këtë libër nuk ka dashur të bëjë asgjë tjetër, veçse të hapë portat për biografinë e një njeriu të rrallë, trimërisht i lartësuar dhe mrekullisht i njohur, Tahir Meha. Me synimin për të parë pikërisht këtë fakt, "hapjen e portës" për biografinë e një njeriu të njohur, u nisa ta lexoj këtë monografi, e cila tashmë gjendet në duart e lexuesit. Më shtynte gjithnjë ideja për të ditur më shumë për jetën e një njeriu, për të cilin, si çdo shqiptar, kisha dëgjuar shumë herë. Mbi të gjitha kisha dëgjuar për aktin e tij të qendresës së 13 majit të vitit 1981, si njëri ndër epilogët e demonstratave të mëdha të pranverës së këtij viti. Kisha dëgjuar për luftën që ishte bërë atë ditë, në gjurmët e një beteje tjetër të njohur, të Ahmet Delisë, ashtu si do të dëgjonim më pas e do të mburreshim përjetë, me qëndresën e fisit të jashtëzakonshëm Jashari, të komandantit të përgjithshëm të UÇK-së, Adem Jasharit.

Njeriu mund t'i hapë portat e një biografie gjithsesi. Mund t'i hapë në një mënyrë që "portat" të duken të shqyera, pra të

përçudnohet historia; mund t'i hapë "portat" nga vetja, ku autori të jetë më i merituar se sa njeriu për të cilin shkruhet, mund t'i hapë "portat" në mënyrë spekulative, duke i veshur fakte e ngjarje që nuk kanë ndodhur, si kemi lexuar në ndonjë biografi të kohëve të fundit.

E kisha kureshtjen për të ditur hapjen e portës për biografinë e një njeriu, i cili ndërsa kishte përmasat e një miti, nuk kishte ende një libër për të; i cili, megjithëse gjendej në dhjetëra e qindra faqe të dosjeve sekrete të zbulimit të fshehtë jugosllav e serb, përsëri nuk ishte i dritëzuar në historinë e popullit të tij; i cili, megjithëse kishte këngët e tij dhe populli nuk i fal aq bujarisht këngët, përsëri mungonte në shtjellimin e plotë të së vërtetës. E kisha menduar këtë, sepse të bësh një akt si ai i 13 majit të vitit 1981, të të rrethojë ushtria serbe që në orët e para të mëngjesit (rrethimi ka filluar në orën 01), të të krijohet një qark rrethues prej disa brezash etj. , jo vetëm që nuk është e rastësishme, por donte të thoshte se njeriu i rrethuar ishte bërë tashmë rrezikshmëri për sistemin, dhunën, shtypjen, vrasjet, mjerimin; donte të thoshte se njeriu, që kishte emrin Tahir Meha, kishte filluar të bëhej një shpresë, një thirrje, një rrugë që duhej ndjekur. Kjo rrugë ishte e rrezikshme, sepse ishte e papërfytyrueshme që forcat e sigurimit serbo-jugosllav të bëjnë gjithë këtë rrethim, në të cilin vriten më shumë se dhjetë milicë, plagosen më shumë se dyfishi i të vrarëve etj. , vetëm se ashtu paskan menduar të bëjnë terror.

Normalisht shërbimi i fshehtë serb, UDB-ja, e kanë pasë studiuar mirë objektin e goditjes së tyre, për t'i dhënë mësim të tjerëve dhe për të shuar çdo vatër rezistence. Nëse ndodhi e kundërta, nëse flakët e rezistencës u rritën, kjo është në nderin e bijve të Drenicës, të cilës i takonte edhe Tahir Meha, edhe i

ati i tij Nebih Meha, të cilës do t'i takojë edhe dëshmori i mëvonshëm Beqir Meha, vllai i Tahirrit.

Mehmet Bislimi, mendoj unë se, nuk ka hapur thjesht vetëm një portë. Unë mendoj se ai ka hapur njëkohsisht disa porta. Po ashtu ai ka bërë edhe një punë tjetër: ka biografizuar jetën dhe luftën e një njeriu, duke dhënë një vepër të dobishme. Më tej se kaq: një vepër të nevojshme. Edhe më tej: një vepër e cila ka qenë e domosdoshme të shkruhet. Fakti që ajo del në dritë në 23 vjetorin e rënies së Tahir Mehës, nuk do të thotë se ajo nuk ka qenë e punuar prej kohësh në mendimin e autorit. Do të thotë se mosngutja e deritanishme ka bërë që të kemi një libër të mirë, i cili, në se kthehem në fillimin e idesë sime, ka hapur disa porta.

Mehmet Bislimi është drenicak, kjo do të thotë se ai e njeh mirë Drenicën. Ai ka bërë të ditur pjesë të historisë së saj, histori përmes së cilës ka kaluar edhe Tahir Meha. Duke i treguar lidhjet fisnore të Tahir Mehës, autori e ka parë të arsyeshme, dhe mirë ka bërë, që gjeografinë e trimërisë drenicake ta shtrijë përtej vatrës ku ka lindur Tahir Meha, përtej cakut të fisit të tij, duke e bërë kështu një simbol të një populli të përvuajtur, mrekullisht luftëtar.

Mehmet Bislimi është njëri ndër veprimtarët e hershëm të çështjes kombëtare. Me aq sa di unë, ai ka më shumë se 25 vite që është përfshirë në këtë përkushtim. Kjo do të thotë se më shumë se gjysmën e jetës së tij ai e ka bërë me idenë se duhet bërë më shumë për lirinë e Kosovës. Duke qenë kështu ai i ka njohur mirë rrethanat në të cilat janë zhvilluar ngjarjet ilegale në Drenicë, apo më gjerë se kaq, ka sjellë fakte të reja për fillesat e kësaj lëvizjeje apo për përmasat që mori ajo. Duke qenë i tillë, ai e ka njohur nga afër Tahir Mehën, familjen e tij, ka

qëndruar në të njëjtën qeli burgu me vllanë e Tahirit, dëshmorin e kombit Beqir Meha, e kjo do të thotë se jo rrallëherë, kujtimet e tij janë autentike. Ai ka mundur t'i shmanget "unit" që mund të dëmtojë një histori biografike, por nga ana tjetër, herë pas here, me stilin e thjeshtë rrëfyes, përzier me humorin që e ka edhe në jetën e përditshme, e bën historinë më të saktë, më bindëse e njëkohsisht më jetësore.

Mehmet Bislimi e shkruan këtë libër kur ka kaluar një kohë, disi e gjatë, pas ngjarjes së 13 majit të vitit 1981. Do të ishte dashur ta bënte më herët, por edhe kjo e ka të mirën e saj. Në këtë kohë ai është njohur me të verteta të reja, me fragmente të dosjes së Tahir Mehës në organet e sigurimit të fshehtë serb, ndonëse jo plotësisht dhe kjo duhet bërë sa më parë. Ka pasur kohën e duhur të gjejë fakte të reja që nuk janë ditur deri më tash, të bëjë analizën krahasuese të ngjarjeve, për të arritur në përfundimin e saktë se Tahir Meha nuk ishte një fragment i veçantë i lëvizjes ilegale çlirimtare të Kosovës, se ai ishte produkt i kësaj lëvizjeje dhe i vendit ku kishte lindur, të cilin po ashtu nuk e idealizon.

Tahir Meha e dinte se në rast lufte, Drenica do ta mbështeste. Herët a vonë kjo do të ndodhte. Ai, po ashtu e dinte, se do të kishte mes bijve të vendit të tij edhe plangprishës. Të dyja përdallimet e Tahir Mehës do të shfaqeshin gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe nëse përmasat e kësaj lufte do të ishin krejt të jashtëzakonshme, kjo do të kishte lidhje edhe me vizionin e Tahir Mehës për lirinë e atdheut të tij.

Shkrimi i biografisë së një njeriu të njohur, aq më shumë i një njeriu si Tahir Meha, ka vështërsitë e veta. Disa prej tyre janë, shpeshherë, të pashmangshme, sidomos kur ende shumë dosje janë pas një mijë çelësave. Mehmet Bislimi ka bërë të

gjitha përpjekjet që përmes grumbullimit të materialit të futet përmes këtyre vështirësive, dhe nëse ndonjëherë nuk ia ka arritur, kjo ka ardhur më shumë nga mungesa e informacionit të fshehtë. Kjo edhe është e kuptueshme.

Narracioni i librit "Këtu i thonë Drenicë" është i thjeshtë, kjo do të thotë se është i bukur. Megjithëse Mehmet Bislimi është poet, ai nuk e ka futur në këtë libër përdorimin poetik të fjalëve dhe të fjalive, nuk ka rendur pas gjetjeve poetike, por ka dëshmuar thjeshtë, në një ndërtim tradicional të biografive, jetën e një martiri, si ishte Tahir Meha. Ndoshta kjo do ta bëjë librin më interesant.

Përshtetshëm do të isha për një ndërthurje, disi më dramatike, duke shkuar disi tej asaj që është e përhershme në biografitë e një njeriu, por kjo nuk e zbeh librin. Një dëshirë e dikujt është vetëm një dëshirë, secili e sheh vetë rrugën që do të bëjë në përshkrimin e jetës së një heroji. Mehmet Bislimi e ka parë në këtë mënyrë, por dramatikja është ruajtur deri në fund. Dhe kjo i bën mirë librit të tij. Mehmet Bislimi i hapi portat për jetën e Tahir Mehës. Pra, ka hapur shumë porta. Duhej një libër i tillë. Dhe ky libër tashti erdhi. Është i mirëseardhur.

Bedri ISLAMI – publicist

NJË BORXH I KAHMOTSHËM

(*Fjala e redaktorit*)

Emri i martirit Tahir Meha opinionit shqiptar dhe më gjerë iu bë i njohur me 13 maj 1981, datë që shënonte ditën e forcave të milicisë famëkeqe jugosllave. Asokohe Kosova vlonte nga demonstratat mbarëpopullore që e kishin goditur për vdekje Jugosllavinë. Masat që kishte ndërmarrë pushtuesi kundër demonstruesve dhe diferencimet ishin të paefektshme. Zëmërimi i Kosovës sa vinte e rritej. Ndaj, shteti, për ta frikësuar një popull të tërë, me qëllim nënshtrimi, e ngriti në ligj dhe aplikoi metodën e shfarosjes së familjeve të shquara shqiptare. Si fillim i fushatës u zgjodh Drenica kryengritëse dhe pikërisht Prekazi heroik. Pra, në datën e cekur më sipër, forca të shumta të milicisë dhe të ushtrisë e rrethojnë shumëfish kullën e Nebih Mehës mbi të cilën Sërbia e derdhi tërë mllefin dhe urrejtjen shovene përmes zjarrit, hekurit dhe barotit. Tahir Meha me të atin plak, Nebihun, si dhe me mbarë familjen qëndruan dhe luftuan deri në flijim, duke e kthyer kullën e tyre në një kala të pamposhtur, në një mit modern. Menjëherë pas kësaj tragjedie të rëndë, shtypi dhe mjetet elektronike të Beogradit, si dhe ato të pushtetit vazal në Kosovë, Tahir Mehën e shpallën terrorist, ndërsa TV Shqiptar, Radio Tirana, gazetatat: "Zëri i Popullit",

"Zëri i Kosovës" dhe shtypi revolucionar i kohës, Tahir Mehën, fshatarin e përvojatur të Prekazit, e ngritën në nivelin e heroit.

Nga dita e rënies heroike e deri me sot, pothuajse një çerek shekulli, emri dhe vepra e Tahir Mehës, jo vetëm u mbajtën gjallë në zemrën e kombit shqiptar, por ata u bënë edhe gurrë e pashtershme frymëzimi dhe shembull i lartë vetëmohimi për rininë tonë liridashëse. Në ruajtjen e emrit, veprës dhe të kujtimit të Tahir Mehës rol të madh ka luajtur edhe muza popullore, vlerësuesja e pagabueshme e moralit të shpirtit kombëtar. Në këto dhjetë vitet e fundit, në shtypin shqiptar, emri i Tahir Mehës dhe i familjes së tij, është zënë në gojë sipërfaqësisht, sa për të thënë diçka, por a është e mjaftueshme vetëm kaq?

Nxënësit, studentët dhe mbarë populli kërkojnë të dinë më tepër për rrënjët, jetën, edukimin dhe veprën e Tahir Mehës. Një punë të këtyllë ia kemi borxh martirit që ra për të mos rënë Kosova në ditët e veta më të rënda. Prandaj libri monografik: "Këtu i thonë Drenicë" për Tahir Mehën, që po i afrohet lexuesit, besoj se e lanë këtë borxh të kahmotshëm, si ndaj heroit ashtu edhe ndaj lexuesit. Libri vjen nga autori Mehmet Bislimi, veprimtar i orëve të para, poet e publicist, militant si dhe bashkfshatar i heroit. Pra, Mehmet Bislimi jo vetëm e ka njohur Tahir Mehën si një person të fshatit të lindjes së tij, por ai heroin e ka prekur nga afër, si në kohëra të mira ashtu edhe në kohëra të liga dhe, ndonëse jo moshatarë, të lidhur rreth një ideali, vazhdimisht së bashku i kanë qarë hallët e Kosovës së robëruar. Vlerë tjetër e këtij libri është puna dhe serioziteti i autorit për ta dhënë sa më besnikërisht figurën e Tahir Mehës. Libri për jetën dhe veprën e Tahir Mehës i autorit Mehmet Bislimi i plotëson të gjitha elementet që i duhen shkrimit të një monografie të mirëfilltë. Prandaj përgëzoj autorin për punën e tij.

Kadri REXHA-lettrar

NË VEND TË HYRJES

Në luftë për liri kombëtare nder shekuj, luftetarët tanë u shquan duke bërë sakrificat më sublimë, duke dhënë shembullin e sprovës së madhe në shërbim të atdheut. Ata me guximin, treguan shpirtin e tyre human dhe para vetës vunë çështjen e përgjithshme të kombit, duke u flijuar në altarin e lirisë.

Populli ynë nëpër shekuj u përgjak, por krenarinë kombëtare e ruajti me fanatizëm. Ai edhe sot i ruan të gjalla kujtimet për bijtë e vet më të mirë, futur thellë në gjirin e historisë sonë të re e të vjetër. Heronjtë tanë, me aktin e tyre të guximshëm u bënë udhërrefyes për brezin e ri. Ata mahnitën bashkëkombësit e vet në kohë dhe hapësirë, por edhe të tjerët me përkushtimin e tyre ndaj çështjes sonë të pazgjidhur. I tillë ishte edhe Tahir Meha, i cili me qëndresën e vet edhe sot i vë në dilemë shumë strateg të artit ushtarak, për shkak të rezistencës, që e bëri kundër një makinerie policoro-ushtarake të ish- Jugosllavisë.

Tahir Meha e përgjaku 13 majin, ditën e organeve të shërbimit të sigurimit të Jugosllavisë, pjesëtarët e së cilës në Prekaz lanë kokën e vet, për më keq „famën" e njësitit special rënë përtokë!

Me 13 maj 1981 ndërmjet aparatit shtypës të atij pushteti dhe popullit shqiptar, krisi pushka e parë pas një pushimi më shumë se tridhjetëvjeçarë, pra që nga rënia e Ymer Berishës me 1949. Kjo pushkë foli shumë për ata që e kuptuan, duke i dhënë edhe rezultatet e saj të para për ata që punuan në këtë drejtim, frytet e së cilës po i prekim e përjetojmë ne sot.

Megjithëse rrugët e lirisë në Kosovën e sotme, ende janë të padefinuara, të gjithë ata që ranë për këtë qëllim, popullin tonë e futën në rrugët e lavdishme, në rrugët e pakthimta drejt lirisë e cila do shtypte të fortë edhe më, për të mos e mohuar gjakun e dëshmorëve tanë e së bashku me ta edhe gjakun e Tahir e Nebih Mehës, martirë të lirisë.

Tahir Meha ne mesin e atyre që ranë për atdhe, nuk kishte ndonjë emër të veçantë. Ai as që kishte punuar për të pasur emër-ngase ishte trashëgimtar i drejtpëdrejtë i familjes së Emin Latit-bashkëluftetarit të denjë të Azem Bejtë-Galicës. Përkundrazi, ai e kishte për detyrë që ta ruante emrin e madh të Emin Latit-Mehës, duke e bërë atë edhe më të ndritur me aktin e rezistencës së tij. Tahir kishte dëgjuar shumë për luftërat e Azem Galicës nga gjyshi i tij dhe nga babai i tij, pastaj nga Bajram Zena, Xhemë Ternavci etj. Tahiri për luftën e kaçakëve kishte dëgjuar si të thuash nga dora e parë e bashkëluftëtarëve të Azem Galicës.

Tahiri ishte brezi i tretë pas Eminit e Nebihut, që pushkën nuk ia ndanë pushtuesit serbosllav gjatë tërë shekullit të njëzetë. Kjo familje këtë e dëshmoi edhe në luftën e fundit që u zhvillua në Kosovë, me ç'rast ra dëshmor edhe i vëllai i Tahirit, Beqir Meha.

Pa dyshim se në vitin 1981 ishin demonstratat e fuqishme të asaj pranvere që i dhanë grushtin vendimtar ish-Jugosllavisë

e cila më nuk u ribë. Edhe atë ish-Jugosllavi Millosheviqiane që më pas qarqet shoviniste serbe tentuan ta mbajnë artificialisht të gjallë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës e vrau me pushkën e lirisë.

Tahiri, në mënyrë shëmbullore e njëjtte jetën e Kaçakut, ngase e kishte mësuar shumë mirë nga gjyshi i tij Emmini. Atë e kërkonte pushtuesi për ta burgosur, ngase i kishte kthyer pushkën dhe nuk po i bindej, që të jetonte si rob. Rezistenca e Tahir Mehës është e lidhur pazgjidhshmërisht me përpjekjet e pareshtura të popullit tonë për liri. Akti i rëniës së tij s'është asgjë më shumë se sa finalizim i këtij misioni i cili po bënte dritë në atë shtegrrugë të nisur kaherë. Tahiri me aktin e rezistencës së tij përshejtoi lëvizjen e proceseve kombëtare duke qenë vet në rend të parë si shembulli më unikat.

Pushka e Tahirit, është pushka e parë lajmëtare e cila u drejtua nga një atdhetar i thjeshtë i Prekazit kunder ish-Jugosllavisë titiste. Kjo pushkë përgjaku 13 majin e vitit 1981, duke e goditur pushtuesin jugosllav në shtat, në mënyrë që nga ky moment shqiptarët të mendojnë dhe të veprojnë për t'i bashkuar mendjet dhe pushkët e tyre për të ecur përpara.

Me këtë monografi për jetën dhe veprën e Tahir Mehës, nuk pretendoj se i kam thënë të gjitha, as që i kam mbyllur portat për një studim tjetër më shkencor e më të arrirë për Tahirin. Përkundrazi, mendoj se kam hapur porta për të trokitur në derën e kullës- legjendë të veprës së madhe të Tahir Mehës.

E ndiej se e kam pasur borxh për ta shkruar këtë monografi, ngase veç të tjerash Tahir Mehën e kam njohur personalisht, që nga rinia ime e hershme. E kam shërbyer me dhjetëra herë me kafe e çaj në kullën tonë të dikurshme, kur ai me babë Nebihun dhe me të vëllanë Beqirin na vizitonin shpesh.

Kam dëgjuar sa e sa herë prej tij për domosdoshmërinë e rezistencës kundër këtij pushtuesi barbar. Kam dëgjuar prej tij sa e sa herë edhe romuze të këndshme, por edhe betimin që e kishte bërë që të mos dorëzohej i gjallë. Pamja e tij burrërore, veshja e tij pedante, natyra e butë e plot humor, pa dyshim edhe përsosmëria e tij në përdorimin e fjalës dhe armës ishin veçori dhe shkathtësi të veçanta që ai i posedonte. Ai e kishte edhe një të ndenjtur të veçantë këmbëkryqi, tërë krenari me duart mbi gjunjë, me kafënë që e vinte në maje të gjurit, me revolën përpara dhe bombat për rreth saj. Ai kishte një dashuri të veçantë për armët, dhe të veçanta i gjente ato. "Si armët e Tahirit ma!" – thoshin bashkëmoshatarët e tij. Tahiri kishte një fytyrë të pastër me flokë të krehur me kujdes dhe të kthyer mbrapa. Kishte një zë të trashë burri dhe herë-herë kollitej, më tepër, për ta shprehur krenarinë e tij. Tahiri atë që e thoshte edhe e bënte. Ndaj e kisha si një barrë mbi supe që me duhej ta zbrazja në letër, e kisha si një borxh që me duhej ta përmbushja para personalitetit të tij. Ai sa herë na thoshte: "Djema, kur të luftoj unë do të shkruajnë gazetat!" E ndiej për obligim që t'i falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan duke kontribuar, me kujtimet, me të dhënat e tyre, që ishin të panjohura deri tani dhe me mendimet e tyre të vlefshme për të bërë një punë kaq të vogël e modeste, siç është ky libër imi, krahasuar me veprën e madhe të Tahir Mehës që e bëri për ne dhe për popullin shqiptar në përgjithësi.

Zvicër, mars 2004

Autori

VËSHTRIM HISTORIK

Në mesin e viteve të '70 shek. XIX, Perandoria Osmane kishte rënë në krizë të thellë ekonomike dhe politike, duke mbetur shumë mbrapa Evropës, si pasojë e qeverisjes me metoda të stërvjetëruara anadollake. Shtypja që po ushtronte kjo perandori po rritej për ditë e më shumë përballë popujve të tjerë të cilët ishin me vite nën pushtimin osman. Njëkohësisht kjo shtypje, ky shfrytëzim i egër me taksa e xhelep po jepte shenjat e pashmangshme të një kryengritjeje të popujve të Ballkanit. Në këtë vazhdë edhe në trevat shqiptare po ziente vullneti i ndrydhur i lirisë që priste të shperthente gjithandej tokave shqiptare si në Korçë e Gjirokastrë, Mirditë e Dukagjin, Malësi e Drenicë, Llap e Kaçanik etj.


Në korrik të vitit 1876 Serbia dhe Mali i Zi, të përkrahura nga Rusia, i shpallën luftë Turqisë, por pas një rezistence të vogël, Turqia i theu keq këto përpjekje të serbo-malazezve. Ngase të përkëdhelurit e Rusisë humbën, në prill të vitit 1877, Rusia i shpalli luftë Turqisë. Përderisa ushtria osmane po pësonte humbje të mëdha nga forcat ruse, si dhe nga rreziku permanent që po e humbiste edhe Stambollin, Porta e Lartë kërkoi armëpushim. Si pasojë e kësaj në Shën-Stefan u bë një lloj paqeje

në fillim të marsit të vitit 1878, ku Serbia, Mali i Zi dhe Rumania do të njiheshin si shtete, nderkaq Bullgaria do të shpallej autonomi, nën sovranitetin e Perandorisë Osmane. Traktati i Shën-Stefanit jo vetëm që Shqipërinë e la nën sundimin turk, por edhe e cungoi shumë rëndë territorin e saj në favor të Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Në këto rethana një grup patriotësh shqiptarë që po vepronin në Stamboll me 1877, formuan "Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Popullit Shqiptar". Aty ishin bashkuar patriotët e kohës, si: Abdyl Frashëri, Vaso Pasha, Sami Frashëri, Jani Vreto, Zija Prishtina etj. Ata nxorën një memorandum duke ia drejtuar Fuqive të Mëdha, për t'i bërë të ditur botës së aspirata e popullit shqiptar është njohja e tij si një popull i bashkuar, mosprekja e tokave dhe kufijve të tij dhe njohja e tij nën një administratë autonome shqiptare. Me dhjetëra patriot të shquar të kombit përgatitën terrenin nëpër krahina të vendit tonë për të organizuar më mirë këtë lëvizje e cila pas pak u vendos me qendër në Prizren me emrin "Lidhja e Prizrenit". Lidhja e Prizrenit gjatë formësimit të saj, formuloi programin politik e kombëtar, pastaj ngriti nëpër të gjithë vendin organizmat e saj drejtues politikë e ushtarakë për realizimin e programit kombëtar.

Si duket me Traktatin e Shën-Stefanit Fuqitë e Mëdha u frikësuan nga zgjerimi i mundshëm i Ruisë në Evropë, prandaj nën presionin e Anglisë dhe të Austro-Hungarisë Rusia u tremb dhe pranoi të ulet në bisedime në Kongresin e Berlinit (më 13 qershor 1878). Evropa dhe fuqitë vendimmarrëse me padrejtësitë e tyre që i bënë ndaj shqiptarëve i dëmtuan edhe më tokat shqiptare duke e shtyrë popullin tonë në përgjakje të pareshtur. Si i tillë ky popull u detyrua pashmangshëm që të mbrohej nga pushtuesit e shumtë. Pasiqë fuqitë e mëdha bënë padrejtësinë

më të madhe të mundshme në historinë e njerëzimit, në dëm të shqiptarëve, ne u detyruam të mbrohemi, në rend të parë si qenie e më pas edhe si komb. Menjëherë pas Kongresit të Berlinit, Konferencës së Ambasadorëve, si dhe më vonë Traktatit të Fshehtë të Londrës, Serbisë iu dha drita jeshile dhe kjo e fundit tani më kishte bërë planet dhe elaboratet, për shpernguljen me dhunë dhe asgjësimin e shqiptarëve nga tokat e veta! Mu në janar të vitit 1913, xhandarmëria e Serbisë, filloi një dhunë të padurueshme mbi shumë vise shqiptare, pra në të njëjtën kohë edhe në Prekaz të Drenicës.



Ahmet Delia

1850-1913

Atdhetar i shquar, tribun popullor që gëzonte autoritet. Udhëheqës i Kuvendit Popullor që u mbajt në Morinë të Drenicës në mars të vitit 1903, ku moren pjesë mbi 5000 burra të të gjitha viseve shqiptare. Aty u vendos dhe u lidh besa për të mos u nënshtruar para pushtuesit. Ahmet Delia ra heroikisht në Prekaz të Drenicës në shkurt të vitit 1913 në përleshje me forcat shoviniste të xhandarmerisë serbo-malazeze.


Përleshja e përgjakshme që u bë në Prekaz ndërmejt bandave të xhandarmërisë serbe dhe bashkëluftëtarëve të Ahmet Delisë (shkurt 1913), shënoi fillimin e pakënaqësive të shqiptarëve (për padrejtësitë që Evropa i bëri ndaj tyre). Me këtë rast, botës së civilizuar, shqiptarët i treguan se nuk do t'i njohin as edhe një herë kongreset e ndryshme të cilat ndanë tokat tona sipas shijeve të shteteve grabitqare fqinje. Evropa, në fakt, nuk e dëgjoji zërin e shqiptarëve për një shekull të tërë lufte e përgjakje, dëbimi e dhunimi, burgosje e izolimi, djegie e masakrimi që Serbia i ushtroi mbi popullin tonë! Mirëpo, Prekazi që ndodhet në zemër të Kosovës, i tregoi botës se sëpata e Ahmet Delisë do të godasë pa mëshirë çdo marrëveshje që do të bëhet në dëm të shqiptarëve. Që nga rënia e Ahmet Delisë e deri të rënia e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari ka një lidhje. Kjo lidhje gati njëshekullore është ajo që e mbajti gjallë frymen tonë kombëtare. Tahir Meha duke i dëgjuar këto gjëra si: historirat dhe bëmat për Ahmet Delinë, për Shaqir Smakën, Azem Bejtën, Mehmet Delinë, Emin Latin, Bajram Zenën, pastaj për shumë trima të kohës si ata të Lidhjes së Prizrenit e deri tek Shaban Polluzha e Mehmet Gradica, kishte gjetur frymzim dhe qëllimin e rrugës së tij prej patrioti. Kishte gjetur rrugën e tij prej guximtari, që në momentin e duhur të jepte gjithçka prej vetes në shërbim të atdheut e të shoqërisë në përgjithësi, duke u bërë shembull i flijimit për brezat që do të pasojnë, gjithnjë drejt shtigjeve të lirisë së atdheut tonë të dashur.

DRENICA DHE BIJTË E SAJ

Në pjesën qendrore të Kosovës shtrihet krahina gjeografike dhe etnografike e Drenicës, e cila në antikën e largët, quhej Klapotnik. Në zemër të Drenicës shtrihet Prekazi-fshati i qëndresës dhe i rezistencës shekullore kundër pushtuesve të atdheut tonë.

Drenica shtrihet ndërmjet Fushë-Kosovës në lindje, Rrafshit të Dukagjinit në perëndim, Goleshit dhe të maleve të Carralevës në jug dhe malit Mokna në veri. Ka një reliev kodrinoro-malor. Mali më i lart i saj është Qyqavica, me një lartësi mbidetare prej 1091 m. Drenica në gjirin e saj përfshinë mbi 90-të fshatra dhe përbëhet nga dy pjesë: nga Drenica e Epërme dhe nga ajo e Poshtme, të cilat administrohen nga dy prefektura: nga ajo e Skënderajt dhe nga ajo e Drenasit.

Në Drenicën e Epërme ose të Kuqe, shtrihet Prekazi, vendlindja e Ahmet Delisë, e Tahir Mehës dhe e Adem Jasharit. Ky fshat njihet që nga kohërat e lashta. Të parët e Prekazit rrjedhin ose thirreshin si lozë e rrënjës së Prekajve, pra: Prenë-Prenkë-Prekë-Pre-ka-z. Edhe sot në Prekaz, duken qartë shenjat e dy varrezave të të parëve të Prekazit: ai i Prekës dhe i Lenës (shoqës së tij). Këto dy varreza gjenden në vendin e quajtur



Shaban, Hamzë dhe Adem Jashari

"Otava", në një skaj të një are. Prekazin si emër të shkruar në letra për herë të parë e hasim në dokumentet turke në vitin 1435. Aty thuhet se është "një fshat me popullatë të paktë, por të pabindur e të rebeluar ndaj urdhërave të sulltani" . Ky është Prekazi ku u lind dhe u rrit martiri i kombit Tahir Meha.

Që nga rezistenca e prekzasve, të cilëve u printe stërgjyshi i Adem Jasharit (Murat Jashari), kundër hordhive turke e deri më sot Prekazi e Drenica kanë dhënë shumë për shqiptarinë. Ndër ta edhe Ahmet Delia, bashkëpunëtor i Hasan Prishtinës dhe i Bajram Currit, që kishte bërë shumë për ta organizuar kryngritjen e përgjithshme për liri, pastaj atdhetari i devotshëm Shaqir Smaka nga Kastrioti i Skënderajt themeluesi i parë i çetave kaçake në Kosovë.

Pas vrasjes së Shaqir Smakës çetave kaçake u priu Azem Bejta, bashkë me të cilin ishin edhe shumë shokë, si: Mursel Delia, Emin Lati, Bajram Zena, Xheladin Luboveci, Mehmet Delia, Xhemë Ternavci, Bajram Delija, Fazli Berani, Adem Miftari, Beqir Lahu, Rifat Bajska, e shumë të tjerë. Të gjithë shokët e Azem Bejtës, Tahir Meha i dinte me emër e mbiemër. Ai madje na i tregonte shpeshherë edhe romuzet e asaj kohe, që i kishte dëgjuar nga gjyshi i tij.

Tahiri, shpeshherë tregonte edhe për një xhandar Lutën: "Ky Luta kishte hapur fjalë se ku ta zinte Azem Bejtën do ta vriste me dorën e vetë! Azemit i vjen lajmi se xhandar Luta një natë ishte në një konak. Me t'u errur, Azemi bashkë me Bajram Zenë Mehën dhe futet brenda në konak ku ishte Lutë xhandari. Azemi u thotë të pranishëmve: «Mos lëvizni se jeni të rrethuar!» Azemi ulet, e ata ia sjellin përpara kafën dhe duhanin. Xhandar Lutës fillojnë t'i dridhen duar e këmbë. «Mbaje veten xhandar Luta!» – ia pret Azemi. «Ja ku erdha. Kam dëgjuar se je betuar



Shaqir Smaka

Atdhetar i devotshëm. Themelues dhe udhëheqës i parë i Çetave Kaçake të Kosovës 1909-1916. U lind në Kastriot të Drenicës, i respektuar dhe me ndikim në atë kohë. Ra me pushkë në dorë në Bajë të Drenicës me 1916 në përpjekje për lirinë e atdheut. Pas rënies së tij, Lëvizjes Kaçake të Kosovës i priu Azem Bejtë Galica.

që po sa të takohemi do të më vrasësh!» «Jo, ore Azem!» – fillon të betohet xhandar Luta. – «Të kanë gënjyer. Unë ty të respektoj!» Azemi ia zgjat kutinë e duhanit xhandar Lutës duke i thënë: «Na kutinë e duhanit. Mbështille një cigare. Ndize dhe pije! Kur ta harxhosh cigaren, do të bie me dhjetëshe në ballë, pra ke jetë vetëm deri sa të sosit cigarja!» Xhandar Luta nuk e mbështillte dot, ngase i shqyheshin letrat e duhanit nga dridhjet e duarve. Azemi e urdhëron shokun e vet Bajramin, i cili ia mbështjell cigaren dhe ia ndez. "– e vazhdonte tregimin Tahiri duke e rrëfyer, ashtu siç e kishte dëgjuar nga Bajram Zena. "Po Lutë xhandari nuk po e pinte dot cigaren. Po i merrej fryma. Të gjithë filluan t'i luten Azemit që ta falte Lutën se kishte gabuar. Azemi kur e pa se xhandar Lutës vërtet po donte t'i dilte shpirti nga frika, e urdhëron që ta flakte petkun e xhandarmërisë së Serbisë. Ia bën një shenjë, duke ia prerë veshin me thikë, dhe e lëshon të ikte vetëm «në të linta» nga konaku!" «Mirë ia ka bërë! Kështu e duan spiunët, t'ua presësh veshin, në mënyrë që t'i njohë populli,» – thoshte në fund Tahiri dhe shkulej se qeshuri. Me tregime e ngjarje trimërish Tahiri ishte formësuar e mbushur me ide për ta përballuar jetën nën pushtim.

Më vonë, pikërisht gjatë vitit 1945, sistemi sllavokomunist me Titon dhe Rankoviçin në krye, vunë çizmen e dhunës në Kosovë, duke e shuar me gjak kryengritjen e Drenicës të udhëhequr nga Shaban Polluzha. Me këtë rast ata pushkatuan mbi dhjetë mijë shqiptarë pa gjyq. Pesë mijë të tjerë i vranë në mënyrën më mizore në Tivar të Malit të Zi. Vranë Ymer Berishën, dënuan grupin e Prekazit, që akuzohej se kishte prerë shtabin operativ çetniko-partizan në Prekaz, në kullën e Shesivar Alisë me 1945. Masakrat, vrasjet dhe dënimet me burg në Kosovë e në viset e tjera shqiptare, që shakaktuan shpërnguljen e dhunshme për në Turqi, nuk kishin të ndalur.

Për t'ia prerë hovin këtij terrori të paparë filluan edhe lëvizjet e para politike në rrethana të reja, si ajo e grupit të Isa Zymberit, nipit të Mursel Delisë dhe e disa atdhetarëve të tjerë që kishin për synim lirinë e popullit.



Mursel Delia

I biri i Ahmet Delisë, bashkëpjesëmarrës në rezistencën e njohur të Prekazit me 1913. Luftëtar dhe bujar. Më vonë i bashkangjitet çetës kaçake të Azem Bejtës, së cilës nuk iu nda për asnjë çast. Vdiq në një spital të Shkupit me 1931 nga një sëmundje jo e rëndë! Dysohet se e kanë helmuar me të diktuar se ishte i biri i Ahmet Delisë. Atje është i varrosur, ngase xhandarmëria e Serbisë nuk kishte lejuar që ta sillnin kufomën në Kosovë, madje e kishin ruajtur ca kohë edhe varrin e tij!...

Në kullat e shumë burrave të Prekazit, në të cilat kishin ngrënë bukë, kishin ndenjtur e kuvenduar burrat e dheut si Hasan Prishtina, në kullën e Ahmet Delisë, ku kishin lidhur besën e madhe "për me dhanë robë e gjanë e mos me iu nënshtruar robnisë..." , pastaj në kullën e gjyshit të Tahirit dhe në kullën e Bajram Zenës, ku kishin ngrënë bukë me dhjetëra herë Azem Bejta me shokë, më vonë Shaban Polluzha e Mehmet Gradica, pastaj në kullën e Murat Jasharit etj. , Tahiri ishte rritur duke i dëgjuar tregimet e vërteta, nga vetë pjesëmarrësit e tyre.




Kulla e Bajram Zenë Mehës

Në këtë kullë kanë ngrënë bukë Azem Bejta me shokë, Shaban Polluzha, Mehmet Gradica, Shaban Jashari e shumë e shumë të tjerë. Shumë nga këto kulla, të cilat janë historia jonë kombëtare, sot i mungojnë Drenicës dhe Kosovës.

Pas vitit 1912 pushteti serb me dhunë filloi spastrimin etnik të popullatës shqiptare nga Kosova, duke ushtruar gjenocid për t'i dëbuar për në Turqi. Kështu kishin filluar edhe në Prekaz, ku hasën në rezistencë të vendosur të prekazasve të prirë nga Ahmet Delia. Nga xhandarmëria serbe aty mbetën të vrarë tetë veta. Sakrificë sublime e Ahmet Delisë dhe gjaku i tij, në atë kohë, shënojnë fljimin e parë në themelet e Kosovës. Që nga ajo ditë e deri më sot, për liri të tokave shqiptare ranë shumë dëshmorë. Pa dyshim, mbi gjakun e tyre, populli ynë do të shënojë emrin LIRI dhe asgjë tjetër.

Lufta për lirinë tonë kombëtare nuk pushoi, edhe pse ajo pati baticat dhe zbaticat e saj. Ajo gjeti mbështetje të fuqishme tek strategët tanë politikë të kohës e herë pas herë edhe te faktori ndërkombëtar. Figurat madhore, të cilat bënë çmos që zëri i shqiptarit të dëgjohej edhe në parlamentet e Evropës, si Abdyl Fërashëri, Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Luigj Gurakuqi, Hoxhë Kadria etj. , i bashkërenditën kërkesat, që u mbështetën edhe nga masat e gjera, për t'i treguar botës se lirinë do ta realizojmë edhe me çmimin e gjakut.



Azem Bejtë Galica

1889-1924

Atdhetar i përkushtuar, luftëtar i paepur, prijës i Lëvizjës Kaçake të Kosovës. Mbi dhjetë vite nuk e hoqi pushkën nga dora në përpjekje për liri të atdheut. Bashkëpunonte ngushtë me Hasan Prishtinën, Bajram Currin etj. Ra me 1924 në mbrojtje të Kosovës dhe të popullit tonë. Pas rënies së tij Lëvizjës Kaçake të Kosovës i priu Mehmet Delia i Radishevës se bashku me Shotën.



Qerime-Shotë Galica

1896 – 1927

Qerime Halili - Radisheva, Shotë Galica, për asnjë çast nuk iu nda burrit dhe bashkëluftëtarit të saj, Azem Galicës. Ajo u bë shembull për botën femërore jo vetëm tek ne. Ajo së bashku me Mehmet Delinë bënë atentat mbi naçallnikun serb në Mitrovicë me 1920 dhe së bashku i prinë çetës së luftëtarëve pas vdekjes së Azemit. Më 1968, në Shqipëri, u shpall "Heroinë e Popullit Shqiptar".

TRADITA LUFTARAKE E FAMILJES MEHA

Emin Lati me të vëllanë Mehën si të rinj kishin dhënë prova duke qenë kurdoherë pranë luftëtarëve të lirisë. Emini, kur ra Ahmet Delia ishte njëzetë vjeç. Në organizimin e lëvizjeve kaçake tanimë ai kishte një përvojë të mirë. Azem Bejta Eminin e donte dhe i besonte shumë. Kur Azemi i kishte gratë në Shqipëri të shumtën e rasteve e dërgonte Eminin për t'ia sjellë në Kosovë. "Të gjithëve iu dua, thoshte Azemi, por Eminin e kam më për zemër. Jam i sigurt se ai më parë do të bjerë, se do të tërhiqet pa u vrarë së bashku me gratë e mia, po që se bie në ndonjë grackë të mundshme të xhandarmërisë serbe. "Vërtet Emini ishte i tillë. Ai mund edhe të vritej, por kurrë të dorëzohej. Ishte betuar se: "Një herë kam me e dhanë këtë shpirt. Mbasi që po u dashka me e dhanë, atëherë do ta jap për shqiptari dhe për shokët e mi!"

Azem Bejta, tanimë kishte bërë emër dhe përvojë si prijës i Lëvizjes Kaçake të Kosovës. Ai e rekrutoi Selim Dervinën nga fshati Kollë i Vushtrrisë në radhët e xhandarmërisë serbe si "çauash", për të qenë në shërbim të çështjes, pra për ta njoftuar Azem Bejtën për planet që mund t'i bënte Serbia kundër kësaj lëvizjeje. Kjo zgjati për dy-tri vite. Pasi që xhandarmëria serbe




Emin Lati Meha

1892 – 1974

Bashkëluftëtar i pandarë i Azem Bejtës, atdhetar i devotshëm dhe pjesëmarrës i dhjetëra luftimeve e aksioneve kundër xhandarmërisë serbe. Si njëri ndër figurat kyçe të Lëvizjës Kaçake të Kosovës, ishte shumë i respektuar nga shokët. Ka vdekur në moshë të shtyrë pleqërie në Prekazin e tij të dashur.


e diktoi Selimin se po i nxirrte informatat jashtë, vendosi që ta percillte. Një natë dimri, me gjasë të vitit 1920, Selim Dervinën e rrethojnë në shtëpinë e vet, meqë e kishin diktuar se brenda në shtëpi i kishte edhe bashkëluftëtarët e Azemit, Eminin Latin me të vëllanë, Mehën. Kërcet pushka dhe lufta zgjat deri afër mëngjesit. Aty vritet Selim Dervina se bashku me nipin e vet, pastaj edhe i vëllai i Eminit, Mehë Lati si dhe dy luftëtarë të tjerë. Njëkohësisht, në atë përleshje, kishin mbetur të vrarë edhe 11 xhandarë serbë.

Tahiri, që në rini kishte dëgjuar për ngjarje të tilla, për këta njerëz të mirë që kurrë nuk flisnin në veten e parë njëjës. Ata kurrë nuk thoshin se unë e bëra atë dhe këtë. Ata gjithmonë pohonin: "Shokët në krye me Azemin e bënë luftën për liri, nderkaq ne u kemi ndihmuar duke ia bërë nga një argat atdheut!" Bujaria dhe urtësia filozofike e këtyre njerëzve të mirë e brumosi Tahirin edhe më me përkushtim për të qenë i gatshëm për sakrificë më sublime që mund të bëjë njeriu për atdheun e vet. Ai do të tregojë edhe një interesim të madh edhe për Kryengritjen e Drenicës, të udhëhequr nga Shaban Polluzha, së cilës më vonë iu bashkangjiti edhe Mehmet Gradica.



Shaban Polluzha


Komandant i Kryengritjes së Drenicës, prijës dhe tribun popullor. Po ashtu komandant i njësitit vullnetar në luftën e Pazarit dhe të Kolashinit kundër çetnikëve serbë. Luftoi kundër nazi-fashizmit gjatë viteve 1941-1944 dhe kundër të gjithë pushtuesve te atdheut tonë. Duke i vërejtur tradhtitë e sllavo-komunistëve të Titos, organizoi kryengritjen popullore në Drenicë. Ra heroikisht në altarin e lirisë pas një lufte të ashpër dhe të pabarabartë me armikun, në shkurt të vitit 1945.



Mehmet Gradica

Toger Mehmet Gradica, komandant i Xhandarmërisë Shqiptare, udhëheqës i luftës për liri kombëtare. Bartës i pushtetit shqiptar gjatë viteve 1941-1943 në Drenicë (nën pushtimin Italian), pa dyshim atdhetar i devotshëm dhe trim i pakompromis. U vra në shkurt të vitit 1945 në kryengritjen e madhe të Drenicës së bashku me Shaban Polluzhën kundër hordhivë partizano-çetnike të Sërbisë, respektivisht Jugosllavisë.

Historinë e Kryengritjes së Drenicës Tahiri e kishte dëgjuar nga babaj i tij Nebihu, bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës. Nebihu i tregonte për kasaphanet që ishin bërë kundër shqiptarëve pas shuarjes me gjak të kësaj kryengritjeje, për masakrat e tmershme që ishin bërë në prag të saj në tërë Kosovën e në veçanti në Drenicë, ku i kishin parë me sytë e tyre kufomat e shqiptarëve të hedhur në lumin Klina të Skënderajt!




Nebih Meha

1910 – 1981

Pjesëmarrës i Kryengritjës së Drenicës. Nebihu asnjëherë nuk iu nënshtrua pushtuesit serb. Ai e kundërshtoi atë në mënyrat më të ndryshme duke luftuar edhe me pushkë në dorë. As pas vitit 1945 e këtj nuk e pushoi veprimtarinë e tij për liri. Më 1981, në moshën 71 vjeçare, ra heroikisht së bashku me të birin Tahirin në një luftë të pabarabartë me pushtetin antishqiptar jugosllav.


Për luftën e Shaban Polluzhës Nebihu i kishte folur shumë Tahirit. I kishte treguar se si kishin luftuar dhëmbë për dhëmbë me forcat e pushtuesit. Ai i kishte folur edhe për trimat dhe udhëheqësit e rrallë të asaj kohe, siç kishin qenë: Miftar Bajraktari, Gani Agë-Spahia, Jetullah Rezalla etj. , të cilët kishin rënë heroikisht në fushën e nderit pa u tërhequr për as një çast nga vija e frontit.



Miftar Bajraktari

1888-1945

U lind në Llaushë të Drenicës. Luftëtar dhe strateg i dalluar. Njeri me autoritet në popull, organizator dhe mbështetës i paluhatur i Shaban Polluzhës dhe i Kryengritjes gjithëpopullore të Drenicës kundër hordhve çetniko-partizane të Serbisë. Major me gradë ushtarake. Akademinë Ushtarake e kishte të kryer në Shqipëri (në kohën e mbretit Zog). Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Kryengritjes së Drenicës. I vetmi që kishte kontaktuar me Misionin Anglez në malet e Qyqavicës në janar të vitit 1945. Ra në vijën e frontit në shkurtin e vitit 1945 së bashku me Shaban Polluzhën.



Gani-Agë Spahia

Ka lindur në Llaushë të Drenicës. Anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Kryengritjës së Drenicës. Luftëtar i paepur i lirisë, i cili nuk u nda prej Shaban Polluzhës për asnjë çast deri sa ra në shkurt të vitit 1945. Ishte strateg dhe diplomat dhe njohës i mirë i rrethanave politike të kohës.

Pas Kryengritjes së Drenicës pushteti serb filloi me represaliet më çnjerëzore mbi shqiptarët. Dhuna, duke e shtrenguar rrethin e hekurt, në atë kohë ishte bërë institucion legal i Jugosllavisë së Titos kundër shqiptarëve. Nga Kryengritja e Drenicës shpëtuan pak udhëheqës, siç qe Ymer Fazlia i Radishevës, i cili kaloi në ilegalitet të thellë. Imeri ka bërë shumë për t'i sendërtuar aspiratat e popullit tonë.



Ymer-Fazli Radisheva

Udhëheqës i vullnetarëve në luftën e Pazarit dhe të Kolashinit kundër çetnikëve. Komandant i Batalionit në luftën e Drenicës. Shpëton nga luftimet e ashpra në Kryengritjen e Drenicës, por vritet në pabesi më vonë, në prill të vitit 1947.


Tahiri Meha, duke e kuptuar esencën e këtyre ngjarjeve, kultivonte një respekt të veçantë për ata trimat të kohës. Padyshim se edhe ai kishte simpatitë e veçanta për ndonjërin nga personazhet e ngjarjeve. Kjo mbase edhe varej prej përshkrimeve me të bukura që i kishin bërë atij gjyshi dhe babai i tij. Siç duket më të veçanta i kishte ato kujtime, që ia kishte treguar Bajram Zena, me një bisedë të rrjedhshme dhe të qetë. Ai ia përshkruante ato me aq simpati dhe me aq kujdes, sa që luftëtarët e lirisë i ngjallte dhe i nxirrte si ne skenë, i bënte të dukshëm. Një simpati më vete Tahiri e mbante për Mehmet Delinë, që bashkëluftëtarët e tij e thërrisnin: "Mehmeti i Vogël", i cili kishte qenë shumë solidar me shokët. Ai ishte në gjendje që t'i printe çdo aksioni. Nuk kishte ndodhur kurrë të thoshte: "Shko ti" ! Çdoherë thoshte: "Rri se po shkoj unë në aksion!" Këtë veti e posedojnë vetëm trimat e rrallë. "Mehmet Delia me plot meritë i priu Lëvizjës Kaçake Të Kosovës pas rëniës së Azemit", – i kishte thënë, Tahir Mehës, Bajram Zena.



Mehmet Delia

1891 – 1945

Ose "Mehmeti i Vogël" – siç e thërrisin shokët e çetës. Luftëtar i shquar që nga viti 1916. Bashkëluftëtar i Azem Bejtës dhe udhëheqës i Lëvizjës Kaçake të Kosovës që nga viti 1924-1927. Ishte strateg i shquar dhe shumë i afërt me shokët e çetës. Pas vitit 1927, përpjekjet e veta për liri të atdheut i vazhdoi në Shqipëri. Vritet në Bari të Italisë nga regjimi fashist si i zënë rob lufte, diku në maj të vitit 1945. Eshtrat e tij ende prehen përtej Adriatikut, në Itali! . .



Bajram Zenë Mehaj

1905 – 1979

Bashkëluftëtar i Azem Galicës që nga orët e para. Burrë i respektuar dhe njohës i mirë i rrethanave të atëhershme politiko-ushtarake. Kishte një kujtesë të hatashme dhe i shpjegonte ngjarjet luftarake pa emocione e pa anime. Ishte shumë i sinqertë. Gjërat i thoshte troç dhe kurrë nuk fliste në vetën e parë, siç e kishin zakon shumë bashkëkohanikë të tij. Vdiq më 1979.

Menjëherë pas përfundimit të LDB-së, udhëheqësit e pushteti komunist, Tito dhe Rankoviçi, filluan me fazën e dytë të pasluftës me represalje mbi shqiptarët. Së pari i mbyllën të gjitha shkollat shqipe, që kishin funksionuar gjatë viteve 1945 – 47. Njëkohësisht i ndaluan edhe simbolet kombëtare. Në emër të "çarmatimit të shqiptarëve" ata ushtruan torturat më mizore mbi shqiptarë. Kjo formë e egër e terrorit, që vazhdoi deri në vitet e gjashtëdhjeta, përcillej me propagandë, e cila kishte për qëllim t'i shpërngulte shqiptarët për në Turqi! Në këtë këndvështrim, po t'i shohim gjërat realisht, vërtet në Kosovë nuk kishte mundësi veprimi për të bërë diçka më të madhe, prandaj duhej përveshur punës për t'i përgatitur gjeneratat e reja, të cilat një ditë do të bëhen më të zonja për të hapur shtigje të reja lirie. Në hapësirat politike dhe ekonomike të kohës në Kosovën e pasluftës, patriotë të shquar filluan përgatitjet e para. Ata kishin shumë punë për të bërë, ngase shtypja ishte shumë e egër dhe se populli ynë kishte vuajtur shumë. Ishte e domosdoshme platforma e bashkimit veprues të këtyre forcave, në mënyrë që flaka e ndezur e lirisë të mos shuhej, por të përhapej ngadalë e sigurt, për të arritur më pas formën e vet të përhëndritjes së natyrshme dhe të domosdoshme. Ndër të parët që vepruan pas LDB-së ishin burrat e kombit tonë, si: Omer Çerkezi me shokë, Ali Aliu i Preshevës me shokë, Adem Demaçi me shokë e dhejtëra e dhjetëra grupe e grupime të tjera atdhedashësish të dënjë, të cilët për t'i dhënë shtytje të fortë çështjes së pazgjidhur të atdheut kaluan vite të tëra rinie nëpër kazamatet e Serbisë

Shqiptarët e Kosovës, përpos prangave të robërisë, nuk kishin se ç'të humbisnin më! Pikërisht mbi këtë platëformë filozofike dhe të drejtë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës edhe triumfoi mbi pushtuesin serb i cili Kosovën e mbajti me dhunë

si koloni, për rreth një shekull!

Është e natyrshme që popujt të cilët luftojnë gjatë për liri, të kenë më shumë trima, dëshmor, histori, këngë trimërie e lavdie, po edhe monumente historie e lapidarë krenarie. Shikuar nga ky kënd edhe Drenica ka veprimtarët, luftëtarët dhe të rënët e vet. .

Pasiqë Isë Zymberi i shpëtoi pushkatimit (ishte komandant i Batalionit të Tretë në Brigadën e Shaban Polluzhës), arratiset nga burgu i Sremit dhe veproi në ilegalitet të thellë deri në vitin 1950. Në pamundësi veprimi të mëtejshëm, Isai arratiset për në Shqipëri së bashku me Sherif Tërstenën. Më vonë, bashkëveprimtarët e Isës, së bashku me ta edhe i biri i tij Shabani, zbulohen, arrestohen dhe dënohen. Si: Shaban Isë Zymberi, Vesel Hajzeri, Halil Sejdia, Ilaz Halimi, Hamëz Tali, Dibran Ukshini, Shaban Fazlia, Ahmet Dili etj. Pas tyre do të dënohet edhe Bajram Nebihu, i cili kishte vënë disa flamuj shqiptarë nëpër Mitrovicë dhe një në Kalanë e Zveçanit. Një flamur, Bajrami, e kishte vënë edhe në trenin që udhëtonte në relacionin Fushë-Kosovë Beograd. Serbët u tmerruan kur panë se treni u fut në Beograd me flamurin shqiptar duke valor!

Në Prekaz tanimë po ngritej brezi i ri i intelektualëve lirishtës të kohës të cilët kishin arritur që t'i ndiqnin mësimet në normalen e Gjakovës. Këta nxënës të inspiruar nga atdhedashuria si dhe nga shembulli i bashkëvendësve të tyre dhe të atdhetarëve të tjerë të kohës (padyshim të përkrahur fuqishëm edhe nga drejtori i normales së Gjakovës, mësuesi dhe atdhetari Beqir Kastrati), kontribuan anë e kënd Kosovës. Ndër ta ishte edhe Bislim Prekazi, i cili i kishte bashkuar bashkëmendimtarët e vet, duke dalë me platformën kombëtare më organizatën e atëhershme të cilën e kishin pagëzuar "Vujtja Shqiptare" . Është me rëndësi të cekim se ky grup kishte të

gjitha resoret si edhe atë të rëndësisë së veçantë, që nënkuptonte përgatitjen për rezistencë të armatosur! Këtij resori i printe pikërisht Beqir Meha (vëlla i Tahir Mehës). Veprimtaria e tyre politike u zbulua nga UDB-ja diku në prill të vitit 1959, me ç'rast burgosen: Bislim Prekazi, Beqir Meha, Adem Alia, Ajet Fazlia-Meha, Sherif Musliu, Ramadan Zeneli, Istref Osmani, Muhamet Llausha etj. Ky grup kishte bërë disa aksione në terren. Njëri prej këtyre aksioneve, ishte edhe ai i sigurimit të armëve që i kishin grabitur në shkollë të Prekazit, e që shënonte fillimin e grumbullimit të armatimit për përgatitjen e një kryngritje të mundshme të armatosur. Këtij aksioni i kishte prirë Beqir Meha me sukses. Kjo nuk kaloi edhe pa tronditje për UDB-në atë kohë. Grupi u dënua, së bashku me ta edhe Beqir Meha, të cilin për vujten e dënimit e transferuan më pas në llogorin koncentruar të "Goli Otoku" famëkeq.



Beqir Meha

1936 – 1999

Beqir Meha, atdhetar i shquar, njeri me karakter të fortë kombëtar. Ai vazhdoi rrugën e ndritur të të parëve të tij. Kjo rrugë e ndritshme Beqirin e bëri të pavdekshëm. Pas vuajtjes së dënimit me burg politik nuk u hamend për asnjë çast, por punoi me përkushtim për ditën që e priste. Në momentin e parë kur u formuan celulat e para të UÇK-së, Beqiri iu bashkangjit atyre. Ishte i pandashëm me Adem Jasharin. Beqiri ra me pushkë në dorë duke luftuar kundër pushtuesit serbe me 25 mars të vitit 1999 në moshën 63 vjeçare. Ra në fushën e nderit për të mos vdekur kurrë.

Familja e Nebih Mehës nuk e kishte të lehtë atë botë për t'i rrahur ato rrugë deri në "Goli Otok" për ta vizituar Beqirin. Hallet dhe dertet filluan që të rëndonin edhe më shumë në kurrizin e Nebihut, ngase Tahiri ishte i ri për t'i përballuar gjithë ato intriga të UDB-së. Tahiri po i shihte drejtëpërdrejtë padrejtësitë, shtypjet, burgosjet që pushteti i Jugosllavisë po i ushtronte mbi shqiptarët. Në këtë rast, si personazh sublimim, ai po e shihte edhe të vëllanë e vet se bashku me prekazasit e tjerë. Tahiri do t'i mbajë në mend gjatë ato rrapllima çizmesh të gardianëve, ato rrapllima dryrësh e shulash të dyerve të hekurta të burgut, ato grila që i kishin ngërthyer shqiptarët dhe ato rreze dielli që përthyheshin në valët e Adriatikut, për t'u betuar më vonë se: "I gjallë në dorë të shkjaut nuk kam me ra!" . Nebihut se pari iu rëndua barra e jetës meqë një jetë të tërë e percolli varfëria, se dyti Beqirin ia burgosën e dënuan, se treti Tahirin e kishte të ri për t'iu bërë krah pune dhe së fundi nga vëzhgimi dhe përcjellja që i bëhej nga UDB-ja dhe marrja në biseda "informative" që i sillte mjaft telashe. Mirëpo Nebih Meha kurrë nuk ishte dhënë. Gjithmonë kokën e mbante lartë. Ai nuk u nënshtrua kurrë as përpara varfërisë e as për para pushtuesit jugosllav. Ai gjithmonë thoshte: "Beqirin e kam të burgosur, por ai një ditë do të lirohet se bashku me shokët. Po unë e kam edhe Tahirin që po rritet e së shpejti do të bëhet krah i fortë i shtëpisë".


Pas vuajtjes së dënimit, Beqiri u kthye në shtëpi. Së bashku me të edhe Nebihut iu kthye buzëqeshja. Beqiri iu tha: "Unë dhe shokët dolëm. Së pari ka rëndësi që dolëm gjallë, por rrugët tona duhet vazhduar nga dikush... e ata jemi ne. Me këtë pushtet nuk i kemi qëruar hesapet ende, prandaj do të ndeshemi me te përsëri. Jo vetëm ne si familje, por pa dyshim edhe si komb!"

Jeta vazhdonte. Shqiptarët filluan të lëviznin për ditë e më shumë. Diku vepronin e nuk zbuloheshin, diku zbuloheshin e burgoseshin. Sa më e madhe që bëhej trysnia aq më fuqishëm ndizej flaka e atdhedashurisë. Në kuadër të veprimtarisë për çështjen e madhe më vonë burgoset edhe Beqir Lutfiu. Është me rëndësi të cekim se Beqir Lutfiu, po ashtu normalist, dënohet nga Gjyqi Ushtarak në Beograd për propagandë antijugosllave. Atë e transferojnë në "Goli Otok" , ku takohet me shumë shqiptarë,të dënuar nga ai regjim si: Kemail Agollin, Xhafer Kodrën, Salih Lisin etj. Beqiri më vonë nëpër kazamatët e Serbisë, por edhe jashtë tyre,takohet edhe me Adem Demaçin. Ai duke i parë te Beqiri tiparet e një djali të vendosur e të zgjuar, si dhe duke e ditur se Beqir Lutfiu ishte në lidhje me veprimtarët e grupit "Vujtja shqiptare" , kishte kërkuar që ky grup të fillonte menjëherë furnizimin me armatim, mbase shpejt do të vinin ditë më të favorshme për një kryengritje të armatosur dhe ne duhej të ishim gati. "Pra le ta marrë vesh bota se poqëse nuk zgjidhen kërkesat tonë me paqe, ne do t'i realizojmë ato edhe me pushkë-kishte thënë Demaçi".

Vitet kalonin. Jeta i kishte përfshirë përpara, si të gjithë të tjerët, me tërë fuqinë e saj edhe familjen Meha. Beqir Meha edhe pas vrasjes së Tahirit dhe Nebihut, nuk u dorëzua. Ata ia vranë vëllanë, babanë, ia plagosën vajzën e vëllait, ia terrorizuan të gjithë anëtarët e familjës, ia dogjën kullën e Tahirit dhe shtëpinë që e kishte në katin përdhes. E mbajtën në arrest për më së shtatë muaj se bashku me axhën e tij Mehmetin, të cilët i akuzuan për vrasje të milicëve serbë. Beqirit i mbetën nën perkujdesje edhe të pesë vajzat e Tahirit. . . Pas shumë vitesh që kaluan në përpëlitje me jetën dhe hallet e saj, Beqir Meha sikur e mori pak veten. Djemtë iu rritën e iu bënë krah pune. Me të

vërejtur këtë, një mbrëmje, Beqiri u tha bijve të vet: "Ju shyqyr u rritët dhe u burruat. Kushtet e jetës, deri diku, i kemi të mira. Si edhe të tjerët, kemi bukë e kripë e zemër. Unë ka kohë që kam pritur t'ju shoh se jeni të zotët e vetes. Tani kam më tepër kohë që të merrem me punët e atdheut. Ka kohë që i kam lënë anash!" Ai në momentin e parë u rreshtua në njësitin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo është pak a shumë e kaluara e familjes së Tahir Mehës që në jetë la gjurmë të pashlyeshme.

Nuk është vetëm se tradita familjare e Mehajve, si edhe e shumë familjeve të tjera në Kosovë, që dhanë aq shumë për atdheun. Por mbi të gjitha është gatishmëria e saj gati njëshekullore për të bërë rojë në zemër të atdheut. Mbase këtu është edhe gjeneza, fuqia, inspirimi dhe vullneti i madh për t'u flijuar me vetëdije të plotë dhe me përkushtim të madh në shërbim të atdheut. Shembujt që nuk mbetën të papërseritur në histori si: djegia për të gjallë e Oso Kukës në kullë të barotit e Kamer Loshit, rënia heroike e Ahmet Delisë, Azem Bejtës, Shaban Polluzhës, qëndresa deri në rënien heroike e Tahir dhe Nebih Mehës, Adem, Hamëz e Shaban Jasharit. Këto rënie janë madhështia e burrave të Kosovës dhe e krejt shqiptarisë që trimërinë, sakrificën, rënien dhe kullat i shndërruan në legjendë! Vetëm atyre që kaq shumë iu përkushtuan çështjes së atdheut, u buzëqeshi fati për të qenë pjesë përbërse e historisë sonë.



Tahir Meha

1943-1981

Tahir (Nebih) Meha. Rrjedh nga një familje me traditë atdhetarizmi. Njeri i përkushtuar shpirtërisht ndaj çështjes kombëtare. Burrë trim dhe i vendosur për t'i jetësuar aspiratat e dëshmorëve tanë. Ra duke luftuar kundër pushtuesit serbo-sllav për 18 orë rresht. Ra me 13 maj 1981, në moshë relativisht të re. Ishte vetëm 38 vjeçar, kur gjaku i tij prej shqiptari të vërtetë rimoi themelet e gurta të lirisë së Kosovës. Tahir Meha u lind në kohën e luftës dhe iku nga kjo botë duke luftuar për liri.

FËMIJËRIA E TAHIR MEHËS

Tahir Meha lindi me 10 tetor 1943 në Prekaz. Atë kohë në Kosovë e më gjerë po bëhej luftë e paparë kunder nazi-fashizmit. Atë fillim vjeshte që po i paraprinte një dimri të ashpër për shqipatrët po përgatitej platforma që Kosova të përfshihej nën juridiksionin jugosllav. Ashtu edhe u vendos më vonë. Pas Konferencës së Bujanit, ku u shpreh vullneti për bashkim me Shqipërinë, Kosova iu aneksua Jugosllavisë dhunshëm. Atë fundviti të 1943, Lufta e Dytë Botërore kishte hyrë në fazën më vendimtare. Tahiri si foshnjë më parë u ndesh me krisma pushkësh e erë baroti, se sa me të qeshura dhe me përkëdhelje prindore.

Dajat e gjyshit të Tahirit ishin nga Baica e Drenasit, kurse të babait të tij ishin nga Gllareva e Klinës. Tahiri dajat e vet i kishte në Llaushë. Në Llaushë dajat i kishte edhe Adem Jashari, pra ishin kusheri edhe prej nënave! Në rrethana të luftës Tahiri kishte patur një foshnjëri të pa rehatshme duke e bartur e ëma nga një sakj në sakjin tjetër, për t'u strehuar nga flakët e luftës me ushqime të pakta dhe me veshmbathje të dobëta, me një gjendje të rëndë shpirtërore e sociale për prindërit tanë, pra si në kohë lufte, ku njëriu nuk kishte hapësirë as për t'iu gëzuar

as lindjës së fëmiut të vet!

Tahiri qe nga fëmijëria, si edhe të gjithë shqiptarët e Kosovës, të cilët tani po përjetonin risundimin e Jugosllavisë e cila e rifilloi një epokë të re të dhunës nder ne, ishte ballafaquar me varfëri dhe pushtim të rëndë. Shtati i tij foshnjarak ndjeu më shumë se ç'po ndodhte rreth tij. Ai ishte si fëmijë shumë i dashur dhe nuk e dallonte diçka e veçantë nga moshatarët e vet pos zgjuarësisë dhe shkathhtësisë së tij. Ishte plotë shëndet dhe nuk mbahet mend të ketë lënguar nga ndonjë sëmundje, pavarësisht varfërisë që e kishte kapluar familjen e tij dhe familjet e fëmijëve të tjerë. Më vonë kur u rrit sa për të filluar shkollimin, mbaroi vetëm katër klasë fillore. Rrethanat e rënda dhe trysnia e robërisë e detyruan të mbetej në shtëpi?! Lufta për bukën e gojës, thjesht përpërlitja për egzistencë, i detyroi shumë shqiptarë që të hiqnin dorë nga shkollimi, duke u kthyer në punëtorë krahu.

Pas mbarimit të LDB-së pushteti i LKJ, filloi që të zbatonte forma të ndryshme të dhunës. Një formë e tillë ishte edhe presioni mbi ekonominë shtëpiake, që i detyronte shqiptarët ta dorëzonin edhe bukën e gojës në emër të "tepricave", apo siç e quanin ata "vishak", "otkup" etj. Në emër të këtyre tepricave kërkoheshin dorëzimi i qumështit, djathit, tëlyenit, leshit, drithit, deri edhe bukës së gojës. Qëllimi ishte që jeta shqiptarit t'i bëhej e padurueshme dhe të shpërngulej për në Turqi. Tahiri po e ndiente këtë mungesë ushqimi si edhe të gjithë fëmijët e tjerë të Kosovës. Megjithatë intuita e fëmijës nuk pushonte se imagjinuari për ditë më të mira. Ai po rritej, ku me një copë buke, ku me një pemë. Jeta edhe pse e rëndë, vazhdonte dhe përballohej pa u diktuar, pra fëmijët rritën pa dashur të ia dinë për rrethanat e rënda të kohës që jetojnë.

RINIA E TAHIR MEHËS

Tahiri si i ri bie në sy për zhdervjelltësinë e tij të pashoqe. Kishte shtat mesatar e të zhvilluar. Ishte i shpejtë në lëvizje, shumë i kujdesshëm në veprime dhe tejet vigjilent. Ai dëgjonte më shumë se ç'fliste. Moshë e rinisë edhe te Tahiri po kalonte me të mirat dhe të këqijat e saj. Tahiri, si i shpejtë që ishte, si në gara të ndryshme, lojë me top, vrapim, mundje, ngjitje në lisa, ngarje të kuajve etj. , ai dëshironte të ishte i pari nder moshatarët e vet. Ai e kishte për krenari këtë, por edhe kur humbte nuk zemërohej, megjithëse nuk pajtohej me humbjen dhe kërkonte që gara të përsëritej deri sa të fitonte. Interesant, kishte shumë kondicion dhe durim të patundur, deri sa e arrinte atë që e dëshironte. Ai jo rrallë, si i ri bënte edhe ndonjë prapështi: piqte tramakë në ara, dëmtonte bereqetin në fushë me bagëti, këpuste ndonjë frut nga pemët e huaja, ngiste ndonjë bashkëmoshatar etj. Kur e bënte ndonjërin nga këto "prapësira" kërkonte me këmbëngulje që të pajtohej me "kundershtarin" dhe nuk e linte që ta "spiunonte" në shtëpi, ngase Nebihu ishte i ashpër dhe mund ta qortonte apo edhe ta ndëshkonte më rëndë. I urrente çunakët e "mamasë" , të cilët për çdo gjë tregonin në shtëpi. Shpesh ndodhte që ata t'i "dënonte" me ndalim në lojërat e

përbashkëta për një apo dy ditë. Kështu Tahiri, si edhe të gjithë ne, u rritë me lojëra e shqetësime fëmijësh. Ai shpesh qeshte me atë kohë rinie, siç mund të qeshim të gjithë ne me prapësitë që i kemi bërë dikur. Tahiri u poq dhe burrërua, tanimë ai mori format e pjekurisë trupore; kishte fytyrë të rregullt paksa të zeshkët me sy të zezë e të ndritur dhe me vetulla të zeza e të trasha. Shkonte gjithnjë i rruar, i pastër dhe i veshur me pedantri. Zakonisht shkonte me kostum. Flokët i kishte të zeza, paksa të dredhura, që i mbante anash mbi ballë. Kishte konstrukt të rregullt dhe një ecje krenare-gjithnjë me kokën dhe ballin e gjërë lartë.


Faza e fillimit të pjekurisë së Tahirin karakterizohet me cilësi të mira shpirtërore e humane. Këtë e karakterizonte ndjenja e tij e lartë e solidarizimit të tij me shokë dhe dashuria për rrethin, për njerëzit dhe kafshët, për tokën dhe shtëpinë, për punën dhe këngën. Ai nuk urrente e as xhelozonte askë. Siç tregojnë edhe bashkëmoshatarët e tij, Tahirin e shihje gjithmonë të shoqëruar, asnjë herë të vetmuar. Të gjithë e donin. Kishte një zgjuarësi të natyrshme. Ishte mikëpritës, bujar e fisnik. Në kullën e tyre mbahej mend përherë bukëdhënia, mikëpritja, bujaria. Tahiri ishte rritur e formuar me rrëfimet e ngjarjeve historike të disa trimave të kohës së Azem Galicës, të cilët kishin pasur fatin që të jetonin ende në kohën e tij. I rritur dhe i edukuar në rrethana të tilla ai shumë herët e kuptoi domosdoshmërinë për të qenë i lirë. Ai mbase krejt natyrshëm po përgatitej për rrugë të gjata, duke qenë krejtësisht i vetëdijshëm për vështirësitë që do t'i haste në këto rrugë. Mirëpo, siç thoshte edhe vet më vonë: "Ne duhet të përgatitemi për një rezistencë të gjatë. Do t'ia arrijmë t'ia dalim, vetëm në se rezistojmë si terësi. Pesëqind vite na ka sunduar Turqia dhe s'ka mundur të na tjetërsojë, nderkaq Serbia këtu ende nuk e ka bërë vendin. Ne jemi të vjetër në këto treva.



Tahir Meha - mosha rinore e tij

Jemi të vendosur për të jetuar në tokat tona, prandaj kjo edhe na forcon ngase e drejta është në anën tonë".

Kulla ku u rrit Tahiri, përveç pritjes dhe përcjelljes së trimave, kishte edhe këngën brenda që u këndohej trimave tanë. Ai e kishte për shpirt këngën: "Ti Shqipni mos thuaj marova" . Këngët e Dërvis Shaqës i donte të gjitha, pa përjashtim edhe ato të arshikërisë. Tahiri për Dërvis Shaqën thoshte: "Dërvisi ore vëlla është shpirti i melosit shqiptar. Ky ta ringjallë heroin dhe ta sjellë historinë para syve. "Të njëjtën simpati e kishte edhe për rapsodët "Mleqani" dhe për kreshnikët e ciklit të Mujit e Halilit. Tahiri thjesht e kishte ushqim shpirtëror melosin shqiptar. Edhe ai si shumë bashkëmoshatarë të tij, kishte si të thuash dëshirat apo pasionet e veta. Ai i donte shumë kuajt dhe i mbante për qejfi. Kuajt si të Tahir Mehës në ato anë pak kush i mbante. Ai thoshte: "Gjokun tim kur ta mberthej e ta marrë sulmin nuk mund ta ndalë as pushka e dushmanit!" Kuajt e tij kishte dëshirë t'i krahasonte me gjokun e Mujit, të Halilit e të Azem Bejtës. Tahiri një dashuri të veçantë e kishte për armët. Nuk kishte armë që ai nuk e njihte, që nuk dinte ta zbërthente e mbërthente, që nuk ia njihte krismën dhe fuqinë. Ishte shenjëtar i mirë. Për armët kujdesej më shumë se për fëmijët e tij. Ai thoshte shpesh: "Burra, armët duhet ruajtur si sytë e ballit. Njëqind vjet e mban armën dhe vjen një ditë kur të duhet më shumë se buka dhe uji. Mos blini shumë traktorë dhe shtëpitë mbaroni më të vogla. Nga këto kursime blini armë! Se me armë i mbroni shtëpitë. Ndryshe vjen serbi e ua merr traktorët, ua djeg shtëpitë e ju nuk keni me çka t'i mbroni!" Ai porosiste: "Ai që është burrë armët nuk i korit dhe s'ia dorëzon për të gjallë armikut...!"



Kulla dhe vajzat e Tahir Mehës

TAHIRI NË SHËRBIM USHTARAK

Tahiri tashmë ishte rritur e burrëruar. Një ditë i erdhi ftesa për të shkuar në shërbim ushtarak! Kjo nuk i pëlqeu Tahirit, por në veçanti u shqetësuan gjyshi dhe i ati i tij. Ata e dinin temperamentin e Tahirit dhe ia kishin frikën. Ishte i ri dhe urrejtjen për pushtuesin nuk mund ta fshihte dot. Tahiri e vërejti këtë shqetësim të prindërve, sado që edhe vetë ishte i shqetësuar e në të njëjtën kohë edhe i mllëfosur që së shpejti do ta shihte veten nën uniformë të pushtuesit tonë gjakatar. Nuk ishte e lehtë për të, por iu kujtua thënia: "Rruga jonë drejt lirisë është e gjatë, prandaj duhet të rezistojmë!" Ai ngadalë i tha babagjyshit: "Po shkoj ushtar babalok, – mbase atje do të kem mundësinë që sado pak ta mësoj artin ushtarak. Do të mësoj si përdoret mitrolozi, granatat, mortajat, topi, ndoshta edhe tanksi. Do të bëj ç' mos, që kur të kthehem nga ushtria, ta sjell një tanks për ty babagjysh!" – Të gjithë i kishte bërë të qeshnin nga shpirti për këtë pohim të çiltër e me humor. Në fakt Tahiri i solli tankset te kulla e babagjyshit të tij në pranverë të vitit 1981 dhe kërceu mbi to si dikur Vojo Kushi!

Ishte bërë rregull e UDB-së që para se shqiptarët të shkonin në shërbim ushtarak, t'ia përcillnin dosjen me të gjitha

dokumentet për personin në fjalë në komandën ku do të shërbente. Ndërkaq për personat dhe familjet e caktuara atë e bënë krejt në mënyrë të veçantë. Rinia shqiptare duhej të ishte shumë e kujdesshme, ngase përfundonte në burg, në çmëndinë, në psikikatri apo për më keq në arkivol, të cilët i kthenin për në Kosovë, me "arsyetimin" se kishte bërë "vetëvrasje", "aksident trafiku" , apo se ishte "vrrarë akidentalisht" . Prandaj rapsodi popullor, jo më kot nxori këngën: "Na ka ardhë një letër me një shkrim të zi, djalo bëhu gati për me shku n'ushtri!" Vërtet lajmi për të vajtur në shërbim ushtarak në ish-Jugosllavi, për rininë shqiptare ishte vetëm një lajm i zi dhe as gjë më shumë!

Tahirin, tanimë shërbimi ushtarak në nivel të komunës së Skënderajt, ia kishte përcjellë dosjen e tij për në Gollubovc të Malit të Zi dhe në Tuzëll të Bosnjës, ku do ta kryente këtë shërbim më vonë. Dosja e tij ushtarake përmbante këto të dhëna të përafërta: "Tahir Meha, i biri i Nebih Mehës-bashkëluftëtarit të Shaban Polluzhës dhe të Mehmet Gradicës, i nipi i Emin Latit-bashkëluftëtarit të Azem Bejtës. I vëllai i Beqir Mehës i dënuar me burg politik që në prill të vitit 1959", armiq të Jugosllavisë që nga koha e Kralit!" ... Kjo do të mjaftonte për Tahirin. Këto të dhëna, shërbimet e pushtetit të Skënderajt, i nxorën më vonë edhe publikisht në gazetatat serbe të Beogradit si në: "Nin", "Borba", "Politika" etj.

Tahiri ndonse i ri në moshë, por i regjur nga përvoja, e njihnte mirë taktikën e pushtuesit serb. Ai i tejkaloi me sukses të gjitha kurthët që mund t'i kishin përgaditur, në saje të këshillave që kishte marrë nga gjyshi, babai dhe nga i vëllai i tij, Beqiri. Erdhi dita kur Tahiri u kthye në shtëpi. Jeta vazhdonte, si gjithmonë, me problemet e saj, herë furishëm e herë e qetë, si valët e detit. Tahiri duke i parë padrejtësitë që po u bëheshin shqiptarëve në kazermat ushtarake serbe e kuptoi edhe më mirë

porosinë e gjyshit: "Tahir, biro, ruaju! Me shka besë nuk ka!" Ai kishte parë se si shqiptarët atje i nënçmonin, i përbuznin, i fyenin, i shanin dhe i diskriminonin në çdo hap. Kjo e bëri ta kuptonte edhe më qartë mesazhin, se: "Rruga e lirisë vërtet është e gjatë".

MARTESA E TAHIR MEHËS

Tahiri, që ishte bërë krah i fortë shtëpie, ishte pjekur e bërë edhe për martesë. Në ndërkohë gjërat kishin ndryshuar dhe ekonomia e familjes së Tahirit kishte rënë paksa. Asnjëri nga anëtarët e familjes së tij nuk ishte në marëdhënie pune. As një burim të të ardhurave, përveç bujqësisë e cila edhe ashtu nuk luante ndonjë rol të veçantë, nga se toka në Drenicë në përgjithësi nuk është e cilësisë së lartë prodhuese. Familja e Tahirit ishte shtuar, po ashtu ishin shtuar edhe shpenzimet e përditshme. Kishte ardhur koha që edhe Tahirin ta martonin. Po martesë donte edhe shpenzimet e veta. Pushteti jugosllav e përdorte me mjeshtëri edhe këtë formë të luftës psikologjike. Kundër shqiptarëve, posaçërisht kundër familjeve të caktuara, që nuk i bindeshin atij, në mënyrë që t'i nënshtronte me varfëri! Duke ushtruar sanksione ekonomike. Për ish-pushtetin, varfëria, ishte mjeti, me anë të së cilit, shqiptarët i detyronte të bënin luftë për ekzistencë. Tahir Meha krahas kësaj lufte, përgatitej edhe shpirtërisht për të sfiduar edhe këtë strategji. Përkundër vështirësive, ai kurrë nuk u ligështua. Punonte e këndonte. Shtinte me armë dhe thoshte: "Këndoni burra se bota është jona. Bëhuni të fortë se vetëm kështu do të triumfojmë mbi të gjitha. Pasuria nuk është gjithçka. "Megjithatë një dorë

shqiptarësh të mjerë ishin bërë urë kalimi për qëllime të ulëta përfitimi. Po ç' i duhet njeriut që të jetojë duke e ngrënë bukën me turp?...

Kështu kalonin ditët. Tahiri në saje të punës së palodhshme arriti që të stabilizohet paksa ekonomikisht dhe pas ca kohe u fejua. Të gjithë u gëzuan që ai e kishte gjetur vajzën e ëndrrave të tij. Ai u fejua me vajzën e Zenel Hotit nga Palaci i Hasan Prishtinës. Familja Hoti ishte e nderuar jo vetëm në Palac, por edhe më gjerë.

Nebihu nuk e fshihte dot gëzimim e madh ngase e kishte fejuar të birin e tij më të vogël. Nuk kaloi as viti dhe Nebihu po përgatiste dasmën e madhe për Tahirin. U thirrën burrat në zë të Prekazit e të fshatrave përreth, miq e dashamirë. Plasi vallja e ahengu. Kënga e çiftelia nuk pushonin deri në mengjes. Gëzimi përcillej me të shtëna armësh dhe sikur në ditët e mira, po ipej sihariqi i një martese të re, e cila do ta gëzonte konakun dhe do ta shtonte familjen Meha.

Kalonin vitet e jetës bashkëshortore fare qetë. Tahirit i lindën vetëm vajza. Ai kishte dëshirë për ta pasur edhe një djalë, pra trashigimtarin e vet. Kjo brengë e bëri që të martohej rishtazi. Edhe nga martesa e dytë, Tahirit, i lindën vetëm vajza! Ishte i vetëdijshëm se kishte bërë një padrejtësi ndaj bashkëshortes. "Ja që e bëra, – thoshte shpesh, – sepse unë një ditë do të shkoj. Dëshiroj që mbrapa ta lë një djalë, i cili kur të rritet, do të dijë ta luajë çarkun e hutës dhe të luftojë me pushtuesin në këmbën time" ... Kjo dëshirë Tahirit nuk iu plotësua. Ai edhe pse la mbrapa pesë vajza le të flejë i qetë. Djemtë e UÇK-së e shkrepën çarkun e hutës kundër pushtuesit serb. Edhe në emër të "djalit" të Tahir Mehës! Ata ia çuan në vend dëshirën e tij, ngase të gjithë ata që morën pjesë ndër beteja, ishin bij dhe bija edhe të Tahirit.



Emin Lati (gypsy), Nebih Meha (babai) dhe Tahiri

TAHIRI DHE JETA E TIJ NË KURBET

Të gjithë e dinim se ç' ishte kurbeti, se sa e hidhur ishte buka e kurbetit. Mirëpo, shumë nga ne (në kohë dhe në mënyra të ndryshme), të shtyrë nga skamja dhe terrori e përjetuam jetën e kurbetit. Kjo plagë e rëndë, si shumë popuj të tjerë, e ka goditur rëndë edhe popullin tonë. Për kurbetin, për jetën dhe bukën e hidhur të tij, ka këngë, vjersha, filma e vepra të tjera arti, ndër të cilat meritojnë të përmenden: "Lëndinë e lotëve", "Mitrua" e Çajupit, "Kur e përcolla Ylberin" , "O kurbet, kurbet i zi" etj. Shumë nga Shqiptarët, që i rrëmbeu kurbeti, nuk u kthyen më kurrë në tokat e veta stërgjyshore, mbetën përtej "Urës së Qabesë" dhe nëpër vende të tjera të botës. Ky fat tragjik na përcolli ndër shekuj. Ky fat po e priste edhe Tahir Mehën!

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, shumë shqiptarë morën rrugën e kurbetit qoftë për shkaqe ekonomike, qoftë për shkaqe politike. Këta dy faktorë, që janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, pushtuesi serbo-jugosllav po i ushtronte mbi shqiptarët me program dhe me të gjitha mjetet e veta tanimë administrative! Mospranimi i tyre në punë, madje përjashtimi nga puna edhe i atyre pak shqiptarëve që ishin të punësuar, taksat e rënda, që

çdo ditë i shtonte pushtuesi, tatimet etj që popullit tonë po ia bënin jetën të padurueshme. Nga kjo dhunë politiko-ekonomike, sa vinte e shtrëngohej zinxhiri i varfërisë. Sa më shumë që shtrengohej ky zinxhir, aq më të forta ishin dhembjet, të cilat, në veçanti ndiheshin tek të rinjtë, që po i përpinte rruga e kurbetit për ditë e më shumë. Kërkesat e jetës dhe ëndrrat e çdo njeriut për të bërë diçka më tepër për veten dhe familjen, ishin të arsyeshme. Mirëpo sanksionet politike dhe ekonomike i pamundësonin ato që të realizoheshin në vend. Jo rastësisht, që nga kohët e lashta, kishte mbetur edhe fjala e urtë popullore, që nënkuptonte rrugën e gjatë të kurbetit: "Mashkulli nafakën e ka në këmbë!" Kjo rrugë iu imponua edhe Tahir Mehës. Që të jetonte vertikalisht e me nder, atij iu desh që të gjente një zgjidhje të përkohshme për ta mëkëmbur ekonominë e familjës së vet. Për ta realizuar një gjë të tillë, Tahiri nuk shpresonte në fantazi "bingosh", por në punën e tij të pandërprerë dhe të ndershme. Kur prindërit e Tahirit e kuptuan këtë i thanë që të mos shkonte. Ai u premtoi se s'do të rrinte gjatë dhe do të kthehej posa të fitonte ca lekë. Dhe vërtet Tahiri e mbajti fjalën. Punoi në disa vende si: në Mal të Zi, në Maqedoni, në Slloveni dhe në Austri. Pas disa vitesh, aty nga fund i viti 1979, përfundimisht u kthye në shtëpi.

Si për të gjithë edhe për Tahirin kurbeti ishte jetë e rëndë. Kurbetçarët e ndienin thellë mallin për atdheun e vet, për më të dashurit e vet, për gurët dhe shkurret e vendlindjes, për shokët dhe miqtë e për kë jo tjetër. Ata punonin që nga mëngjesi e deri në mbrëmje. Bënin punë të rënda që të siguronin ndonjë lekë për t'ua dërguar në atdhe, ku pritnin prindërit dhe fëmijët. Tahir Meha, i cili i perjetoi rëndë ato vite që ia fali kurbetit, mësoi shumë nga pervoja e jetës në dhe të huaj. Ai pati rastin të takojë shumë kurbetçarë që ishin me vite atje dhe të mësojë prej tyre.

Në të njëjtën kohë edhe ata mësonin nga ky kurbetçar i ri që bartte një bagazh të pasur historik dhe të realitetit kosovar. Pas ca viteve, të gjithë shokët e tij që kanë punuar me të, sidomos ata me të cilët ka punuar në Austri me simpati e respekt të veçantë rrëfejnë për Tahir Mehën: "Punonim bashkë. Tahiri ishte i ri dhe i fuqishëm, djalë i urtë e fjalëpak. Ishte ekonomist i fortë. Bisedonim shpesh në ato baraka druri ku banonin zakonisht punëtorët. Ishte shumë parimor dhe vizionar. Gjërat i thoshte krejt pa ngurrim. Bisedat e tij shpesh na shqetësonin, por njëkohësisht guximi i tij na mahniste. Tahiri na thoshte: "Vëllezër, ta duam njeri-tjetrin, se këtu jemi në vend të huaj. Ne duhet të përkujdesemi për shokët tanë në mënyrë që të përfitojmë të gjithë dhe të kthehemi shëndoshë në shtëpitë tona. Ai na porosiste që të mos binim pre e shërbëtorëve të klubeve të Jugosllavisë të cilat i organizonte ambasada e Beogradit. Hapur na thoshte se Jugosllavia për ne është pushtuese, ndërsa ambasada jonë është ambasada Shqiptare, të cilën duhet ta duam e ta vizitojmë!" Kështu i kujtojnë sot shokët bisedat e tij. Tahiri vazhdimisht e mbante flamurin shqiptar te koka, në dhomën ku flinte. Kur i lexonte gazetatat, shpesh na thoshte si me shaka: "Kur do të luftoj unë me Jugosllavi, do të shkruajn tridhjetë gazeta!" - Ne qeshnim, por me të vërtetë, më 14 maj të vitit 1981, ato gazeta shkruan, se Tahir Meha luftoi me Jugosllavinë dhe ne qeshëm,por edhe qamë bashkarisht!" ...

Shokët e kurbetit tregojnë: "Tahiri përgatitjes për luftë i kishte hyrë me një besim dhe me një vendosmëri të plotë. Kjo përgatitje ishte faktori kryesor që e detyroi armikun që ta pranonte kapitullimin moral në oborrin e kullës së Tahirit, mu në zemër të Prekazit. Ai për çdo mbrëmje lëshonte kasetofonin me këngët e tij të preferuara nga Dervish Shaqa dhe këngët për kreshnikët e Mujit e Halilit. Në folklorin tonë Tahiri po shihte

filozofinë e një përshkrimi të rrallë që rapsodi po i bënte heroit dhe ngjarjes së madhe historike. Në to ai njihej me një realitet sa të hidhur për të kaluarën tonë historike, por në të njëjtën kohë aq edhe stoike, dinjitoze e krenare. Aty shihte se si shqiptarët në beteja e në luftëra kurrë nuk e humbën dinjitetin kombëtar, vendosmërinë e guximin për ndeshje të reja në rrugët e lirisë. Tahiri shpesh thoshte: "Baco-o, historia jonë është histori luftërash e përpjekjesh për liri. Kjo histori i ka pranuar në gjirin e vet vetëm ata të cilët u futën në portat e saj me tërë fuqinë e vet në shërbim të atdheut. "Pas pohimeve të këtilla shpesh shtonte: "Unë do të ha barot me dhëmbë! Do t'ia kaloj edhe Mujit e Halilit," – dhe ia japte me gjithë shpirt së qeshurës së tij karakteristike. Aq i thjeshtë e i afërt ishte me shokët e tij Tahir Meha, i cili me humorin e tij të veçantë të bënte shpejt për vete.

Tahiri kishte dëshirë të zjarrtë për armët. Që atëherë ai filloi të furnizohej me to duke i sjellë nga shtetet ku punonte. Ai e donte armën, por e donte edhe këngën e humorin. Pa dyshim e donte edhe jetën, por më tepër e donte lirinë, së cilës pa u kursyer do t'ia falë jetën.

Të gjithë shokët e Tahirit që patën rastin të punojnë me të në kurbet, në kohë dhe në vende të ndryshme, ruajnë edhe sot kujtimet më të mira për të. Tahiri e dinte përse punonte. Në një kohë kur dikujt i dukej krejt provokative, ai shpesh u thoshte shokëve: "Blini armë dhe ruani mirë! Armët e sjellin lirinë. "Vërtet ai u mishërua me pushkën e tij e cila u bë lajmëtare e parë e fillimit të një lufte, që shqiptarët, herët a vonë, do të duhej ta bënin për lirinë e vet, ashtu siç e bëri Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

TAKIMET DHE BISEDAT E TAHIRIT ME MIQ E SHOKË

Që nga koha e gjyshit të tij, kulla e tyre ishte një vendtakim për trimat e kohës. Aty merreshin vendime të mdha. Këtë traditë tradicionale e kombëtare e kishte vazhduar edhe Nebihu dhe tani po e vazhdonte Tahiri. Aty disa herë ishin takuar shokët e Tahirit, madje edhe atdhetarët e shquar si Zeqir Gërvalla e Selman Berisha. Këta dy të fundit fillimisht ishin njohur me axhën e tij Mehmet Mehën në kazamatet e Serbisë. Ishin njohur atje ku janë njohur qindra atdhedashës të kohës, të cilët, më vonë, kanë vënë ura miqësie duke e zgjeruar rrethin e veprimit në shërbim të atdheut. Ata Tahirit i dhanë shtytje morale për çështje madhore të atdheut. Janë të shumta takimet që Tahiri kishte pasur me këta dy atdhetarë të dëshmuar në kullën e vet. Prej tyre ai kishte mësuar shumë. Ishte përgatitur edhe më tepër, madje qëllimet e tij drejt përpjekjes për çlirimin e atdheut ishin qartësuar edhe më. Tahiri vetë e thoshte më vonë: "Përvoja e jetës fitohet nga ata të cilët kanë përjetuar më shumë në jetë" . Nga takimet e shumta që i kishte pasur me shokët e vet, ai sikur ishte brumosur dhe fuqizuar edhe më. Pa dyshim i frymëzuar edhe me idetë e rilindësëve tanë për një Shqipëri të lirë e të

bashkuar, të ngritur e të përparuar ai u përkushtua me tërë fuqinë e vet, duke qenë i vetëdijshëm se nuk arrihet lehtë dhe brenda natës.

Tahiri ishte përpjekur për ta zgjeruar rrethin e vet sa më shumë. Ishte i ndërgjegjshëm, se në kohën që po vepronte, e kishte të veshtirë që të gjente bashkëveprimtarë, ngase ato vite ('75 – '80), pushteti serbo-sllav e kishte vënë në gjumë pjesën më të madhe të shqiptarëve. Si të thuash njerëzit kishin filluar që ta gënjenin veten e tyre se çështja e Kosovës tani do të avancohej më shumë. Këtë hile, mjerisht, e kishin gëlltitur edhe shumë nga intelektualët tanë! Tahiri e kishte kuptuar këtë realitet të hidhur, andaj po vepronte dhe thoshte: "Unë e di se nuk është e lehtë, por dalëngadalë, për ditë e nga pak, këtij hyqymeti duhet t'ia thyejmë nga një hu gardhi deri sa ta rrëzojmë krejt. Ne ta bëjmë tonën e të tjerët do ta çojnë punën tonë më tutje. "Nga ky parim u udhëhoq Tahiri, kur rezistoi me Nebihun. Ata atë ditë luftuan të vendosur. Përkundër lutjeve të shumta që iu bënë nga pushteti, as që u shkoi ndërmend që të dorzoheshin. Troç i thanë pushtuesit: "Jo, ne nuk i dorzohemi shkajaut. Edhe pushkët tona, si edhe tuajat, dinë të vjellin zjarr!" Tahiri nuk kishte folur kot, nuk kishte vepruar kot, nuk ishte armatosur kot, nuk e kishte urrejtur kot pushtuesin. Tahiri nuk luftoi kot, këtë e vërtetoi koha katërcipërisht.

DASHURIA E TAHIRIT PËR ARMËT

Tahiri kontaktet e para me armën i kishte pasur fare në moshë të re. Dashuria për armët ishte traditë e trashëguar nga gjyshi e pastaj edhe nga babai. Ata shpesh i kishin folur për kohërat e mëparshme. I kishin treguar se si në kullën e tyre vinin me armë të ndryshme shumë burra të asaj kohe. "Ata kur hynin në kullë, së pari i virnin pushkët në mur, ku ishin gozhdët e ngulitura enkas për armët. Pastaj i hiqnin koburet nga brezi dhe uleshin ngadalë. I zoti i shtëpisë i urdhëronte që të rrinin lirshëm. Ata ishin në besën e të zotit të konakut. Luftë mund të bëhej, por mysafirët nuk mund t'i ngiste kush deri sa ishin në konak. Këtë duhet ta mbash mend mirë djali im!" – si gjyshi i thoshte sa e sa herë edhe babai i tij, Nebihu, i cili e vazhdonte me pasion rrëfimin. – "Pastaj shërbeheshin me duhan e kafe. Kërciste muhabeti deri në orët e vona të natës. Kishte shumë raste (sidomos netëve të dimrit), kur ata këndonin këngë për trimat e kreshnikët, luanin "kapuças" , "lojën me filxhana" etj. Ata e gjuanin njëri-tjetrin me këngë e romuze. Talleshin bukur e çiltër, qeshnin shpirtërisht, ishin trima bujarë e të thjeshtë sa që kënaqeshe duke i dëgjuar e duke i shikuar. Po biseda më e dashur për ta, ishte për armët. Bisedonin se cili e kishte pushkën,

apo koburen më të mirë, arma e kujt po shtinte më mirë, cila kishte fuqinë më të madhe etj. Thoshin se koburja e filanit ishte e mbeshtjellë me serm! Dhjetëshja e filanit ishte me dorëza briri. Pastaj flitej për pushkën e gjatë të Mretit, për "belgjikun" e gjatë e për "martinën e kuqe". I vinin në pah karakteristikat e armëve, duke thënë se filani e kishte një mauzer me një dru të verdhë si këmbë sokoli, e kishte një "taliankë" që e shpojke lisin, tjetri e kishte një pushkë gjermani që i kish hak tri lira ari etj. Ata shpesh edhe gjuanin në shenjë, duke i provuar armët e tyre. Këto tregime të gjyshit dhe të babait të tij Tahiri shpeshherë jo vetëm i kujtonte, por edhe i përjetonte. Ani pse ato ngjarje kishin ndodhur në kohë të ndryshme, ai e ndiente veten si personazh të tyre. Tahirin thjesht i pëlqente të ishte si Azem Bejta, si Mic Sokoli, si Sefë Koshrja, si Oso Kuka e plot trima të tjerë që kishin zënë vend nderi në historinë tonë. Për Tahirin, ata ishin idhuj.

Tahiri, kishte pasur rastin qysh si i ri që të mësonte shumë për armët, për kujdesin ndaj tyre, natyrisht për sjelljen me to. Ai sa herë kishte dëgjuar nga gjyshi i tij dhe të jerët se: "Me armën duhet pasur kujdes, ngase atë e mbush shejtani një herë në vit!" Pra ata kujdeseshin që të mos vritej dikush gabimisht. Nga bisdedat e tyre dilnin këshilla e porosi të qarta, si për Tahirin dhe për mbarë brezin e ri: "Tytën e armës mos ia kthe askujt, qoftë edhe nëse ajo është e zbratur". "Arma një herë në vit kercet vet!". "Nëse ia kthen armën dushmanit, mos e fut më në brez pa e shkrepur". "Arma nuk dorëzohet për së gjalli". "Për të nuk duhet të dijë as gruja!". "Arma nuk koritet para anmikut!". "Armën duhet mbajtur pastër". "Me armë mbrohet shtëpia, rob e fëmija". "Me armë fitohet liria!" etj. Nga këto këshilla e porosi, pos tjerash, mësojmë se shqiptarët jo se i kanë mbajtur armët nga dëshira, por se në armë kanë gjetur mbrojtjen e vet

personale, familjare dhe kolektive. Me armë është mbrojtur dinjiteti, nderi dhe kombi. Me armë është mbajtur gjallë rezistenca shekullore, në radhë të parë për të mbijetuar e më pas për ta fituar lirinë e cila na ka munguar gjatë. Pra arma për shqiptarin ka paraqitur mbrojtjen e tij, sigurinë e tij, ka paraqitur drejtësinë, ligjin. Arma për shqiptarin ka qenë prindi dhe fëmija i tij. Mbështetja në armë ka qenë shpresa e tij e vetme për t'i realizuar të drejtat. Arma për shqiptarin ka qenë thjesht institucion, ngase shqiptarët nuk i kanë mbrojtur institucionet ndërkombëtare e as ato vendore, ngase ishin institucione të pushtuesit të cilat kishin për synim nënshtrimin e shqiptarëve, por jo kurrë edhe mbrojtjen e tyre. Duke i pasur të gjitha këto parasysh, Tahir Meha, i përkushtohet furnizimit me armë dhe dashurinë për armën vendosi ta përcillte edhe te bashkëkohanikët e tij dhe te gjeneratat e reja.

MË KUJTOHET...

(Pjesë nga ditari)

Isha i ri. Në kullën tonë u shërbeja me kafe apo çaj mysafirëve që vinin. Në kullë na vinte shpesh edhe Nebihu me të bijtë: Tahirin dhe Beqirin. Herë-herë ai vinte edhe me Bajram Zenën e të tjerë. Ata zakonisht vinin mbrëmjeve të vona të dimrit. Sa hynin brenda i virnin armët në gozhdë, pastaj hiqnin koburet nga brezi dhe i fushnin nën jastëk. Ndonjëri e mbante para vetes koburen, së bashku me takëmin e duhanit, si qelibarin, kutinë, çakmakun, të cilën e miklonte lehtë me dorë. Këtë veti e ka pasur edhe Adem Jashari, komandanti legjendar, i cili për aq sa i miklonte mustaqet krah më krah, po aq i miklonte edhe armët e tij!

Kam përshtypjen se trimat lindin të tillë, të tillë e kanë fatin dhe vetëm ata ulen këmbëkryq në sofrën e historisë.

Është interesant të ceket se gozhdët, apo varëset e armëve duhej të ishin të ngulitura për nga lartësia në masë të barabartë. Nuk guxonte që një armë të qëndronte më lartë dhe tjetra më poshtë e varur, sepse "koritej" arma! Është e mahnitshme, sa respekt i ka kushtuar shqiptari armës së lirisë ndër shekuj! Ata provonin ndonjëherë të shtinin edhe në shenjë.

Në kullë, një ditë, kishin ardhur, Tahir Meha, Beqir Meha, Ramadan Zeneli e Sherif Musliu. Aty ishte edhe djali i axhës tim Bislimi. Ata kërkuan të vinin një shenjë për të parë se cila

armë do të ishte më e saktë në qitje. Ishte viti '76. Para dritares së kullës, në një largësi prej rreth 400 metrash, ishte një dardhë e trashë qe ne e quanim: "Dardha Shavarine". Mua ma dhanë një rrip brezi dhe një letër të bardhë. Letrën e ngjita në trup të dardhës, ndërsa mbi të vura rripin e gjerë nja tre-pesë cm, i cili dallohej lehtë mbi letrën e bardhë që shërbente për shenjë. Filluan të shtinin. Nuk ishte e lehtë të goditej caku. Tahiri tha: "Ma lini mua burra dhe shihni se si qëllohet shenja. "E mori pushkën. E shikoi shenjën përmes shënjestrës. U ndal dhe mori frymë thellë. Më pas i vuri plumbin në tytë dhe e përqëndroi sërish shikimin përmes shënjestrës në shenjë. E tërhoqi këmbëzën e pushkës dhe i dha zjarr. Shkova të dardha dhe e mora rripin me vete. E kishte goditur mu në mes. U ul dhe u tha të pranishmëve: "Besa nuk guxon të më rrej as syri e as pushka, se që të dy i dënojnë," – dhe shpertheu gazit.

Një pjesë e familjës sime për një kohë ka jetuar në Tamnik të Mitrovicës. Tahiri na vizitonte shpesh edhe atje. "Në një rast, duke u kthyer nga Mitrovica, – tregonte babai im, – kishim hipur në një qerre kuajsh, tip arabaje dhe po udhëtonim në drejtim të Skënderajt. Te vendi i quajtur Faqja e Lëmurit, milicia i kishin vënë pusi Tahirit. I diktoi me kohë. Kërceu nga qerrja dhe u ngjit përpjetë Faqes së Lëmurit. Kur arriti në majë, nxori koburen nga brezi dhe ia shkrepiti tri herë përpjetë duke brohoritur: "O-o-o, nuk çarmatoset i gjallë Tahir Meha, jo ore-e-e! ..." Milicët nuk kishin guximin ta ndiqnin, por kishin filluar që ta kërcnonin të zotin e qerres dhe babain tim, duke ju thënë: "Kush ishte ai që e kishin pasur në qerre, se do t'ju arrestojmë nëse nuk tregoni?!" "Besa ju e dëgjuat më mirë se ne kush ishte, po lernani rehat në punët tona," – ua kishin këthyre këta. "E ai ja ku është. Shkoni dhe kapeni po deshët!" "Ikni!" – i kishte urdhëruar njëri nga milicët duke i kërcnuar.

FISNIKËRIA E TAHIR MEHËS

Përkundër të gjitha rrëfimeve për luftën e shumë trimave dhe për ashpërsitë e jetës, përkundër rrëfimeve për luftën e gjyshit dhe të babait, që Tahiri i kishte dëgjuar qysh në rininë e tij të hershme, përkundër persekutimit që kishte përjetuar ajo familje, burgosjes së vëllait dhe përkundër kurbetit të rëndë e vështirësive të tjera, Tahiri kishte mbetur njeri me botë të pasur shpirtërore. Vështirë është të gjendet ndonjë njeri si ai, i cili do ta ruante qetësinë e tij të brendëshme shpirtërore, ndjenjat humane, dhe sensin për humor, ashtu siç i kishte ruajtur Tahir Meha. Me gjasë këtë forcë dhe botë fisnike shpirtërore, e kishte trashëguar nga i gjyshi që kishte qenë i tillë. Si i tillë, ai që herët, pa u hamendur për as një çast, u rreshtua me luftëtarët e lirisë për vite të tëra.

Nuk ka gjë më fisnike se kur njeriu jep gjithçka prej vetes së tij për atdheun e vet. Gjithçka nga vetja dha edhe i ati i Tahirit, edhe i vëllai i tij, Beqiri, i cili jo vetëm vuajti dënimin me burg për veprimtari politike, por hyri edhe në radhët e UÇK-së, ku ra me pushkë në dorë. I tillë ishte edhe Tahir Meha, njeri që solidarizohej me të shtypurin, për t'i dalë në ndihmë dhe për ta ngritur në luftë kundër së padrejtës. Tahiri i çdoherë i ndihmonte


shokët e vet në punë. Ai me dëshirë solidarizohej me të varfërit. Shpesh ndodhte ta merrte përsipër që t'ua zgjidhte atyre ndonjë problem, kur nuk u përgjigjej ndonjë i „madh”, për çështje borxhi, ngatërrese apo ndonjë hall tjetër.

Është interesant dhe me rëndësi që të përkujtohet një episod, nga jeta e Mursel Delisë. Ia çojnë Murselit një thirrje për t'u paraqitur në xhandarmëri, që ishte me qendër, në Kishën e Deviqit, afër Llaushës (kjo kishë kishte luajtur rolin e kasaphanës për shqiptarët në të gjitha kohërat). Mendohet mirë e mirë se ç'të bënte. Po të mos shkonte do t'i duhej të hynte në luftë me xhandarët, të cilët pa dyshim se do ta rrethonin. Të shpërngulej për në Turqi, nuk bënte, nga që kjo ishte edhe dëshira dhe qëllimi i Serbisë. Në fund vendosi që të shkonte në Deviq. Duke kaluar pranë lagjes Mehaj, takohet me gjyshin e Tahirit. Pasi që përshëndeten mes vete, Murseli i tregon hallin. Emini i thotë: "Prit pak këtu. " – Shkon në shtëpi, e merr pushkën dhe i thotë Murselit: "Qe besa e shqiptarit, nuk të lashë vetëm!" – Sado që Murseli përpiqet ta ndalë, nuk ia arrinë dot. Shkojnë në Deviq. Xhandarët kur e shohin Eminin të armatosur fillojnë të bëjnë mend se sa veta të tjerë të armatosur mund të ishin të fshehur në malin e afërt. Atëherë i thonë: "Mursel ne të kemi ftuar që të meremi vesh që tani e tutje të rrini urtë dhe që ta ndertojmë paqen se mjaft kemi luftuar" – dhe pas nja dhjetë minutash e kishin liruar! A mund të ketë gjë më fisnike se gatishmëria e njeriut për t'u sakrifikuar për shokun, për bashkëkombasin, për atdheun? Këtë mund ta bëjnë vetëm njerëzit e mdhenj siç ishin ata të familjes Meha e të familjes Jashari.

Pa dyshim se Tahiri kishte marrë shumë nga kjo edukatë familjare. Familja atij i kishte dhënë një bazament të fortë që solidaritetin, në rrethana të reja, ta perfeksiononte deri në shkallë

të sakrificës së vetëdijshme. Tahiri nuk deshë ta njihë e as t'ia dorëzonte armët pushtuesit serb, të cilët nuk iu kishin nënshtuar as gjyshi, as babai e as vëllai i tij. Ai nuk u luhat kurrë para provave të mëdha dhe para pengesave të shumta që i dolën në rrugët e jetës. Tërë jetën e vet u solidarizua me të shtypurin, me të varfërin, me hallexhiun. Ky ishte Tahir Meha shpirtmadh, Tahir Meha fisnik, i cili edhe po të kërciste pushka, siç thonë, në të katër anë, nuk të linte asnjë herë vetëm. Ai të jepte kurajo dhe të këshillonte për të mirë. Shpesh u thoshte burrave të Drenicës se na duhej shkollimi dhe dituria. Për rëndësinë e femrës drenicake, ua kujtonte atyre rolin e femrave tona që kishin zënë vend në histori. Ua kujtonte mbretëreshën Teutë, që kishte udhëhequr shtetin edhe në luftë, Norën e Kelmendit, që kishte vrarë pashanë, mandej Tringën, Shotën, Ganimeten, Margaritën, Iben e të tjera, që krahas burrave kishin luftuar për liri. "E sot, ku është femra jonë, në veçanti femra drenicake?!" – përfundonte ai duke i thëlluar rrudhat në ballin e tij të gjerë. Mbase kështu Tahiri në thellësitë e shpirtit të tij e kishte ëndërruar një femër, si figurat e lartëpërmendura, që ta kishte jo vetëm grua, por edhe bashkëluftëtare e bashkudhëtare në ëndrrat e jetës së tij. Mbase. . . , por ja që nuk bëhej çdo gjë sipas dëshirës. Shqetësimi që s'po e linte një trashigimtar ishte i madh, sepse mirë e dinte se rruga e jetës së tij nuk ishte kopsht me lule, por. . . Kjo e rëndonte në shpirt. Ishte i vetdijshëm, se për ta pasur një djalë, të cilin nuk e pati kurrë, duke u martuar me dy gra, i kishte bërë padrejtësi bashkëshortes së tij, që e respektonte shumë. Edhe pse asnjëherë nuk ankohej, kjo e mundonte. Kur dikush e prekte në këtë plagë, ia kthente: "Edhe Azem Bejta i ka pasur dy gra dhe nuk la djalë mbrapa, por Kosovës i la emrin dhe historinë e luftës për liri. Po ne, burra, çdo t'i lëmë Kosovës?" – Ishte pyetja më brengosëse e këtij

trimi, e këtij e atdhetari, që për ta parë Kosoëvën të lirë, u bë theror, iku nga kjo botë, që si të thuash ende pa e shijuar si duhet, me vetëm 38 vitet e jetës. Iku nga kjo botë me brengën që nuk la djalë, por i qetë se mbrapa la kushtimin e armës lirilajmëruese, la shokët, pasuesit e tij, që i hapën rrugën asaj pranverë të bukur studentore, asaj pranvere të madhe që erdhi me shumë lule për dëshmoret e Kosovës e se bashku me ta edhe për Tahirin!



Tahir Meha

TAHIRI E URRENTE PUSHTUESIN DHE SHËRBËTORËT E TIJ

Padyshim se shkalla e vetëdijes dhe përkushtimi patriotik janë dy faktorë që luajnë rol të madh në përcaktimin e individit për të luftuar për lirinë e atdheut. Tahiri i plotësonte shumë mirë këto dy kushte. Atë bagazh të pasur kombëtar, që e kishte trashëguar nga të parët e tij, diti shumë mirë ta shfrytëzonte e ta zbatonte në kohën kur ai veptoi. Urrejtjen dhe përbuzjen për pushtuesin, ai i përdorte si levë strategjike të veprimit të mëtutjeshëm. Urrejtja e tij nuk mbështetej mbi baza racore, përcaktimi kombëtar, apo profesionale. Jo, ai e urrente robërinë, padrejtësinë, e urrente pushtuesin që atë dhe mbarë popullin tonë e kishte vënë nën prangat e robërisë. Urrejtja e Tahirit ishte pasojë e të gjithë shqetësimeve padrejtësive që përjetonte populli ynë, ishte pasojë e vuajtjeve dhe maltretimeve të familjes Mehaj, që si shumë familje liridashëse ishte nëpërkëmbur prore nga pushtuesi. Burgosjet e qindra atdhetarëve, shtypja me dhunë e demonstruesëve të '68, '81, vrasjet e shumta, plagosjet, arrestimet dënimet. . . , që ishin bërë pjesë e jetës së përditshme, ia shtonin edhe më shumë urrejtjen Tahirit, kundër shkaktarit,

në rastin konkret kundër pushtuesit dhe shërbëtorëve të tij. Të gjitha këto padrejtësi ai i përjetonte rëndë, por në veçanti, më rëndë e përjetoi dhunën e vitit '81. Për këtë urrjetje Tahir Mehën, milicia po e ndiqte hap pas hapi. Donte ta arrestonte. Për të mos rënë në dorë, kishte vitin që kishte dalë si ilegal në mal. Vujtjet nuk e mundonin, por e mundonte brenga që nuk ishte i pranishëm në ato demonstarta të mëdha që ishin drejtuar kundër pushtuesit që ai e urretne me shpirt. Tahri priste me padurim që kjo lëvizje të shkallëzohej në një luftë të armatosur, ku e shihte veten ushtar të saj.

ISHA STUDENT

(Pjesë nga ditari)

Kisha marrë pjesë vazhdimisht në demonstrata. Të paktën isha munduar që të isha prezent kudo. Me Tahirin u takova diku rreth 4 apo 5 prillit në një mal mbi Mehajt. U përshëndetëm dhe u ulëm pranë një gardhi. "Nuk të lëshoj, -më tha, – pa më treguar për të gjitha ato që po ndodhin. "I interesonte për çdo gjë, madje në imtësi. Donte të dinte si ishin zhvilluar ngjarjet. A kishte shumë të vrarë e të plagosur. A kishte shumë të arrestuar. A po solidarizoheshin qytetarët me studentët. A kishte shtënë në demonstrues veç milicisë edhe ushtria jugosllave? Pyeste se si janë sjellë milicia shqiptare me studentët. Ai kishte dëgjuar edhe për rastin „Delibashiq!" (Delibashiqi nga dritarja e shtëpisë së tij kishin shtënë me armë mbi demonstruesit dhe kishin vrarë dy studentë). etj. Kishte dëgjuar për përkujdesjen e shërbimit mjekësor ndaj demonstruesve, për pjesmarrjen e femrës shqiptare krah burrave dhe për rolin aktiv të saj, etj. Kur mësoi për të gjitha këto, mori frymë thellë dhe tha: "Po që besa, ka trima Kosova ore!" – dhe e shtrengoi fort mauzerin e tij sa iu skuqën gishtat e dorës.

Në shpirtin e Tahirin kishte zënë vend dashuria e madhe për atë lëvizje të fuqishme dhe urrejtja për armikun shtypës që kishte bërë gjithë ato vrasje e plagosje. Tahiri ishte i prerë:

"Me pushtuesin serb duhet luftuar. Nuk ka rrugë tjetër për ta fituar lirinë. Mirëpo, si do t'ia bëjmë me shërbëtorët e tij? "– shtroi pyetjen për të cilën aty për aty e dha edhe përgjigjen: "Të gjithë ata që me vetëdije janë futur në shërbim të pushtuesi dhe punojnë kundër atdheut të vet, nuk duan më pak se pushtuesi!" M'u duk sikur ato informata që ia dhashë ia lehtësuan shpirtin. Në të ndarë vërjta sikur iu zbeh ca fytyra e tij esmere. Peshën e atij shikimi, që ma drejtoi si kurrë më parë e ndiej edhe sot, njashtu si të shtrenguarën që ma bëri në kryhun tim rinor, duke më përqaftuar kur u ndamë...

EKCESET E TAHIRIT ME PUSHTUESIN

Tahiri po hynte në fazën e veprimtarisë së tij shumë serioze. Ishte shumë i vendosur dhe i paluhatur në arritjen dhe realizimin e aspiratave. Iu kishte përkushtuar qëllimit, prandaj punonte pandërprerë.

Ai ishte i vetëdijshëm se ishte e domosdoshme dhe e shenjtë të luftonte për lirinë e atdheut. Tahiri që e kuptoi këtë shumë mirë, kurrë nuk ngurroi të vepronte natë e ditë pa dashur t'ia dinte për epilogun. Nuk kalkuloi kurrë me gjërat siç i "elaboronin" disa, që lufta ua ka prishur kumbaritë me pushtuesin. Kurrë nuk ra në grackën e atyre, të cilëve edhe sot nostalgjia për atë kohë të "bekuar" ua gërryen mushkëritë. Asnjëherë nuk u pajtua me "filozofinë" se liria do të vinte më shpejt e më mirë sikur të mos luftonin. Ai thoshte prerë e qartë: "Liridashësit nuk e lënë punën në dorë të fatit. Ata me angazhimin dhe guximin e tyre i prijnë fatit që sjell dashurinë mes njerëzve, të drejtën për të jetuar të lirë, paqen dhe mirëqenien. Ata nuk iu besojnë thënieve të kota si: "Zoti e bënë mirë!" Tahiri me shembullin e tij dhe me koburen e tij, sikur edhe paraardhësit e tij, e goditi ëndrrën e gjatë të pushtuesve jugosllavë për Kosovën. Ai u bashkua me ta, që po e zgjonin

popullin tonë nga ai gjumë i rëndë që e kishte kapluar. Demonstratat studentore dhe pushka lajmëtare e Tahir Mehës ishin termeti më i fuqishëm që e goditën në themel ish-Jugosllavinë që nga Lufta e Dytë Botërore e këtej. Nga ky termet ish-Jugosllavia do të shkatërrohet. Kosova do të bëhet varr i pushtuesve serbo-sllavë!

Veprimi konkret i Tahir Mehës filloi me mosbindjen dhe kundërshtimin ndaj organeve të pushtetit, ai thoshte: "Unë nuk e njohë kralin Tito. ai është pushtues për mua. Kështu duhet ta trajtojmë të gjithë ne që e duam lirinë e vendit tonë!" Tahiri tanimë nuk dilte pa armë askund. Kërkesës së milicisë për të dorzuar armët nuk i bindej. Rezistonte me to kur ata i zinin rrugën. Edhe sherbimi i UDB-së e kishte kuptuar seriozisht se me Tahir Mehën mund të flitej vetëm me pushkë! Prandaj nuk guxonin që t'i shkonin në shtëpi për ta kontrolluar. Ata edhe në rrugë tani më nuk donin që të takoheshin me të. Ata tentonin ta kapnin në befasi, përndryshe i bishtonin ndeshjes ballë për ballë me te. Pasi që e kishin vërejtur se më Tahirin nuk i delet lehtë!...

Per ironi të fatit, gjërat ndodhin nganjëherë edhe kunder vullnetit të njerit. Tahiri kurrë nuk kishte dashur që të ketë probleme me shqiptarë. Me këmbëngulje u kishte ikur kurtheve, sado që kishte pasur ndonjëherë edhe provokime po nga vetë shqiptarët e "ndershëm", siç i quante atëbotë Serbia shërbëtorët e saj. Me gjithë kujdesin që Tahiri kishte treguar për t'iu ikur këtyre kurtheve, nuk ishte e mundur. Në fillim të pranverës së vitit 1979, Tahiri ishte duke shkuar në mulli për të bluar drithë me qerre që e tërhiqnin qetë. Rrugës sa nuk e shtypi me gjithë qetë një furgon që erdhi me shpejtësi të madhe. Fatbardhësisht, edhe pse e nxori krejt nga rruga e asfaltuar, nuk pati pasoja serioze. Tahiri ngritet me shpejtësi dhe e shan shoferin e furgonit i cili as që kishte zbritur për të parë se ç'kishte bërë as për të

kërkuar falje! Ai sapo e dogjoi Tahirin, zbriti nga makina duke iu kërcnuar: "A e di ti kujt po i thua a je normal?" Fillon kacafytja. Si përfundim, shoferi i furgonit, që paska qenë i vëllai i kryetarit të komunës së Skënderajt, shkon i rrahur e i përgjakur në Skënderaj.

Nuk u desh shumë dhe u përhap lajmi: "I pabinduri, Tahir Meha, po ngre dorë edhe kundër pushtetit. E paska rrahur edhe të vëllanë e kryetarit!" Fillimisht Tahirin i erdhi keq për këtë, dhe tha: "Dreq o punë, si po më thyhen gjërat në dorë! Kaq shumë po mundohem t'u ik incidnteve, por. . . ! Për më se tre muaj Tahiri nuk zbriti në Skënderaj ku zakonisht dilte ditëve të hëna, kur ishte edhe ditë tregu. Pas tre muajsh filloi të duket rrallë dhe me shumë kujdes, ngase e dinte se do të plaste sherri. Megjithatë njeriu i gjallë duhet të jetojë. Ai kishte nevojë për furnizim me gjëra të përditshme si edhe të tjerët. Është interesant se as organet e sigurimit për këtë rast, Tahirin, nuk i shkuan në shtëpi, as nuk i dërguan ftesë që të paraqitej në milici! Kjo heshtje po e habiste edhe Tahirin. Ata e kishin bërë këtë enkas. Përgatitnin një kurth, andaj donin që edhe Tahiri të besonte se ajo punë ishte harruar.

ARRESTIMI APO KIDNAPIMI I TAHIR MEHËS NË SKËNDERAJ

Ishte pjesa e dytë e vitit 1979. Tahiri kishte dalë në Skënderaj si zakonisht për nevoja të familjës si dhe për ta takuar ndonjërin nga shokët apo miqtë. Si i kujdesshëm që ishte, e vërejti, se atë ditë nuk do të kalonte mirë. Disa civilë po e përcillnin si hije! Ishte mu në qendër të qytetit dhe nuk e kishte të lehtë që të tërhiqej. Në moment grumbullohen shumë milicë dhe e rrethojnë. Shteg për t'u larguar nuk kishte. Të hapte zjarr, nuk ishte moment i përshtatshëm. Nuk u zbraps. Me vendosmëri dhe neveri ua tërhoqi vërejtjen milicëve: "Ju zagarë të Jugosllavisë, mos u afroni se do të gjeni belanë!" Me shpejtësi të madhe erdhi edhe një makinë milicie me forca të tjera shtesë. Filloi përleshja. Ishin mbi 15-të milicë. E sulmuan Tahirin. E përgjakën. E lidhën. E poshtëruan! E rrahen aq keq, mu në qendër të qytetit, para qytetarëve dhe e futën pa ndjenja në makinë. E dërguan në stacionin e milicisë së Skënderajt duke u shfryrë edhe më tutje mbi të.

Ata e kishin goditur Tahirin me grushta, shqelma, shufra gome, me kondakë pushkësh e revolesh... E kishin mbuluar me gjak! Një dëshmitar i rastit kishte thënë: "E rrahën njërin aq

fortë, sa nuk besoj se ka për ta zanë mëngjesi të gjallë! Vallahi, këta milicët tanë janë hallakatë mendsh krejt. Desh e mbyten njeriun. Ai milici serb, veç këqyrke e më dorë nuk e prekte!" Milici serb s'kishte pse ta prekte. Punën e tij po e bënin shqiptarët! Ai po i shikonte se cili nga shërbëtorët ishte më i denjë për shërbime të tilla.

Tahirin e kidnapuan në mes të Skënderajt, pikërisht ditën e tregut, në prani të shumë qytetarëve. Atë e lau me gjak milicia e Serbisë, duke dashur që me këtë "shembull" t'i jepte mend "miletit" se kush e kundërshton pushtetin e Jugosllavisë dhe kush nget organet e tij kështu do ta pësonte! Kështu u kishte thënë milici serb të pranishëmve, sapo e kishin futur Tahirin në makinë, dhe para të gjithëve i kishte përgëzuar milicët: "Bravo momci, idemo!" - që d. m. th. : "Ju lumtë djema, shkojmë!"

Torturat mbi trupin e Tahirit nuk kishin pushuar me kaq. Ato kishin vazhduar për tri ditë me radhë edhe në stacionin e milicisë së Skënderajt. Pastaj për më se një muaj rresht në UDB-në e Mitrovicës, deri në atë shkallë, sa ia kishin thyer edhe brinjët! Tahirin e kishin mbajtur gjashtë muaj rresht nën hetime. E kishin pyetur për të gjitha, që nga gjyshi e babai e deri te i vëllai e nipat. E kishin pyetur se me kë shoqërohej. E kishin pyetur për bisedat, për armët, prej nga furnizohej ai me to. Pastaj e kishin pyetur për jetën e tij në kurbet, me kë ishte takuar atje dhe pse e kundërshtonte këtë pushtet. Në fund fare e kishin kërcënuar: "A e di se ne edhe mund të të vrasim! Të marrim e të qesim në mal në kufi me Shqipërinë dhe themi se të ka vararë roja duke e kaluar kufirin. Të varim e themi se e ka varur veten ngase nuk ke mundur që ta përballosh burgun" etj. Tahirin e torturonin gati çdo natë. Donin ta shkatërronin edhe psikikisht. Megjithatë ai u rezistoi të gjitha torturave me shpresën e madhe se një ditë do të hakmerrej për të gjitha të ligat që po i bënin atij

dhe që iu kishin bërë atdhetarëve tanë më herët.

Pas më se gjashtë muaj hetimesh, në mungesë faktesh të tjera, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, me urdhër të UDB-së, e dënoi me një vit burg, duke e lënë të lirë deri në fuqizimin e lëndës. Tahiri nga burgu doli me shëndet të rrënuar dhe me një dhembje të madhe në gjoks. Iu desh kohë për ta marrë veten plotësisht.

PËR TË GJALLË MË NUK DORËZOHEM

(Pjesë nga ditari)

Befasitë janë interesante dhe të papërseritshme. Po atë ditë që ishte liruar Tahiri nga burgu, jam takuar me të! Nga Prishtina atë ditë pata shkuar në Mitrovicë, prej nga e mora autobusin për në Skënderaj, në të cilin kishte qenë edhe Tahiri, i cili nga burgu po kthehej në shtëpi. Nëse nuk gabohem ka qenë fundi i janarit ose fillim shkurtit të vitit 1980. Derisa isha në autobus Tahirin nuk e kisha vërejtur fare. Sa zbrita nga autobusi, pas pak mora drejtimin për në fshatin Prekaz. Para meje pashë duke ecur një njeri me një valixhe të vogël në dorë. Shikonte herë-herë mbrapa dhe ecte ca si shpejt. E shpejtova hapin që ta takoja, për të bërë një copë rrugë me të. Nga mbrapa i dukej koka e rruar të cilën nga të ftohtit mundahej ta mbronte me jakën e xhaketës. Rrobat nuk i kishte të trasha, për atë stinë të ftohtë dimri dhe ishte pa pallto?! "Kush do të jetë ky vallë?" – thashë, me vete. Veshja jo e zakonshme dhe pamja disi e çuditshme, ma shtoi edhe më tepër kureshtjen. Arrita krejt afër tij dhe e përshëndeta: "A mujte or burrë?" Ai nuk u pergjigj! Kur e pashë mirë në fytyrë, e njoha: "Eh Tahir!" – i thashë me një zë që me doli ashtu pa e kuptuar as vet. Edhe ai me pa dhe si me ndrojtje, duke u kthyer nga unë më tha: "O, ti qenke!" - dhe u përshëndetëm. Ishte ca si vonë dhe sa kishte filluar të

errësohej. "S'të fola kur me thirre – më tha, nga se thashë me vete mos ma kanë lëshuar ndonjë zagar që të më percjellë. E kisha ndër mend që sa t'i kalojmë Jasharajt me të zënë e me të b-a-a...!" – pastaj ia dha gazit me një të qeshur, e cila nuk më ngjau me të qeshurat e tij të mëparshme. . .

Duke e pyetur për ditët e burgut si dhe për përripecitë që kishte kaluar, vërejta se filloi t'i vinte në vend shkëlqimi i fytyrës që i kishte humbur paksa. Vërtet ishte zbehur shumë, mbase nga qëndrimi i gjatë mbyllur në burg. Ia dhashë shallin tim, me të cilin e mbështolli kokën. Ia mora edhe atë valixhe të vogël nga dora dhe vazhduam rrugën. Kishim diku të udhëtonim rreth tridhjetë minuta nëpër rrugën që për tek Mehaj kalonte përmes lagjës Jasharaj. Një baltë e përzier me borë bënte që të na rrëshqisnin këmbët. Ai po ndiente një lodhje dhe nuk po ecte më siç kishte ecur dikur. Ishte tërë mllef. Rreth shtatë muaj hetime, tortura, qeli, ushqimi i dobët, pa rroba, pa shtrojë e mbulojë të duhur, dhe për „shpërblim" dy brinjët e thyer! I kishte humbur forca fizike dhe kondicioni që e kishte patur më parë.

Bëmë ca rrugë. Tahiri nuk po fliste shumë. E kuptova se e kishte të vështirë. Ajo që i kishte ndodhur po e gërryente përbrenda. Dikur më tha: "Ti ndoshta ke dëgjuar se si Tahir Mehën në mes të Skënderajt e kanë mbuluar me gjak!" M'u duk siku nxirrte zjarr nga goja! "S'ka gjë. Është "hyqymet," – i thashë, ngase ai kështu e quante pushtetin. "Hyqymeti, thonë, nuk të korit!" – i përdora këto shprehje pa i peshuar se sa ishin me vend. "Po mor djalë, – ma ktheu, – ai është hyqymet, por hyqymet i huaj e jo yni. Ky të korit dyfish, se është hyqymet pushtues!" Ç'ti thoshja? Biseda m'u ndërpre. Në atë moment po kalonim afër kullës së vjetër të Shaban Jasharit. Ishte errësuar dhe mu në atë çast u ndërpre edhe rryma. Tahiri më pyeti: "A i ke parë këta të Shabanit si janë?" "Mihën Shaban e

shoh ndonjëherë. Ademin më shpesh, nderkaq Hamzën ka kohë që nuk e kam parë". "Këta janë trima dhe burra të mirë, mos harro" - i mëshoi zërit.

Erdhi koha të ndaheshim. Ai po merrte drejtimin e lagjes Mehaj, ndersa unë atë të Nezajve. I zgjata dorën. Hoqi shallin nga qafa dhe ma zgjati. "Mbaje!" - i thashë "Jo, - tha, - në asnjë mënyrë! Tani mbërrina, do edhe dhjetë minuta rrugë. Ty të falënderit për rrugën që e bëmë bashkë. Unë djalo i kisha marrë rrobat e dimrit. Para se të lirohesh, m'i kishin sjellur familja, por ata të UDB-së nuk m'i dhanë. Më thanë: "Kështu ke për të shkuar në shtëpi në mënyrë që të kuptosh se ka hyqymet këtu që të lë «në të linta»! Ja kështu i thanë ata Tahir Mehësdjaloo!" - këtë o-në, sikur e zgjati aq sa i doli mllef. Ma dha dorën, duke më thënë: "Për të gjallë më nuk dorëzohem!" U ndamë me Tahirin. Edhe tani pas sa viteve, sa herë që kaloj aty ku ndahet rruga për në drejtim të lagjes Mehaj dhe Brahaj e Nezaj, më kujtohen fjalët e tij: "Për të gjallë më nuk dorëzohem!" ...Ai vërtet e kishte vendosur për të vdekur, por jo për të hyrë më i gjallë në duartë e UDB-së.

Tahir ishte ndër të rrallët, që i kam takuar në jetë, që flasin me guxim dhe me kohë. Fliste pak dhe krejt natyrshëm. I parashikonte proceset, meqë e njihje mirë realitetin dhe nuk i frikësohej vështirësive dhe rreziqeve. Megjithatë ai jetën kurrë nuk e nënqmonte, përkundrazi ai atë e vlerësonte më shumë nga të tjerët, ngase e maste atë më kandarin e peshës së lirisë.

TENTIMI I DYTË PËR ARRESTIM

Tahiri ju pervesh punëve të shtëpisë të cilat gjatë kohë nuk i kishte prekur me dorë. Priste dhe percillte miq që vinin për ta vizituar me rastin e lirimt nga burgu. Në këtë mënyrë Tahir Meha po i kalonte ditët dhe po i shëronte plagët që ia kishte shkatuar burgu. Disa njerëz të ligj mendonin se ai kishte "mbledhur mend" . Thoshin si nën hundë: "I paska bërë mirë burgu!" Tahiri i dëgjonte këto fjalë, por s'e kishte ndër mend të merrej me ta. Ai e kishte të qartë: punë kishte me pushtuesin dhe me askë tjetër. Nuk merrej me gjepura. Atë nuk e kishin luhatur torturat e rënda e jo më pallavrat e njerëzve të dobët. Torturat në burg ia kishin shtuar edhe më urretjen ndaj pushtuesit. Saherë që i kujtonte ato shfrynte me mlllef: "Ah, pushtues i poshtër! Ah, gjakpirës! Do të vijë dita!"

Tahiri së shpejti solli një armë tjetër në vend të asaj që ia kishte marrë milicia. Pasi u kujdes edhe për ato armë që i kishte fshehur nëpër vende të ndryshme, vendosi të merrej me punët që ishte detyruar t'i ndërpriste për shkak të vuajtjes së burgut.

Pranvera po ndiqte ngadalë stinën e dimrit. Natyra kishte filluar të shpërthente me mijëra ngjyra. Se bashku me të edhe njerëzit po lëviznin më gjallë, më hareshëm dhe më krenar se

kurrë. Diçka po lëvizte, diçka që nuk po shihej, por që po ndihej! Në kopshte, në ara, në fusha...kudo shihej gjallëri ishte pranvera e hershme e vitit 1980. Sa e bukur që është jeta, mendonte Tahiri i magjepsur nga kjo mrekulli, – por aq neveritëse e përbuzëse është ajo kur të mungon liria! Natyrisht se edhe Tahiri e donte jetën, mbase më shumë se të tjerët, por ai nuk e donte jetën e robit, prandaj e sfidonte pushtuesin çdo ditë nga pak dhe në çdo mënyrë të mundshme!

Pranvera ato ditë vërtet po e kërkonte dorën e Tahirit. Duhej mbjellur drithi në ara, duhej punuar kopshti, duhej korrur bari në livadhe, duhej thurur gardhi. . . Duhej përgatitur çdo gjë në atë pranverë, në mënyrë që njeriu punëtor t’i gëzohej vjeshtës që do të pasonte. Këtë po mendonte Tahiri, kur një zë pushtetari e thirri të dera. Tahiri doli dhe e përshendeti. Ngase nuk e njihte e ftoi që të futej brenda. "Jo, ta kam sjellë këtë letër! Duhet ta nënshkruash. " – i tha ai dhe iku. Tahiri e mori letrën dhe e lexoi. I kishte ardhur ftesa për të vajtur në burg, për ta vuajtur pjesën e dytë të dënimit! I shkoi buza në gaz dhe tha me vete: "Pa shih, se çka mendon UDB-ja. Tani kur është vluğu më i madh i punës, kur unë duhet ta siguroj ekzistencën e familjes, do të më ngujojë! Jo!" – tha prerë Tahir Meha dhe e shqeu atë letër copë-copë, duke e flakur tutje si një të ligë të urreyer.

Ditët po kalonin dhe Tahiri po vazhdonte punën e vet pa e prishur fare terezinë. UDB-ja po priste reagimet e para të Tahirit. Ai kohë pas kohe dilte në Skënderaj, koburen e mbante në brez dhe granatat në xhepa. Ishte i vendosur. Datës, në të cilën duhej të lajmërohej në milici të Skënderajt, i kishte kaluar afati ditë më parë. Milicia po bënte plane të reja. Ajo e kishte kuptuar fare mirë se Tahiri nuk kishte "mbledhur mend" .

Me 28 prill, Tahiri kishte zbritur prapë në Skënderaj. Shpejt e shpejt mbaroi ca punë që kishte dhe po ngutej që të

kthehej për në shtëpi. Diku rreth orës 14: 00 i afrohen fillimisht dy milicë dhe i thonë se kishin urdhrin për ta arrestuar. Tahiri i pa dhe pa të keq u tha: "Ikni, se po ju marr në qafë. Le të vijnë të tjerët të më arrestojnë!" Sa pa u mbaruar fjalët, disa milicë të tjerë i nxorën revolet, duke e kërcnuar Tahirin që të mos kundërshtonte se ishte i arrestuar. Tahiri pa e humbur gjakftohtësinë fare u thotë: "Jo, jo, e keni gabim. Mbase ndonjë tjetër po, por Tahir Mehën jo, nuk mund ta arrestoni!" Kërceu shpejt përtej rrugës. Në njëren dorë shtrëngoi revolen, në tjetrën granatën, por nuk shtiu. Milicia, sipas urdhrin të udhëheqësit të tyre, hapi zjarr në Tahirin. Është e papërshkrueshme, tregonin dëshmitarët e shumtë, se si gjithë ata plumba në drejtim të tij, pos njërit që e kishte kapur në këmbën e djathtë mbi gju, të tjerët nuk e kishin qëlluar! "Tahiri, – rrëfenin dëshmitarët, – nuk përkulej, fare nuk ruhej! Qëndronte krenar dhe në këmbë. Thauja se asgjë nuk po ndodhte. Edhe pse ishte i plagosur në këmbë, ecte krejt normal dhe qetë! Kur e mori rrugën për në drejtim të Llaushës dhe u largua ca nga qendra e Skënderajt, disa milicë filluan ta ndiqnin mbrapa me të shtëna. Atëherë Tahiri u pozicionua pas një traktori dhe filloi të shtinte në drejtim të tyre. Milicët ia dhanë vrapit dhe kështu u krijua një pamje sa tragjike aq edhe komike. Milicët që po iknin ngatërroheshin në këmbët e veta. Disave u shkonin kapelat përtokë e disa të tjerë ishin bërë krejt pluhur duke u rrëzuar në të ikur. U hap fjala si era: "Tahir Meha mu në qendër të Skënderajt i ndoqi milicët si lepujt!"

Tahiri u zdorgj ngadalë kodrës mbi Skënderaj, në drejtim të Llaushës. Mbrëmjen e kaloi në Klinë të Ulët te familja e Imer Ibishit. Atë nuk e brengosi shumë ajo që kishte ndodhur në Skënderaj. Ishte përgatitur për takime të tilla. Tani e tutje Tahirin po e priste një jetë krejt tjetër, jeta prej ilegali. Për pak

kohë qëndroi në Klinë të Ulët, pastaj në Qubrel te Zekë Fazlija e në Rezallë te Ragip Delia. Më pas në Verboc te Habib dhe Jonuz Shala. e së fundi në shtëpinë e tij, ku e kaloi kohën më të gjatë, deri sa edhe ra.

JETA PREJ ILEGALI

Pas të 28 prillit të vitit 1980, kur Tahir Meha iu kishte përgjigjur me të shtëna milicisë në Skënderaj, u shtrëngua të bënte jetë ilegali. Në të vërtetë për jetën e kaçakut, Tahiri kishte dëgjuar dhe mësuar shumë më herët nga gjyshi i tij. Megjithë njohuritë teorike që i kishte për këtë jetë, tani ai praktikisht atë po e perjetonte disi më ndryshe. Ishte përmirësuar ca nga shëndeti. Dhembja në gjoks sikur i kishte kaluar. Me gjithë se brinjët iu kishin ngjitur, herë-herë prapë e ngacmonin. Plaga e plumbit iu kishte mbyllur dhe nuk e pengonte edhe aq në lëvizjet e tija që i bënte gati çdo natë për ta vështruar terrenin ku strehohej. Ndihmën dhe përkujdesjen më të madhe gjatë kësaj kohe pa dyshim e kishte nga babai, Nebihu dhe i vëllai, Beqiri, si dhe nga të dyja gratë e tij. Ata, pa marrë parasysh rrezikun që i kanosej mbarë familjes, sepse Tahiri kishte marrë vendim të prerë: "vdekje po, dorëzim jo!" , e furnizonin atë me ushqime, e vëzhgonin terrenin dhe e strehonin pa u hamundur për as një çast.

Tahiri e kishte të qartë se ilegaliteti kërkonte gjeturi dhe përgatitje të domosdoshme, si:

- Të ishte shumë i kujdesshëm dhe vigjilent.

- Të kishte parasyesh ambientin dhe hapësirën gjatë lëvizjes.

- Të kishte koncentrim të duhur psiko-fizik.

- Të mbizotëronte arsyeja për veprim dhe vlerësim të situatës.

- Të kishte njohuri mbi lëvizjen e rrethit të tij.

- Të furnizohej me ushqim, veshëmbathje, armatim dhe strehim në rrethana të caktuara.

- T'i shquante dhe t'i vlerësonte tepër sakt elementet e dyshimta.

- Të kishte vazhdimisht informacione, ta hulumtonte dhe ta verifikonte sakt burimin e

tyre.

-Ta kishte të qartë se tani ai është vetë «mbret i natës!»

-Të ishte i gatshëm që në çdo moment ta ndërronte me shpejtësi bazën e strehimit po të paraqitje nëvoja etj.

Teorikisht, Tahiri të gjitha këto i kishte të qarta. Shtrohej pyetja se sa e si do të arrinte që t'i zbatonte ato rregulla të jetës ilegale në praktikë. Pas një kohe, që e kaloi në disa fshatra të Skënderajt, Tahiri u vendos në kullën e tij.

Pasi u vendos përfundimisht në kullë, i kufizoi lëvizjet e ditës. Terrenin, përreth lagjes e vëzhgonte natën. Ishte i vetëdijshëm për pasojat që mund t'i sillte strehimi në kullën e tij. Andaj një ditë, Tahiri i thotë babait të vet: "Babalok, erdha në shtëpi, ngase këtu jam në familjen time. Sido që t'i vijë fundi, të paktën nuk mund të thonë se Tahir Meha ia fiku derën filanit. Unë e vëreja se njerëzit kishin frikë të me mbanin, sado që nuk ma thoshin hapur. E kuptoja fare mirë këtë. Shqetësimin dhe frikën e tyre e vëreja në fytyrat dhe sjelljet e tyre. Shumica e njerëzve tanë ende nuk janë të përgatitur që t'i kundërvihen si duhet pushtuesit,unë e kuptoi këtë,prandaj as nuk i fajsoi ata

njerëz të mirë e bujar që më kanë mbajtur deri me tani, bile mendoj se kanë bërë shumë për mua duke i rrezikuar edhe familjet e tyre. Prandaj vendosa dhe erdha në kullën tonë". "Mirë kë bërë," – ia ktheu Nebihu. "Lë të bëhet çka të bëhet. Bashkë do t'i ndajmë të mirat dhe të ligat, tek e fundit jemi në shtëpinë tonë!"

Pas disa kohe UDB-ja, pa dyshim nga shërbëtorët e vet, e kishte kuptuar se Tahir Meha po qëndronte këmbëkryq në shtëpinë e tij! Ata po e përgjonin. Po siguronin informacionet e duhura. Sado që kishte kaluar bukur kohë, prej se Tahiri ishte ilegal në kullë, organet e pushtetit as që ishin dukur përreth lagjes Mehaj. Nuk silleshin fare atypari! Ata prapë, në befasi, donin ta hidhnin në grackë Tahir Mehën. Këtë truk të tyre Tahiri e kishte kuptuar. ...Ai nuk po flinte.

Në raportin, që e kemi në dorë, me titullin: "Dosja Meha", shihet qartë se ata, në ditën kritike, i kishin pasur në dorë të gjitha informacionet, madje shumë të sakta.

«Dosja Meha», raport i organeve të hetuesisë, që do të zërë vend në faqet e këtij libri, është pjesë origjinale e dokumenteve të hetuesisë. Kjo dosje është gjetur nga një qytetar i Prishtinës, në stacionin e policisë në Prishtinë, që ishte rrënuar nga bombardimet e NATO-s. Pjesët (me gjithë komentet e veta), që do të citohen në vijim, janë marrë nga gazeta "Koha Ditore", e 6 dhe 8 prill 2000, redaksisë së të cilës, qytetari që e kishte gjetur këtë material, ia kisht dorëzuar:

"Në mënyrë operative me 12 maj 1981 rreth orës 17: 00, kemi ardhur deri të shënimi (informacioni) se Tahir Meha me siguri në mbrëmje do të jetë në shtëpinë e vet, në fshatin Prekaz të Ulët..." .

Nga raporti, del qartë se përcjellësi ishte njohës i mirë i

terrenit dhe lagjes Mehaj. Informatat e sakta, në favor të UDB-së, sollën deri te rrethimi i kullës së Tahir Mehës, që filloi pikërisht në orën 01 të datës 13 maj 1981.

Agu i asaj dite, që sapo kishte filluar, po shkrepnte bashkë me krismat e pushkëve të Tahir e Nebih Mehës, që rezistonin me trimëri në kullën që ishte rrethuar e po sulmohej me armë nga policia speciale e Jugosllavisë. Krismat e Tahirit dhe Nebihut, atë ditë prilli, në të gdhirë, bashkë me rrezet e para të agimit përhapnin lajmin për një luftë në mbrojtje të jetës, të nderit dhe të pragaut të shtëpisë, pralajmëronin rifillimin e një lufte të armatosur për lirinë e mbarë Kosovës.

QËNDRIMI I TAHIR MEHËS PËR DEMONSTRATAT E VITI 1981

Tahir Meha kishte mbushur vitin që po bënte jetë ilegale, kur në Kosovë shperthyen fuqishëm demonstratat e 11 e 26 marsit, të 1 dhe 2 prillit të atij viti. Demonstratat, me prëmasat që morën, i befasuan pushtetmbajtësit jugosllavë. Ata ishin zënë të papërgatitur, për të përballuar tërë këtë vlim revolte të popullit shqiptar e cila ishte mbledhur lëmsh nga mizoritë dhe barbaritë e atij regjimi. Federata jugosllave u zu ngushtë dhe u luhet. E verbuar nga padrejtësia dhe lakmia për t'i mbajtur të tjerët nën sundim, të vetmin shpëtim gjeti në ushtrimin e dhunës mbi demonstruesit shqiptarë. Maltretimet, demolimet, arrestimet, plagosjet, vrasjet, diferencimet etj. , jo që ndihmuan gjë, por e thelluan edhe më krizën politike dhe ekonomike në Kosovë. Frazologjia boshe e ish-Jugosllavisë, mbi të ashtuquajturën bashkëjetësë e vetëqeverisje socialiste, doli për lëndinë. Para gjithë botës bashkëkohore Jugosllavia nxori në shesh fytyrën e vërtetë të atij regjimi antishqiptar.

Demonstartat e vitit '81 ngjallën shpresën te qindra e qindra atdhedashës të cilët me vite të tëra e kishin pritur një ditë të tillë! Ata kishin pritur me vite një shpërthim të popullit

të vet, ashtu siç e presin skamnorët shpërthimin e rrezeve të diellit pranveror. Edhe Tahiri, edhe pse i kishte pritur, ishte mahnitur nga këto ngjarje. Ai, që për shkak të padrejtësisë dhe robërisë, nuk kishte mundur të shkollohej, nuk kishte mundësi të dinte se ç'po zihej në mesin e studentëve. Lëvizjet e kufizuara, dhe jeta e thellë në ilegalitet, po ashtu ia kishin pamundësuar që të kishte informacione të mjaftueshme mbi rrjedhat e lëvizjes studentore që i përgatiti demonstratat e asaj pranvere. Lajmi për këto demonstrata, për Tahir Mehën, të cilin karakteri i tij kryengritës e kishte shtyrë që të bënte rezistencë individuale kundër pushtuesit, ishte një gëzim i madh. Pra, në rrugën që ai kishte zgjedhur, më nuk ishte vetëm.

TAKIMI I FUNDIT

(Pjesë nga ditari)

Ishte kjo hera e fundit qe e takova Tahir Mehën për të gjallë të tij. Ishte shumë i gëzuar dhe tërë emocione. Tani kishte më shumë informacione. Po e ndiente dhe po e shihte se populli ynë me fuqinë e vet, vërtet kishte tronditur pushtetin shtypës. Pyetjen e parë që ma bëri ishte: "A thua mor djalë, çka po thotë Shqipëria? Pse nuk po ndihet ende!?" U zura ngushtë. Vërtet nuk dija se ç't'i thoshja. Ishte 7 prilli dhe Shqipëria zyrtarisht ende nuk ishte prononcuar?! (Komentin e parë, i cili na forcoi e na dha zemër e fuqi të papërshkrueshme, ajo e dha të nesërmen, më 8 prill). I thashë: "Baca Tahir, Shqipëria nuk ngutet, por kur t'ia bëj bamë, do t'ia bëjë përnjëmend!" "As që dyshoj, – ma ktheu, – por e kam ngase nuk po më pritet mor djalë. Unë jam i gatshëm që Kosovës t'ia fal jetën time. Atë ditë po e pres. Tani, kur po e shoh se populli është në të mbarën dhe në të drejtën e tij, unë jam ba me krahë! Ta dish, unë jam me ju. Do të shkrihem i tëri. Jam i gatshëm, si Oso Kuka, të digjem në flakë të barotit, vetëm e vetëm që të çlirohemi prej këtij pushteti shtypës e gjakatar. Këtu në zemër me ka therrur kur kam dëgjuar për vrasjen e atyre studentëve. Ta dini, do tua marr hakun katërfish!" Kur u ndamë më porositi: "Mos u ndalni. Vetëm punoni, vetëm punoni. Dita jonë patjetër do të vijë! Për çdo

nevojë, mos i harro dyert e Tahir Mehës," –më tha, duke më rënë lehtë me dorë supeve.

Fitova përshtypjen se këto demonstrata e kishin bërë Tahirin më të ri, më optimist, më të fuqishëm. Liria e Kosovës tani po dukej në horizont, më herët se ç'kishin menduar disa!

DIFERENCIMET IDEO-POLITIKE NË KOSOVË

Pas shpërthimit të demonstratave në Kosovë filloi procesi i diferencimit dhe i dënimit të pjesëmarrësve dhe përkrahësve të tyre. LKJ-ja kishte filluar fushatë të egër, duke dashur që shqiptarët t'i goditte rëndë. Disa filluan të luhaten, mirëpo Kosova kishte edhe atdhetarë të devotshëm, që s'donin t'ia dinin për rrezikun. Dhe pikërisht duke u mbeshtetur në veprat e këtyre burrave të mëdhenj, Kosova dhe populli shqiptar në përgjithësi, sot ka për se të mburret me historinë e tij. I tillë, ishte edhe Nebih Meha, që nuk pranoi për asnjë çast që të distancohej as nga demonstratat e studentëve e as nga biri i tij Tahiri. Madje ai nuk u distancau as atëherë kur duhej ta zgjidhte rrugën mes jetës dhe vdekjes! Të rrallë janë shembujt në historinë e popujve, siç ka ndodhur ndër ne, kur burri, qoftë babai me të birin, shoku me shokun, vëllai me vëllnë, apo me bashkëluftëtarin, thotë: "Jo besa nuk po dorëzohem, por dua të vdes se bashku me të!" Raste të tilla si të Nebihut, ndër ne, më herët e më vonë, kemi me dhjetëra. Rënia heroike e Rexhep Malës dhe e Nuhi Berishës, Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, Fehmi e Xhevë Lladrovci, Adem legjendarit me gjithë familje, janë akte të periudhës më të re në historinë tonë të bujshme. Këto akte heroizmi të popullit

tonë, që janë kurorëzuar me lavdinë e rënies legjendare për liri, i lënë në hije edhe aktet më heroike të veprave më të lashta të Danteve e të Homerëve të të gjitha kulturave dhe përpjekjeve të njerëzimit për liri gjatë gjithë historisë së lashtë të njerëzimit, qoftë e shkruar e qoftë legjendë.

Nebih Meha, në rrugën e vështirë të përpjekjeve për liri, kurrë nuk u hamend: "Unë nuk e gjykoj birin tim, për rrugën që ka zgjedhur, nuk i gjykoj demonstratat, që paraqesin përpjekjet tona për liri. Demonstrantët janë bijtë e mi. Po i gjykova ata, do ta gjykoj edhe Tahirin tim. Unë jam deri në vdekje me popullin tim!" . Hapur e kundërshonte diferencimin dhe apelonte te bashkëkohësit që t'i përkrahnin studentët. "Studentët janë ardhmënia jonë. Ata dinë se çka duan dhe çka bëjnë. Jo që duhet t'i dënojmë, por duhet t'i përkrahim fuqishëm!" Edhe përkundër rrezikut që i kanosej atij dhe familjes së tij, Nebihu, nuk deshi t'ia dijë për trysinë që i bënin për të birin. Nebihu publikisht e mbrojti Tahirin. Shumëherë kishte thënë me plot krenari: "Tahiri im nuk dorëzohet i gjallë në dorë të pushtuesit! Edhe unë së bashku me të do të luftoj kundër Serbisë" . Për ta theksuar edhe më fort qëndrimin e patundur të tij, shtonte: "Ia kam dhënë besën Tahirin. Me të do ta bëjë vdekjen. . Trarët e kullës sime do të fluturojnë deri në Llaushë nga lufta që do ta bëjmë me shka. Le të ndiejë gjithë bota se shqiptari më nuk e duron robërinë!" Edhe në ndenja, gazmende apo ndonjë rast morti dinte ta sfidonte vdekjen dhe t'i thumbonte ata që ishin të luhatsëm me humor: "Unë do të vdes nga plumbi, duke luftuar për liri. Juve burra, pa të keqen e askujt, do t'ju mbysin flamat me krye në jastëk. Pas vdekjes suaj, kush s'ka çka thotë për ju" . Aq hapur e aq në mënyrë të sinqertë, ua thoshte këtë, sa bashkëbiseduesit, jo që prekeshin, por qeshnin me gjithë zemër ngase Nebihun e respektonin shumë.

NJË DIALOG I ASHPËR DHE I PRERË NË KULLËN E SHABAN POLLUZHËS

Nebih Meha, një ditë marsi të vitit 1981, së bashku me Zekë Fazlinë e Çubrelit, shkojnë në Polluzhë, në kullën e Metit (të të birit të Shaban Polluzhës), me të cilin ishin edhe miq të vjetër. Në atë konak qëllon edhe Beqir Dobra nga Kryesheci i Skënderajt, (nip i Shaban Polluzhës dhe dhëndër i autorit të këtij libri), i cili, më vonë, ra për liri, gjatë luftës së UÇK-së.

Beqir Dobra, disa herë, me besnikërinë më të madhe e ka treguar dialogun e ashpër që e kishte pasur bacë Nebihu në atë kullë me zëvendëskomandantin serb të stacionit të milicisë së Skënderajt, Cvetko Radojçiqin.

UDB-ja, siç e kishte zakon, përmes zagarëve të vetë e përcillte edhe Nebihun, se ku shkonte dhe me kë shoqërohej. UDB-ashët ishin lajmëruar se Nebih Meha, vetë i dytë shkoi për në kullë të Shaban Polluzhës. Me këtë rast ata supozonin, se: "Për derisa shkon aty babai i tij, rrjedhimisht edhe Tahiri duhej të ishte atypari!" Kështu vendosin të shkonin ta takonin e ta kërcënonin Nebihun mu aty ku ishte mysafir!

"Sa ishim duke ndejur, – tregonte Beqir Dobra, – pasi që

kishim ngrënë drekë dhe po pinim çaj, u ndie një e thirrur. Pas saj u fut në kullë zëvendëskomandanti i stacionit të milicisë së Skënderajt Cvetko Radojçiq vetë i katërti. Nebihu as që lëvizi nga vendi. Pasi u ulën, filloi biseda me anë të një përkthyesi, sepse Nebihu, thënë realisht, nuk e dinte edhe aq serbishten. Biseda që fillimisht ishte ca e qetë, me kohë mori tone kërcnimi:

- Ne erdhëm këtu të takohemi me mixhën Nebih, posa morëm vesh që është këtu, në kullën tuaj. Thamë të bisedojmë pak me të, sepse unë i respektoj pleqtë," – e filloi bisedën Radojçiq.

- E para, ai, me këtë, donte që t'i tregonte Nebihut se nuk kishin ardhur krejt kot, por po e përcillnin. E dyta, duke e theksuar shprehjen "Sa e morëm vesh që është këtu" ...- donte ta ngjallte dyshimin, te Nebih Meha, se përcjellësin e tij e kishte diku afër, e kishte të rrethit të vet, pra të fuste dyshimin dhe pasigurinë. Ndërsa për t'ia vënë kapakun kësaj pune, vazhdoi me dinakëri: – "Unë i respektoj pleqtë," – me të cilën donte t'i thoshte, se ti nuk ke faj, por Tahiri dhe doli aty ku ia kishte qitur rrethin:

- Dorëzoje djalin në besën tonë dhe kjo punë, mixha Nebih, do të mbyllet! – Rajdoçiqi, fjalën "mixhë" e përdorte për ta zbutur Nebihun. Pasi ia hodhi një vështrim zhbirues, e pyeti: – Ku është Tahiri, mixha Nebih? Ti e di që ne po e kërkojmë. Ti e di po ashtu se ai ua ka rrezikuar jetën milicëve duke shtënë në ta. Ti e di mirë, që ne ende s'të kemi ardhur në shtëpi për këtë punë. Nuk po duam t'ju shqetësojmë, prandaj erdha këtu që të të lus ta dorëzosh Tahirin. Është mirë që ti vet, me dorën tënde, ta dorëzosh. Përndryshe, – e ngriti zërin ai, – nëse Tahiri nuk dorëzohet brenda tri javëve, ne kemi urdhrin për ta vrasur, ku ta zëmë! Bile kemi urdhër që ta vrasim edhe atë

qe e strehon, – tha për të futur frikën tek strehuesit e mundshëm të Tahir Mehës.

Posa përkthyesi i tha edhe fjalët e fundit, Nebihu që mezi priste, ia ktheu, me një ton po aq kërcënues:

- Dëgjo ti, komandir i milicisë. Së pari, duhet ta dini që, Tahir Meha, edhe po të dua unë, nuk është djalë që i dorëzohet hyqymetit tuaj. Së dyti, as Nebih Meha, nuk është një babë qe dorëzon djalin e vet në milici. As babë e as babgjysh nuk jemi dorëzuar, e jo më. . . – Këtu përkthyesi u ngatërrua, tregonte Beqir Dobra. Nuk kishte guximin që t’ia përkthente komandantit të vet atë që po e thoshte Nebihu. Radojçiqi, i cili e e mori vesh, ngase e dinte shqipen shumë mirë, ndërhyri:

- Mixha Nebih, koha e Kralit tani ka kaluar. Tani jemi në Jugosllavinë e Titos, jemi në kohën e vëllazërim-bashkimit. S’ka më luftë. Tani është kohë paqeje dhe duhet të rrini rehat.

- Ju e dini shumë mirë, -vazhdoi fjalën Nebihu, – që djalit tim, në këtë kohë, ia keni thyer dy brinjë dhe e keni bërë për spital. E keni sulmuar midis qytetit, pa bërë asgjë. Ku keni parë ju kështu? E keni gjuajtur edhe me armë. . . Sigurisht që ai ka vdekur diku ne mal, ndërkaq ju po më bini kot në qafë mua se e paskam fshehur dhe se u dashka t’jua dorëzoj! – i tha sa për të marrë vesh se a e dinin ata se ku strehohej Tahiri.

- Djalin e ke në shtëpi. – mori frymë Radojçiqi. – Ne jemi në dijeni për këtë. Nëse e dorëzon, ta japim besën se s’ka për ta prekur kush me dorë.

- Djalin nuk e kam në shtëpi, mirëpo edhe po të kisha, nuk kam besë në hyqymetin e Serbisë! – përfundoi Nebihu.

Radojçiqi kërceu në këmbë. U mat të ndërmernte diçka, por e vërejti se nuk ishte as momenti e as rrethanat. I urdhëroi

milicët që të dilnin, duke e kërcnuar edhe një herë Nebihun:

- Ta dish pra, se kemi për ta vrarë, ku ta takojmë. Ai nuk ka shpëtim!

- Kush ka lypur vrasje, deri më sot, ajo e ka gjetur. Veç, mos harro, Tahirin, kurrë nuk e merr plumbi i shkaut!

- Në të dalë e sipër Radojçiqi i tha edhe këtë Nebihut:

- Së bashku me Tahirin, të gjithëve do të ju vrasim!

- Pikë falë mos të qofsha, se plumbi ta len edhe ty!-ia ktheu Nebihu pa lëvizur nga vendi.

- Të gjithë sa ishim brenda, – tregonte Beqir Dobra, – u shtangëm. Nuk e dinim çdo të pasonte. Nebihu që ishte i vendosur, as që donte t'ia dinte për këtë. Pasi ata shkuan iu drejtua të zotit të konakut:

- Lirohu, Met Shabani, se ti nuk ke faj. Unë e di se ata me përcjellin, por ti mos u shqetëso fare. Ata duan që të mbjellin firikë të unë, por Nebih Meha nuk e di se çka është frika. Na jep leje, se edhe ne po ecim e na e bën hallall për këtë që ndodhi në kullën tënde. Mirëpo, jam shumë i lumtur që këto fjalë ia thashë shkaut pikërisht në kullën e Shaban Polluzhës. Po të ishte Shabani gjallë, do t'ia jepte plumbin, por ne jemi ligur, or Meto-o-o! – ia ktheu Nebihu duke u përshëndetur me të zotin e konakut.

Shërbimet e UDB-së, pa dyshim se kishin bërë përgatitje të gjata për ta kapur Tahirin. Për këtë flet shumë mirë edhe "Dosja Meha".



Nebih Meha

«DOSJA MEHA» E ZBULUAR 19 VITE MË VONË

Më 13 maj, në ish-Jugosllavinë, festohej, dita e sigurimit shtetëror. Operacioni, që ishte paraparë për këtë ditë, në formë dukej i zakonshëm. Në të vërtetë, ky aksion, i pranverës së vitit 1981, kishte për qëllim, mu në ditën e sigurimit shtetëror, ta arrestonte Tahir Mehën dhe t'i jepte "mësim" të gjithë atyre që kishin ngritur krye kundër pushtetit antishqiptar jugosllav. Sipas të dhënave zyrtare të asaj kohe, për njësinë speciale të milicisë, operacioni kishte përfunduar me katër të vrarë dhe tre të plagosur!

Shënimet që pasojnë janë deklarata të familjarëve (të cilat duhet të shihen me dyshim sepse janë marrë nga pjesëtarët e sigurimit shtetëror), të milicëve pjesëmarrës në aksion dhe nga shkresat zyrtare të SPB-së së Kosovës për "Dosjen Meha" .

Sipas kësaj dosjeje Tahir Meha përshkruhet në këtë mënyrë: "Mesatarisht i zhvilluar, i gjatë rreth 170 cm, fytyrë të rrumbullakët, flokë ngjyrë të zezë të errët të nënqethur me rregull, në kokë zakonisht mban kallpak. Ka gojë, hundë, sy, duar, këmbë të zhvilluara normalisht. Në qoftë se është pa

kallpak, flokët i kreh prapa, nuk është tullac, por ka flokë të dendur. Gjatë ikjes ka pasur të veshur një mantel ngjyrë të kaltër të çelët. Gjatë ecjes lëviz me kujdes duke kthyer kokën majtas dhe djathtas. Gjatë ikjes ka pasur të veshur pantallona të zeza dhe këpucë me ngjyrë të panjohur. Lidhjet familjare të Tahir Mehës tash për tash janë të panjohura jashtë selisë së këtij organi. Për herë të fundit ka punuar në Kavadar në RS të Maqedonisë. Në rastin e gjetjes së tij duhet të privohet nga liria dhe t'i dorëzohet Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës së Kosovës, ndërsa duhet njohtuar këtë organ duke u thirrur në numrin e depeshës. Komandanti i Stacionit-dokument zyrtar i SPB-së".

"Në natën midis 12 e 13 majit, Tahirin, e kanë zgjuar të lehurat e qenit në oborr. Është kollitur zhurmëshëm dhe ka nderur një cigare. Rreth orës 01: 30, kishte nxjerrë revolen, që e mbante nën jastëk kur flinte, e të cilën e vinte në bel gjatë ditës. Kishte kohë që bënte gjumë me rroba veshur. I kishte thënë gruas, Shefkijes, që të pyeste se kush është jashtë. Përgjigja ka ardhur nga njëri prej milicëve, që ka thënë se shtëpia është e rrethuar nga milicia dhe e ka ftuar që të dorëzohet për shkak se ekzistonte urdhri gjyqësor për arrestimin e tij" .

"Më 28. 04. 1980, rreth orës 14: 00, në Skënderaj, Tahir Meha ka shtënë nga revolja e prodhimit të panjohur, kalibri 9 mm, në drejtim të milicit NN, me qëllim të vrasjes së tij, në çastin kur patrulla e milicisë, me urdhër të Gjykatës së Qarkut të Skënderajt, ka tentuar ta privonte atë nga liria dhe ta shpiente në gjykatë për vuajtjen e dënimit në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh."

"Tahiri e kishte urdhëruar Shefkijen, bashkëshorten e parë të tij, që të kërkonte nga milicët që të largoheshin, por ata nuk kishin lëvizur nga pozitata e tyre. I ka thënë Hakës, bashkë-

shortës së tij të dytë, që të vepronte njësoj dhe t'u thoshte milicëve se «Tahiri nuk është këtu». Por milicët të vendosur nuk kishin reaguar dhe kishin isistuar se ishin në dijeni që Tahiri ndodhej në shtëpi."

"Në mënyrë operative, me 12 maj 1981, rreth orës 17: 00, kemi ardhur deri të shënimi se Tahiri me siguri, në mbrëmje, do të jetë në shtëpinë e vet, në fshatin Prekaz i Ulët. . . Aksioni duhet të fillojë të mërkurën, më 13 maj 1981, në orën 02: 00, kur njësia duhej të nisej nga organi dhe të bllokonte shtëpinë e të përmendurit Tahir. Pas bllokimit të shtëpisë, posa të fillonte agu i parë, me ndihmën e megafonit duhej të ftohej Tahiri që të dilte dhe të dorëzohej. Në rast se nuk pranonte të dorëzohej duhej të merreshin masat dhe veprimet e parapara..., – thuhet në kuadër të planit operativ të hartuar lidhur me masat dhe veprimet që duheshin marrë nga shërbimi i sigurimit publik për kapjen e Tahir Mehajt" .


"Tahiri kishte kuptuar se milicët ishin në dijeni se ai ndodhej në shtëpi dhe se nuk do të largohej. I është afruar dritares dhe ka filluar të bisedonte me milicin që kishte qenë më afër dritares: «Nuk kam besim që t'i dorëzohem milicisë së Serbicës se ata m'i kanë thyer brinjët dhe njëherë më kanë plagosur»-kishte thënë Tahiri. Milicët janë përpjekur ta bindin se askush nuk do ta rrihte. Për një kohë të gjithë kishin qëndruar në vendin e tyre. Tahiri me kujdes kishte përcjellë lëvizjet e çdonjërit prej milicëve që e kishin rrethuar shtëpinë e tij. Duke shikuar me bisht të syrit, i vendosur pranë dritares kishte reaguar në çdo lëvizje të tyre dhe të armëve. «Do t'i dorëzohem në besë vetëm Zoranit, punëtorit të DB-së (Sigurimi Shtetëror në Mitrovicë),» – kishte thënë Tahiri pas një kohe. Një "gazikë" ishte nisur për Skënderaj dhe pas pak ishte kthyer me njëfarë personi, të cilin Tahiri nuk e kishte njohur. – «Ky nuk është Zorani», – u kishte

thënë ai. Pas kësaj u kishte thënë milicëve se do t'i dorëzohej një Imeri apo Faiku. Në vend të tyre kishte ardhur njëri i quajtur Zena, të cilin e njihte Tahiri. Në bisedë me të Tahiri, kishte refuzuar të dorëzohet, duke kërkuar që të silleshin personat që i kishte thirrur.

«Imeri ka vdekur në fatkeqësi komunikacioni e Faiku është në shokdhomë», – i kishin thënë milicët. "Heshtja e brishtë kishte vazhduar. Tahiri kishte vërejtur se përforcimet e milicisë sa vinin e shtoheshin.

Ai e kishte ndier se po i afrohen çastet e fundit të jetës dhe u kishte thënë grave që të mos ia hapin derën askujt dhe të mos vinin më në dhomën e tij në katin e dytë të shtëpisë" . . .

"Tahiri ka dalë në dritare, ka biseduar gati me të gjithë milicët dhe nuk ka dashur të dorëzohet, duke u thënë se unë i gjallë nuk dorëzohem. Bile, nganjëherë e shpaloste edhe gjoksin dhe thoshte: «Vritmëni!» – deklaratat e milicëve pjesëmarrës në aksion, dhënë me 17. 05. 1981.



Plani operativ për sulmin mbi shtëpinë e Tahir Mehës. Dokument i UDB-së.

MILICIA E KA NËNÇMUAR TAHIRIN

"Për zënien e Tahirit, rreth orës 10: 00 të 13 majit, është angazhuar njësitit special i milicisë. Rreth orës 10: 00 në zyrën time në Skënderaj ka ardhur inspektori i SPB-së A. B me komandantin e njësitit special të milicisë që është prezentuar si Franc. Ai ka thënë se detyrë e milicëve është që të mos vërehet ardhja e njësitit të tij në vendin e ngjarjes, që ta mbajmë Tahirin në dritare për 2-3 minuta, deri sa ai t'i vendosë njerëzit e vet në vende të caktuara dhe të japë urdhrin për futje të lotsjellësit dhe zënien e tij. Ndërkohë që milicët nuk duhet të përzihen në kryerjen e aksionit të njësitit special kur të fillojë veprimi.

Derisa milicët e tjerë kanë biseduar me Tahirin për t'ia tërhequr vëmendjen, njësitit special i është afruar shtëpisë. Disa prej tyre janë fshehur në gardh, derisa njëri, me ndihmën e milicëve të tjerë ka marrë llotrën për të hipur në dritare. Të veshur në uniforma të gjelbërta, pjestarët e njësitit special, janë përvjedhur pranë shtëpisë se Tahirit. «Të lutem largohu», – i kishte thënë Franci njërit prej milicëve të rregullt, derisa ai përpiqej t'i shpjegonte milicëve specialë se ku gjendej Tahiri. Mandej udhëheqësi i tyre përmes radiolidhjes ka urdhëruar që me anë të pushkëve speciale të përdorin mjetet kimike. Dy

patrona të gazit lotsjellës nuk kanë hyrë nëpër dritare, por kanë goditur murin dhe janë kthyer duke përhapur gazin lotsjellës në mesin e milicëve. Janë dëgjuar britmat e grave dhe të fëmijëve që në rrëmujën e krijuar ia kanë dalë që të largohen nga shtëpia.

"Disa milicë e kanë ngritur llotrën (rezhnik i qerres me shtiza të rralla, në formë shkalle, që vihet në qerren që tërhiqet nga kafshët për të bartur kashtë apo sanë). Kam parë se njëri ka hypur deri në gjysmë. Po këtë moment kam dëgjuar edhe krisma, por nuk dija se kush po shtinte. Të shtënat janë përzier me britmat e grave, të mbështjella me mbulesën e gazit lotsjellës. Një pjesë e milicëve është detyruar të tërhiqet mu për shkak të gazit lotsjellës të hedhur nga milicia speciale. Një pjesëtar të njësitit special (Salih Hasanoviq), i cili ka tentuar të ngjitet shkallëve të llotrës, Tahiri e ka qëlluar nga dritarja. Pas kësaj është qëlluar edhe Muhamet Selmanaj. Muhameti i cili ka qenë afër meje të oda më ka thënë: «Këqyr ku qenka Tahiri» dhe njëkohësisht e ka drejtuar pushkën në drejtim të dritares së Tahirit. Mirëpo, në këtë moment, Tahiri ka shtënë dhe Muhameti menjëherë është rrëzuar, kështu që fare nuk ka mundur të shtinte në dritaren ku ka qenë Tahiri. Pas kësaj kam dëgjuar një milic të njësitit special duke kërkuar ndihmë në radio-lidhje: «Më ndihmo! Jam plagosur». Duke u kthyer për ta kërkuar mjekun e takova një udhëheqës të njësisë speciale të cilin e kam pyetur në gjuhën serbe: «Kolegë, e ke parë mjekun?» Ai më tha: «Nuk e di ku është. Unë i kam humbur dy milicë. » Milicët në dëshmitë e tyre thonë se për shkak të rrëmujës së përgjithshme dhe të shtënave si dhe përhapjes së gazit lotsjellës nuk kanë qenë në dijeni se ç'ka ndodhur" .

"Pasi që kanë pushuar krismat e armëve, kam dëgjuar zërin e grave duke thënë: «U vra Tahiri! U vra Tahiri!» – deklaroi njëri."

"Një milic tjetër dëshmon se Franci është kthyer me pushkën e Nebihut të cilin e kishte vrarë, duke thënë: «E kam vrarë plakun dhe ia kam marrur pushkën. » Por, para se ta kishte bërë këtë, Nebihu kishte vrarë një milic të njësitit special, Pejoviq.

Pas këtij dueli ka mbretëruar qetësia. Milicët janë tërhequr nga pozitat e tyre, por shtëpia ka mbetur nën rrethim. «Pastaj ka ardhur transporter i blinduar dhe sulmi ndaj shtëpisë ka vazhduar për një kohë, por as me këtë nuk është arritur qëllimi », – shkruan Cvetko Radojçiq, milic rezervist në Skënderaj. «Pstaj është gjuajtur me tromblona e janë provuar edhe mjetet kimike që janë futur përmes vrimave në shtëpi. Ka ardhur edhe një mjete tjetër i blinduar, e pastaj nga udhëheqësi i njësitit të milicisë është përcjellë që shokët duhet të tërhiqen pasi që do të fillohet me hedhjen e bombave të dorës ».

Në këtë kohë milicët janë tërhequr dhe kanë qëndruar në distancë në pritje të daljes së Tahirit. Urdhri është dhënë që një transporter i blinduar të rrënojë shtëpinë për ta detyruar Tahirin që të dilte. »Kur blinda ka goditur derën dhe ka rrënuar një pjesë të shtëpisë nuk është parë më asgjë për shkak se është ngritur një re e pluhurit. Udhëheqësi i njësitit special ka dhënë urdhrin për tërheqjen e transporterit dhe ka vazhduar me hedhjen e bombave të dorës. Gjithashtu ka ndriçuar oborrin me reflektorë». – pohon Radojçiq në deklaratën e tij.

"Në një çast në orët e vona të pasditës, Tahir Meha ka braktisur pozitën e tij dhe ka luajtur me «krejt apo asgjë». Ka dalë nga shtëpia e tij e rrënuar dhe ka filluar të vrapojë. Ka kapercyer një gardh dhe është nisur poshtë arave. Janë dëgjuar dy breshëri automatiku dhe një e shtënë pushke. Tahiri ka hasur në rrethin e dytë të pozicioneve të milicisë" .

«Nuk di si ka ardhur deri të vdekja e katër shokëve të mi», – shkruan Radojçiq. «Sa më perket mua kjo ka ndodhur për shkak se e kanë nënçmuar Tahirin dhe se e kanë zhvilluar sulmin shumë shpejt pa u njoftuar në detaje me të gjitha objektet.»

Në aksionin për zënien e Tahir Mehës janë vrarë milicët: Muhamet Selmanaj, Salih Hasanoviq, Voja Tubiq, Milanko Pejoviq. Janë plagosur Boshko Palija, Jovica Milaçiq dhe Vllado Stepanoviq dhe janë likuiduar Tahir e Nebih Meha. "Pjesë nga "Dosja Meha" të botuara në «Koha Ditore», 8 prill 2000.



Plani operativ - shtëpia e Tahir Mehës. Dokument i UDB-së.

KUNDËRTHËNIET BRENDË «DOSJES MEHA»

Në «Dosjen Meha», vërehen fare qartë përpjekjet e organeve të sigurimit të Skënderajt dhe të atyre të Mitrovicës për ta mbuluar dhe për ta shtrëmbuar të vërtetën! «Kishte ardhur urdhërarresti për Tahirin nga Gjykata e Qarkut të Skënderajt !?», – thuhet në shkresat e organeve të sigurimit. Skënderaj as sot e kësaj dite nuk ka gjykatë të qarkut !

Atëbotë organet e UDB-së për opinion patën thënë se Tahir Meha kishte marrë peng anëtarët e familjes së tij. Këto organe, prapë sipas UDB-së, ishin përpjekur që t'i lironin nga pengëmarrja anëtarët e familjës së Tahirit. Nëse i referohemi dokumenteve të po këtyre organeve gjendja na del krejt ndryshe citojmë:

«Kur është dhënë urdhri për hedhjen e mjeteve kimike dhe pasi u përhap gazi lotsjellës, u dëgjuan britmat e grave dhe të fëmijëve që në rrëmujën e krijuar donin të dilnin jashtë nga shtëpia».

Kush i pengoi pra, anëtarët e familjes së Tahirit që të dilnin nga shtëpia? Kështu paskan dashur organet e SPB-së që t'i shpëtonin dhe mbronin familjen e Tahirit duke i sulmuar pa ndërprerë me granata dore, breshëri armësh dhe mjete kimike,

lotësjellës etj. Si mund të shpëtonin ata njerëz duke i sulmuar me armë në të njejtën kohë?! Kur citohen fjalët e të dyja bashkëshorteve të Tahirrit, edhe pse janë marrë nga dosja e milicisë, mund të shohim se cila është e vërteta në këtë rast:

«Tahiri na tha neve grave që të mos ia hapnim derën askujt dhe të mos vinim më në katin e dytë, pra në dhomën ku ishte ai».

Ishte njësia speciale, e cila, duke i detyruar që të qëndronin mbyllur në shtëpi fëmijët dhe anëtarët e tjerë të Tahirrit, donin ta rritnin presionin psikik mbi Tahirin. Kur fëmijët mësynë derën për të dalë jashtë, se më nuk mund qëndronin, ata i pritën me armë zjarri. Me këtë rast ata plagosën rëndë, vajzën e madhe të Tahirrit.

Në "Dosjen Meha", aty diku nga fundi përmenden katër milicë të vrarë dhe tre të plagosur, me emër e mbiemër. Kur është fjala për të plagosurit ata shkruajnë se: «Janë likuiduar Tahir e Nebih Meha». Fare nuk e përmendin vajzën e Tahirrit, e cila kishte marrë plagë të rënda! Ndërkaq bashkëshorten e Tahirrit, e cila kishte arritur të dilte nga shtëpia, nuk e kishin lejuar që të hynte për ta marrur Salën e cila ishte vetëm gjashtëmuajshe që gjendej në djep. Kjo foshnjë, që kishte mbijetuar nën trarët e shtëpisë gjysmë të rrënuar, për orë të tëra, kishte mbetur nën rrebeshin e plumbave, gazrave kimike, lotsjellësve, granatave të dorës, mjeteve të blinduara dhe zjarrit që kishte kapluar shtëpinë!

Duke u përpjekur t'i shtrembërojë faktet UDB-ja krijon një shfaqje teatrale, që fund e krye është një trillim. Përderisa Tahiri paska "kërkuar dorëzimin në besë" të Zoranit, pastaj Imerit e Faikut... përse vallë këta nuk paskan lejuar një gjë të tillë! Përse nuk ia sollën "dorëzanët", ta "garantonin" njeriun që po "kërkonte" të dorëzohej pa gjak e luftë dhe puna do të

përfundonte me kaq! Ata edhe ashtu sipas pohimeve të tyre "kërkonin" dorëzimin e Tahirit e jo luftë me njeriun i cili kërkonte "besën e tyre" ! Përse i thanë se "Imeri ka vdekur e Faiku gjendet në shok dhomë" , ndërsa në vend të Zoranit i sollën Zenën !? UDB-ja e kishte shumë të qartë se Tahiri nuk do të dorëzohej i gjallë. Ata e dinin shumë mirë se po t'i sillnin UDB-ashët e lartpërmendur në atë përleshje do të hanin plumbat e "valterit" të Tahir Mehës. Ata, duke i shpallur të vdekur a të sëmurë, kolegët e tyre, i nxorën me mjeshtëri nga ajo "lojë" vdekjeprurëse. Si ta sillnin Zoranin, Imerin a Faikun, të ballafaqoheshin me Tahirin i cili shumë herë e kishte shprehur mllefin duke thënë: "Në më ardhhtë dita mua, e di se me kë do të kem punë. O do t'i laj hesapet një nga një, në radhë të parë me ata që kanë bërë ç'është më zi mbi trupin tim, o s'do të mundohem të mbetem gjallë!" Dhelprat si Zorani dhe të tjerët, që Tahiri ua kishte "besën" , e dinin mirë se takimi i tyre me Tahir Mehën, ishte takim i tyre me vdekjen!

Vetë "Dosja Meha" , që është shkruar nga organet e sigurimit e mohon pohimin se Tahir Meha ka kërkuar që të dorëzohet: Në të njëjtën dosje i hasim dy versione që e kundërshtojnë kategorikisht njëra-tjetrën. Derisa në të parin thuhet se ai kërkonte që t'i dorëzohej në besë Zoranit, në të dytin thuhet: "Tahiri herë pas here ka dalë në dritare dhe ka biseduar gati me të gjithë milicët. Ai nuk ka dashur të dorëzohet, duke thënë se: «Unë i gjallë nuk dorzohem!». Bile nganjëherë e shpaloste gjoksin dhe thoshte: «Vritmëni!».

Në "Dosjen Meha" thuhet edhe kjo: "Në orën 10: 00 A. B. , inspektor i SPB-së, shkon me Franc Kosin në zyrë të Cvetko Radojçiqit!" Më lartë, gjithnjë në të njëjtën dosje, për këtë Cvetko Radojçiqin thuhet se ishte «milic rezervist» në Skënderaj" , ndërkaq më poshtë thuhet se më i larti i njësitit

special në nivel të ish-Jugosllavisë, siç ishte Franc Kosi, shkon në zyrë të Cvetko Radojçiqit, pra të «rezervistit»! Më pas na del se ata mësyjnë Prekazin, ku dëgjojnë një të plagosur që po kërkonte mjekun dhe tjetrin që në gjuhën serbe po i thoshte: "Koleg unë kam humbur dy milicë e ti po kërkon mjekun" . Po aty citohet që Radojçiqi të ketë thënë se: "Unë kam humbur katër shokët e mi" ! Pra, këto janë përshkrime të sigurimit të shteti të ish Jugosllavisë në «Dosjen Meha», me plot kontradikta, ku Sigurimi Shtetëror është munduar ta fshehë të vërtetën, që siç flasin dëshmitarë të shumtë, atë ditë i kushtoi së paku me 20 milicë të vrarë e me dhjetëra të tjerë të plagosur.

Më pas organet e SPB-së do t'i burgosin edhe Mehmet e Beqir Mehën. Me akuzën për vrasje dhe plagosje të milicëve të njësitit special ata do të mbahen për shtatë muaj nën hetime në burgun e Mitrovicës!

E vërteta për fundin e përgjakur në Prekaz, në Kosovë e më larg, ishte përhapur me shpejtësi rrufeje. Numri i milicëve të vrarë nuk përkonte as përafërsisht me atë që e jepte versioni zyrtar. Milicia speciale, më 13 maj 1981, mu në festën e sigurimit shtetëror, që kishte sulur me gjithë arsenalin e armëve për t'iu dhënë leksion kryengritësve, ishte thyer dhe kishte dështuar para qëndresës heroike të Tahir e Nebih Mehës. Për ta zvogëluar dozën e turpfit, UDB-ja po e fshihte numrin e të vrarëve. Ndërsa, që ta "arsyetonte" sulmin kundër një qytetari e një familjeje, arrestonte e burgoste edhe të tjerë. Para opoininit me çdo kusht mendohej të krijonte përshtypjen se kundër policisë speciale, atë ditë në Prekaz, nuk kishte luftuar vetëm një Tahir Mehë, por edhe shumë të tjerë.

NË BURG ME BEQIR MEHËN

(Pjesë nga ditari)

Kisha bërë ca muaj në burgun e Mitrovicës. Nga dritarja e qelisë sime, në «shëtitorën» e burgut, kisha vërejtur Mehmetin dhe Beqirin. Pas disa muajve më nxorën nga qelia dhe më dërguan në një dhomë ku ishin dy e më shumë veta. Më futën në të njëjtën dhomë me Beqir Mehën! Nuk e kisha të qartë: rastësisht apo me qëllim. Ne ishim që të dy nga i njëjti fshat dhe rregullat e burgut nuk e lejonin një gjë të tillë. Sidoqoftë aty më lanë për tri ditë rresht. Pas tri dite erdhën dhe shpejt më larguan nga ajo dhomë. Më thanë se do të më transferonin në Prishtinë! Në fakt nuk më transferuan. Gjatë atyre tri ditëve sa kisha qëndruar me Beqirin, kishim biseduar gjërë e gjatë. Disa herë e kisha lexuar edhe aktvendimin e tij. Ani pse SPB-ja e dinte shumë mirë se Beqiri dhe Mehmeti tërë ditën e 13 majit, nga milicia kanë qenë të rrethuar me gjithë familjet e tyre dhe nuk i kanë lënë që të dalin jashtë as për nevojat e tyre elementare! Akuzoheshin për vrasje të milicëve dhe për plagosje të tyre! Në aktvendim shkruante: " ...për veprat e kryera të lartëpërmendurit mund të dënohen me dënimin kapital, deri me vdekje !" Derisa unë po ia lexoja aktvendimin me habi, Beqiri më tha: " Djalo, po të kisha mundësi që t'i bashkangjitesha Tahirit dhe babës, ta dhashë besën se kufomat e milicisë as me

kamion nuk do të kishin mundur t'i bartnin. Tani lë të na akuzojnë si të duan. Unë jam shumë i vetdijsëm: këta po mundohen të hakmerren për ata që i ka vrarë Tahiri. Nuk munden dot: Tahiri e baba nuk ka vrarë tre a katër, por një batalion të tërë me milice!"



Beqir Meha

STRATEGJIA E TAHIR MEHËS

Në «Dosjen Meha» organet e sigurimit kanë shkruar hollësisht për aftësitë psiko-fizike, qëndresën dhe vigjilencën e Tahirit. "Tahiri kishte përcjellur me vemendje lëvizjet e çdo milici që e kishin rrethuar. Duke i shikuar me bisht të syrit, i vendosur pranë dritares, kishte reaguar në çdo lëvizje të armëve të tyre!"

Vendosmëria, gjakftohtësia dhe trimëria e Tahirit bëri që ai për 18 orë rresht ta përballonte rrethimin. Që nga ora 01: 00 deri të nesërmen në orën 21 e pesëmbëdhjetë minuta të rezistonte kundër 200-300 milicëve (nga sa mund t'i kishte pasur rrethi i parë). Tërë natën e kishte kaluar pa gjumë e pa ngrënë. Breshëritë e vazhdueshme të armëve të ndryshme, nuk e rrezikonin vetëm atë, por mbarë familjen. Babanë ia kishin vrarë, vajzën ia kishin plagosur. Përpos që mbrohej e sulmonte ishte i detyruar të merrej herë pas here edhe me Salën e vogël në djep, të qarat e së cilës të fusnin në dhe! Ai jo vetëm që i përballoi të gjitha këto, por triumfoi moralisht duke qëndruar me trimëri të rrallë. Siç tregojnë milicët që ishin afër, të rrethit të parë: "Tahiri luftonte edhe këndonte. Herë pas here e këndonte këngën e Dervish Shaqës: «Ti Kosovë mos thuj marova». Na sfidonte dhe na

përbuzte: "Kush afrohet të themeli i kullës sime, aty do të mbetet kurban!" -na thoshte ai, "Ikni or, se qe besa po me dhimbjeni, se cilin të dua e vras. "Herë pas herë na e fuste tmerrin duke bërtitur me tërë zërin që kishte: "O-o-o,...prite, prite Tahir Mehën ore-e-e!» Ai të vriste kur të donte! Plumbi i tij, nuk të kursente. E vrau një milic, natën, duke e marrë në shenjë, vetëm në dritën e flakës së pushkës së tij. Ishte i tmerrshëm, i guximshëm dhe gjakftohtë njëkohësisht" ...

Strategjia e Tahirit i kishte çorientuar milicët gjatë gjithë asaj dite. Me taktikën e tij luftarake të befasonte. Me dhjetëra minuta, herë pas here brenda asaj dite, ai nuk bëhej i gjallë. Kur, milicët që mendonin se e kishin vvarë, ndërmerrnin hapat e veprimit, ai «ringjallej» dhe i godiste! Gjuante rrallë, por plumbi kurrë nuk i shkonte huq! Ky, pra, ishte Tahir Meha, që më 13 maj, ditën e themelimit të milicisë, e theu mitin "e pathyeshmërisë" të njësive speciale të Jugosllavisë!

Milicia jugosllave për ta vvarë Tahir Mehën ka përdorur një arsenal armësh: mjete të blinduara, picgauerë, granata dore, transporterë të blinduar, tankse, lotsjellës, snajperë, minahedhës, tromblona si dhe helikopter që gjatë asaj dite kishte fluturuar pandërprerë mbi kullën e Tahirit. Në "Dosjen Meha" , ndër të tjera, shkruan se për ta vënë në gjumë, apo për ta paralizuar, ata atë ditë kanë hedhur edhe helme kimike: " Pastaj është gjuajtur me tromblona e janë futur edhe mjete kimike përmes vrimave në shtëpinë e tij!»

NJË E "FSHEHTË E HAPUR" PAS 23 VITEVE

Ka mbi dhjetë vite që kam biseduar me shumë veta për të pasur njohuri sa më të sakta për rastin e Tahir Mehës, për ditën e rrethimit të 13 majit. Informata të sakta më kanë dhënë vetëm disa nga bashkëbiseduesit e mi. Të tjerët sikur nuk patën guximin që të flasin për këtë ngjarje! Sigurisht u frikësuan nga e kaluara e tyre, u frikësuan nga Serbia dhe shërbimi i saj, para të cilëve e kanë dhënë betimin. Inspektorët dhe hetuesit e rastit "Meha" e të rasteve të tjera, nuk më kanë habitur, sepse ata e kanë një jetë të tërë në shërbim të Serbisë, në shërbim të pushtuesit. Më kanë habitur disa që frikësoheshin pa arsye dhe nuk guxonin të flisnin për njeriun që ka guxuar të flasë, të luftojë e të vdesë edhe për ta duke u ballafaquar me organet e sigurimit shtetëror jugosllav dhe me një milici të armatosur deri në dhëmbë. Me këtë rast, si dhe më herët, njerëzit mbetën të ndarë në dy kategori: në shërbëtorë të pushtuesit, që nuk guxojnë edhe sot ta shkelin "besën" që i kanë dhënë Serbisë dhe në ata që e kanë kundërshtuar dhe e kanë luftuar atë dhe nuk janë luhatur e nuk janë thyer kurrë edhe pse mbi ta janë ushtruar dhunë, tortura të egra, dënime me vite nëpër burgje, izolime, vrasje e likuidime në forma të ndryshme etj.

Kam pasur shpresë të madhe se do ta fus në dorë tërë «Dosjen Meha», që të mos e marrë vetëm atë që e ka publikuar «Koha Ditore». Te njeriu që shkova për ta marrë materialin, nuk gjeta gatishmëri për diç të tillë! "Nuk guxoj të ta jap materialin e dosjës. Kjo dosje mund të hapet vetëm atëherë kur të kenë kaluar 50 vite nga rasti që ka ndodhur-më tha!"... U habita. Dosja ishte publikuar në gazetë dhe e njëjta nuk i lejohej autorit për ta shfrytëzuar për libër! As sot nuk mund ta kuptoj atë përgjegjësi «zyrtare» që ai ia kishte ngarkuar vetes së vet si duket, në këto rrethana!

Për ta nxjerrë të vërtetën e ngjarjes së 13 majit 1981, ditën kur u bë luftë e ashpër në mes Tahir Mehës dhe milicisë jugosllave, më herët e më vonë, kam biseduar sa e sa herë me Beqir Mehën, me Mehmet Mehën, me Shaban Jasharin, me Hamëz Jasharin, me Jahir Ramën, me Rexhep Kaçanikun, me Avdi Behramin, me Zymer Mehën, me Murat Mehën, me Naser Mehën, me Ilir Mehën, me Ferat Mehën, me Bislim Bislimin, me Haxhi Delinë, me Bedri Tahirin etj. si dhe disa milicëve tjerë të intervistuar që kanë marrë pjesë në rrethim.

Për ta shndritur të vërtetën, janë për t'u cekur dhe për t'u cituar edhe disa të dhëna, që e vlejné të hapen edhe pas 23 viteve, të cilat janë marrë nga ish-shefi i SPB-së për Skënderaj, pas rastit "Meha" edhe nga postkomandanti i stacionit të milicisë në Skënderaj:

"Më 13 maj diku rreth orës 03: 30^{oo} min. Pas konfirmimit së Tahir Meha gjendej në shtëpi, është përgatitur një forcë e milicisë për ta rrethuar dhe për ta arrestuar Tahirin. Para se të vendosej për këtë aksion, organet përkatëse, në fakt gjatë tërë asaj periudhe në ndihmë konsultative dhe të drejtpërdrejtë ishin angazhuar inspektorë të lartë të resoriatit të SKPB-së (Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendëshme), në ndihmë të

kolegëve të tyre në Skënderaj. Ata kishin përpiluar disa plane operative dhe taktike për arrestimin e Tahir Mehës. Në marrëveshje me inspektorët resorialë, iu ishte bërë kërkesë organeve gjegjëse për angazhimin e njësitit special të milicisë për këtë qëllim. (Kuptohet, kërkesa ishte bërë pas dështimit të milicisë vendëse, ku nuk përmenden fare në ç'shkallë ishin ato dështime). Ardhja e njësitit special, menjëherë pasoi me sulm, pa pyetur fare për shkallën e rrezikut që paraqiste Tahiri dhe familja e tij, sidomos Nebihu i cili ishte në katin e dytë të kullës. Komandanti i kësaj njësie Franc Kosi, ka pyetur vetëm se në cilën dhomë gjendej Tahiri. Ai menjëherë i ka vendosur personat e vet në pika të caktuara, duke i përjashtuar forcat vendëse nga aksioni. Ai ka thënë: «As një të mos na perziheni në aksion! Aksioni ka filluar menjëherë. Milici i njësisë speciale Hasanoviq, deri sa ia kishte futur pushkës predhen tjetër të gazit lotsjellës, goditet nga Tahiri në gjoks (2 cm mbi këmishën antiplumb), me revolen e markës "Valter" . Pastaj është goditur milici Muhamet Selmani. Në përleshje e sipër, nga dora e Nebihut, është vrarë edhe milici Tubiq. Duke e parë shkathtësinë dhe saktësinë e Tahirit dhe pasojat që pësoi kjo njësi, në aksion ishte angazhuar edhe vet Franci. Pastaj janë vrarë edhe milici Pejoviq dhe Jovica Milaçiq. I tërë ky aksion, që kishte filluar diku rreth orës 10: 00, të 13 majit 1981, që pati për pasojë luftën ndermjet milicisë speciale, nga njëra anë dhe të Tahir e Nebih Mehës, nga ana tjetër ka zgjatur 10-15 minuta!

Komandanti Franc, duke e parë dështimin e turpshëm në këtë përleshje, ka urdhëruar njësitin që të tërhiqej. Janë angazhuar me dhjetëra milicë, për t'i terhequr të vrarët dhe të plagosurit nga vendi i ngjarjes të cilët i kanë bartur me helikopter. Pas kësaj pllakosje është lajmëruar drejtpërdrejt instanca më e lartë e tyre deri te Sekretari Federativ për punë të Brendshme i

ish-Jugosllavisë, gjenerali Franjo Herleviq, i cili ishte shokuar dhe kishte thënë: "A është e mundur që kjo t'i ndodhë Franc Kosit, elitës së njësive tona speciale!?"

Këto të dhëna (sado që mund të jenë në kundërshtim me të parat), të nxisin ta shtrosh pyetjen: Sa është numri i milicëve të vrarë e të plagosur atë ditë nga dora e Tahirit? Aty thuhet se e tërë kjo ka zgjatur rreth 10-15 minuta, diku rreth orës 10 të paraditës. Në të dhënat e këtij dokumenti (del se Tahiri është vrarë rreth orës 20 e 20 minuta), ku thuhet: "Tahiri ka arritur të shpartallojë rrethin e parë të milicisë. Ai ka hasur në rrethin e dytë dhe është vrarë në largësi nga kulla prej afër 80 metrash!". shtrohet pyetja edhe sa milicë të vrarë mund të kenë qenë deri në orën 21:15 miuta. Ndërkaq të dhënat e dokumentit tjetër nuk përputhen me këtë ku thuhet: "Tahiri ka arritur që ta shpërthejë rrethin e parë rreth orës 21 e 15 minuta dhe është vrarë në largësi prej afro 50 metrash larg kullës" .

Se numri i të vrarëve, atë ditë, ka qenë më i madh kuptohet edhe nga përshkrimi i ngjarjes që i bëhet po në atë dokument: "Pas urdhërit që Tahiri të sulmohej me mjete të rënda, dhe pas vrasjës së Tahirit, për ekspertizë është angazhuar edhe Instituti i Sigurisë Nacionale në Beograd, të cilin e udhëhiqte gjeneralmajori Popoviq. Ai, kur mësoi se Tahiri, gjatë gjithë kohës dhe pasi ishte vrarë Nebihu, kishte përdorur vetëm një pushkë M 48 dhe një revole, shfaqti skepticizëm duke e vlerësuar se një akt të tillë nuk mund të kryhej nga një ose dy person. Ai mbeshteti dyshimin se në vrasjen e milicëve të "njësisë speciale" mund të kenë marrë pjesë edhe milicët vendorë! Ky dyshim rezultoi me ekspertizën balistike, të të gjitha armëve të të gjithë atyre që në momentin e përleshjes me Tahir Mehën kishin qenë prezentë në vendin e ngjarjes. Nga kjo ekspertizë që u bë në Institutin e Sigurisë Nacionale në Beograd, dyshimi shkoi edhe

më tej, duke aluduar se Tahirin e kanë ndihmuar edhe njësitet e mbrojtjes territoriale të Skënderajt. Mirëpo, meqë nuk u gjet asnjë argument bindës për ta arsyetuar këtë "konstantim", armët nuk iu kthyen kurrë më bartësve të tyre.

Ekspertizë i është bërë edhe vendit të ngjarjes, (kullës së Tahir Mehës), të cilën sipas urdhrit nga lart, gati një vit, natë e ditë e kanë mbajtur me roje.

CILA ËSHTË E VËRTETA E 13 MAJIT 1981

Jeta në ilegalitet e kishte pajisur Tahirin me një përvojë mjaft të madhe. Gatishmëria për të papriturat, vigjilenca për t'i zbuluar dhe për t'u mbrojtur nga rreziqet, lëvizjet e kujdesshme dhe me masë, vëzhgimi i terrenit dhe verifikimi i informatave ishin bërë pjesë e jetës së tij. Të gjitha këto ndikonin që ai të vinte në përfundime shumë të shpejta dhe të sakt në mënyrë që të reagoje me kohë.

Kohën më të madhe të ilegalitetit, sidomos atë të fundit, Tahiri e kishte kaluar, në shtëpi të vet. Këtë e kishin marrë vesh edhe organet e sigurimit të cilat po përgatitnin një plan specifik për ta arrestuar Tahir Mehën.

Në bazë të shumë dëshmitarëve, por edhe të fakteve që gjenden në «Dosjen Meha», del se urdhri për rrethimin dhe arrestimin e Tahir Mehës erdhi nga instancat më të larta shtetërore. Në pajtim me to, organet përkatëse të vendit, që më 11 maj, vendosën që secilin ta ngarkonin me detyra të caktuara për këtë aksion që deri në fund duhej të mbetej tepër sekret për milicët vendor.

Shërbimi operativ kishte vërtetuar sakt të dhënën se Tahir Meha në natën e 12 majit do të ishte në shtëpinë e tij. Rrethimi

filloi rreth orës 12-të të natës së 12 majit. Forca të shumta të milicisë, pa bërë as zhurmën më të vogël, nëpër errësirën e natës, u nisën për në Prekaz. Ato u ndanë në tri drejtime: 1- rrugës për në Prekaz të Epërm. 2- nga ana e Polacit-Kodralive. 3- nga ana e Jasharajve. Pikëtakim të vetëm kishin kullën e Tahir Mehës. Kështu u realizua hallka e parë e rrethimit që ishte vendosur në një distancë të largët nga kulla. Qëllimi ishte i qartë: ta bllokoni çdo shteg, nga mund t'i shpëtonte Tahiri rrethimit dhe ta paralizoni çdo ndihmë eventuale që mund ti ofrohej atij, nga jashtë, me këtë rast. Rrethi tjetër ishte vendosur, rreth orës 01:00, që po pasonte, shumë më afër kullës. Në të njëjtën kohë, ishte rrethur e tërë lagja Mehaj e në veçanti shtëpia e Beqiri Mehës dhe e Mehmet Mehës, që të mos e ndihmonin Tahirin e Nebihun gjatë rezistencës. Vendosja e këtij rrethi fillimisht ishte diktuar nga qentë të cilët u alarmuan e pastaj, siç kemi shkruar më lart edhe nga vet Tahiri.

Me të zbardhur të ditës së 13 majit, apo thënë më mirë se me krismat e pushkëve të para, ishte dhënë urdhri edhe për hallkën e tretë, që u vendos në një largësi pak më të madhe nga kulla e Tahirit. Përpos milicëve, numri i të cilëve ishte i madh në këtë hallkë ishin prëfshirë edhe njësitët të rezervistëve të mbrojtjes territoriale të Skënderajt. Pasi përfundon procedura e rrethimit, fillojnë bisedimet e drejtpërdrejta të organeve të sigurimit me Tahirin. Tahiri e kishte më se të qartë se konflikti i armatosur me milicët, për të cilin ishte përgatitur gjatë ishte i pashmangshëm. Ai ishte shumë i qetë, shumë i vendosur dhe e dominonte situatën plotësisht. Ai po i përgatiste psikikisht edhe anëtarët e familjës së vet të cilët milicia nuk i lejonte që të dilnin nga shtëpia! Ai po bisedonte me fëmijët dhe gratë, që ishin nën shënjestrën e armëve të milicëve! Organet e sigurimit u munduan ta bindin Tahirin që të dorëzohej. Por Tahiri duke e

nxjerrur gjoksin në dritare, u kishte thënë qartë se "me u vra po, por me u dorzua kurrë" !

Është e vërtetë se Tahiri kërkoi disa herë nga organet e milicisë, që t'ia lironin familjen të dilte jashtë, por kërkesa e tij nuk u përfill! Në një rast ata i thonë Tahirit se nuk po lejonte Nebihun që të dorëzohej! Tahiri ua kthen: "Po unë qe sa kohë po ju lutem që të ma lejoni familjen të dalë jashtë e ju nga ana tjetër po më thoni se po e pengoj babën që të dorëzohet. "Pas këtyre fajlëve pason thirrja e Tahirit me zë të lartë: "O baba plak, Hyqymeti na ka rrethue!. Ti e di se unë nuk dorëzohem, po ti dil. Si të dalësh ti, mbase i lirojnë të dalin edhe gratë dhe fëmijët. Ta dini së pa ju e kam shumë më lehtë të qëndroj këtu në kullë!" ... "Jo, or Tahir djali" , – ia ktheu Nebihu. "Baba nuk të lë vetëm për jetë. Jo se je biri im, por tani ne jemi bashkëluftetarë. Baba që 50 vjet po e pret këtë ditë. Le të vdesim duke kënduar e duke luftuar kundër shkaut se bashku biro!"

Vendimet ishin të prera. Vend për hamendje nuk kishte më. Kulla sikur ua kishte zili trimave që po i mbante në gjirin e saj. Muret e saja të trasha, ende nuk e dinin se a do të mund t'i mbronin trimat, nga predhat dhe granatat të shumta që do të derdheshin atë ditë mbi to!

Tahiri u pozicionua në katin e dytë, dhe präcillte çdo lëvizje të milicëve dhe të armëve të tyre, ndërkaq Nebihu zuri vend në katin përdhes. Milicia vazhdonte me presionin për dorëzim. Në veçanti kërkonte të dorëzohej Nebihu e ta linte Tahirin vetëm. "Për këtë nuk kemi se çka të bisedojmë më" , – ua preu edhe një herë shkurt Nebihu: "Nuk e lë birin tim vetëm. Ju po deshët lironie familjen të dalë jashtë, se i trenuat rob e fëmijë!" Pas kësaj, për një kohë, mbretëroi heshtje e plotë.

Agu e gjeti lagjen Mehaj nën rrethim të hekurt. Askë nuk e linin të dilte nga shtëpitë. Organet e sigurimit po luanin edhe

me një kartë tjetër. Duke shpresuar se do të kishin sukses me disa njerëz që po i dërgonin si ndërmjetësues. Jahir Rama nga Prekazi tregon: "Sa më pa Tahiri më tha: «Jahir, kot të kanë sjellë këtu. Unë nuk dorzohem. Për luftën e sotit do të shkruajnë shumë gazeta. Ta dhashë besën, se do të luftojë me Serbi deri sa të ketë shpirt në trupin tim. Po lemi do cigare në të paçin qëlluar me veti dhe largohu. "Pas tij e dërguan një Zenë Klinën, të cilin Tahiri as qe e përfilli.

Diku rreth orës 10: 00 biseda për dorëzim mori fund. Milicia e përforcuar edhe nga njësi special, mori hapat e parë për t' i hyrë Tahirit brenda. Fillimisht hodhën lotsjellës, por nuk u godit caku. Tahiri që ua ktheu me të shtëna i goditi disa milicë. Pasuan të shtënat e pandërprera. Tahiri këndonte dhe herë pas herë shtinte. Ai shtinte rrallë. Kuptohej, ai po mendonte për një rezistencë të gjatë. Shpesh e thërriste babanë e vet Nebihun:

- O-o-o, Nebih Meha ore-e-e!

- O- o-o, ho-ia-a-a, – ia kthente Nebihu!

- A do të qëndrojmë, babo-o-o?

- Po besa, do të qëndrojmë e do të këndojmë, – ia kthente Nebihu përgjigjen që e shoqëronte me krisma pushke. Tahiri gjatë asaj dite, disa herë e ka kënduar këngën: "Ti shqipni mos thuaj marova" ...

Gjendja sa vinte e po keqësohej. Luftimet po ashpërsoheshin e shkallëzoheshin. Fëmijët dhe gratë po vuanin më së tepërmi. Ato qëndronin nën goditje të vazhdueshme të armëve dhe të helmeve kimike. Katër a pesë milicë Tahiri i kishte vrarë që në orët e para të përleshjës. Njëri prej tyre thanë se ishte shqiptar! Pas vrasjes së milicëve të parë u krijua rrëmujë. Qeni të zotit nuk e njihte. Dështuan edhe përpjekjet për t'u ngjitur me llotra në katin e dytë. Dështoi edhe gazi lotsjellës.

Dështuan edhe granatat e dorës. Disa prej tyre nuk e qëllonin cakun, nuk i qëllonin frengjitë. Disa të tjera që binin brenda Tahiri arrinte t'ua kthente prapa. Milicët bëheshin rrafsh me tokë. Nuk guxonin ta ngritnin kokën, ngase pushka e Tahirit i merrte në lule të ballit. Pas çdo rrebeshi të të shtënave, Tahiri ndalej. Nuk shtinte, nuk lëvizte. Priste reagimin. Në moment kur milicët, përpqeshin t'i tërhiqnin shokët e tyre të vrrarë e të plagosur, që zhgërrheshin nga plagët në oborrin e kullës, Tahiri, si era, dilte në dritare dhe i godiste! Një nga milicët e njësitit special që kishte marrë zemër të futej në katin përdhes goditet për vdekje nga Nebihu. Ai, ia merr pushkën, dhe provon ta fusë brenda duke e tërhequr zvarrë për jake të xhaketës. Mirëpo milici ishte i rëndë. Breshëria e të shtënave që nuk ndalej e pengonte Nebihun. Në përpjekje e sipër Nabihu plagoset në shuplakën e dorës së djathtë. Plumbi ia kishte këputur gishtat, por ai nuk e kishte lëshuar armën e milicit të vrrarë. Edhe ashtu i plagosur, pozicionohet në stallën mbrapa shtëpisë, për ta vazhduar rezistencën. Diku pas dite, Nebihu që mbronte katin e parë të shtëpisë dhe stallën ishte goditur me mortajë. Franc Kosi, të cilin njësitit i vet e mbronte me të shtëna, futet në stallë. Franci, nga frika se mos po ngrihej Nebihu që në atë moment po jepte ende shenja jete, e godet me rafal automatiku. Të dy qetë e Nebihut që kishin qenë të lidhur në stallë tërbohen nga krismat e armëve. Njëri, që pos Nebihut nuk guxonte askush ta lidhte e ta zgjidhte, meqë vriste keq, e këput litarin dhe ia mësyn Francit, i cili i tmerruar nga brirët e mprehta të kaut, nis e bërtet me të madhe: "Ndihmë, ndihmë! Më mbyti, me mbyti!" Milicët, që po e dëgjonin, nuk e dinin se çka po ndodhte brenda shtallës. Mendonin se mos Francin e kishin zënë Nebihu me Tahirin e po ia nxirrnin shpirtin për ngadale. Aq i kishte kapur frika, sa s'kishte burrë nëne që ia mësyente stallës, ata vetëm shtinin me armë pa

ndërprerë... Pas pak kohe, duke sharë e bërtitur, del Franci, me një pushkë që e mbante si trofe në dorë. "E vrava plakun dhe ia mora pushkën!" mburrej ai. Milicët, fillojnë të dyshojnë se mos Franci kishte luajtur nga frika. Pushka që ai e mbante në dorë nuk ishte e Nebihut, por e një polici, që pak më parë kishte mbaruar në duart e Nebihut.

Pas një kohe fëmijët dhe gratë e Tahirit mësyjnë derën dhe dalin përjashta duke vrapuar në drejtim të shtëpisë së vëllait të Tahirit. Në momentin kur fëmijët dualën nga shtëpia njeri nga milicët e njësitit special shtinë me armë mbi ta dhe plagos rëndë vajzën e Tahirit e cila duke u tërhequr zvarrë futet në hambarin e drithit. Tahiri tani ishte fill i vetëm në kullë. Për milicët ishte e qartë se rreziku për ta, tani ishte edhe më i madh. Tahiri që kishte mbetur me një foshnjë nëpër këmbë, që kërkonte edhe kujdesje, nuk jepej. Luftonte me një taktikë të çuditshme që i befasonte kundërshtarët. Shtinte dhe qëllonte mirë, herë nga njëra, herë nga tjetra dritare e kullës, sa krijohej bindja se brenda nuk ishte një, po nja dhjetë veta! Kur shtëpia sulmohej me të shtëna dhe mbështillej nga tymi e zjarri, Tahiri, si të ishte vrarë e linte pushkën mbeshtetur në dritare me tytë gjysmë jashtë. Milicët së pari pritnin, pastaj thërrisnin e shtinin, por ai nuk ndihej i gjallë! Sapo ata ngjiteshin me shkallë deri te dritarja, kërciste revolja apo bomba. Nga dy-tre milicë binin lëmsh të vrarë a të plagosur. Atë ditë në këtë mënyrë njësi i policisë speciale pësoi disa herë.

Milicët që filloi t'i kapte paniku nuk po i bindeshin më Francit. Pati raste kur u shanë dhe sa nuk u vranë me armë mes vete! "A po do që të vritemi të gjithë në Prekaz? A nuk e sheh se si na ka larë me gjak!", – i tha njëri në grindje e sipër komandantit Franc, i cili iu kërcnuu: "Unë komandoj këtu. Nuk ka tërheqje pa i vrarë të gjithë. Edhe me topa do ta rrah këtë vend, do t'i djeg edhe themelet e kësai kulle!"

SI U VRA TAHIR MEHA

Tërë ajo ditë u përshkua me luftime herë të rrepta e herë më të matura. Vetëm sa kishte filluar rënia e muzgut të parë e më këtë edhe fundi i asaj dite të përgjakur. Menduan se nëpër errësirë do të futeshin më lehtë në kullë. Kështu edhe vepruan. Pas një heshtjeje, relativisht të gjatë, njëri nga milicët e mori një sëpatë dhe iu afrua derës së hyrjes që ta thyente. Tahiri nuk ndihej i gjallë. Menduan se e kishin varrë, por jo, nuk doli ashtu. Në momentin kur milici filloi ta godiste derën e kullës me sëpatë, u dëgjuan dy krisma dhe britmat e milicistit. Franci duke bërë titur me të madhe urdhëroi ndërprerjen e të shtënave. Ai kërkoi tanksin.

Në atë çast Tahiri, që qëndronte pranë dritares, iu tha me zë të lartë: "Deri në mëngjes do t'iu vras të gjithëve!" Prapë pasuan breshëri të shtënash. Një nga milicët e kësaj njësie ishte ngritur gjysmë në këmbë dhe nuk po e nderpriste rafalin, ngase ishte humbur fare. Në atë moment Tahiri, që nga koridori i shtëpisë, duke e pasur për orientim flakën e armës së kundërshatarit, e godet milicin në lule të ballit!

Franci prapë urdhëroi ndërprerjen e zjarrit. Ai po ashtu urdhëroi që të vendoseshin reflektorët, që ta zbulonte Tahirin

po të ikte nëpër errësirë. Kërkoj që me anë të tanksit të rrëzohej shtëpia. Ora po i ofrohej njëzetënjëshit. Atë natë askush s' mund të llogariste se do të dilte i gjallë, mëngjesi ishte larg!... Tahiri po i hante një nga një milicët e njësisë speciale! Tahiri e kishte nuhatur planin e Francit. Pa dyshim se i kishte dëgjuar edhe urdhërat e Francit, prandaj ishte bërë gati edhe për këtë. Kur tanksi theu derën e hyrjes dhe rrëzoi pjesën e parë të murit të kullës, Tahiri po qëndronte mbi trarët e katit të dytë që kishin mbetur varur. Kur tanksi u tërhoq mbrapa për në oborr, që ta godiste pjesën tjetër të murit, Tahiri, kërceu mib tanks. Duke e parë rrezikun se po zbulohej nga reflektorët e shumtë, kërceu nga tanksi dhe arriti ta kalonte edhe pritën e parë! Mirëpo, kur i afrohet gardhit tjetër të arës, diku rreth 80 metar larg shtëpisë, diktohet nga prita e dytë e cila shkrehu dy rafale të përnjëhershme, që u shoqëruan me dy krisma të forta të një arme të rëndë.

Në orën 21,15 minuta, më 13 maj 1981, u vërtetua vrasja e Tahir Mehës. Në kontrollin e parë që ia bënë ia gjetën: një revole të markës "Valter" me një çantë rripi në krah me rreth 30 predha, një pushkë M 48 me 200 predha, katër bomba dore, një thikë dhe një copë bukë misri në xhep, të cilën e kishte kafshuar dy-tri herë gjatë asaj dite. Në xhepin tjetër kishte edhe rreth gjysmë pakete cigare dhe një çakmak.

RËNIE MADHËSHTORE

Tahiri kishte mbyllur sytë. Flokët e krehur mbrapa, dhe mustaqet sapo të lëshuara i rrinin bukur. Të veshur kishte një këmishë ngjyrë të kaltërt të çelur dhe xhakëtë e pantallona të kaltra paksa në të mbyllur. Edhe pas rënies, sikur po i buzëqeshte Kosovës. Nëntë plumba e kishin marrë në trup, shtatë prej të cilëve në gjoks dhe dy në anën e djathtë të kraharorit. Tamam si dikur Gjergj Elez Alinë! Me nëntë plagë në trup!...

Tahir Meha ra në moshën 38 vjeçare. Ra sepse më shumë e deshi lirinë se jetën.

Ra se bashku me babanë plak Nebihun 71 vjeçar. A ka diçka më madhështore dhe më të fuqishme, se kur një prind bie në mbrojtje të fëmijëve dhe të familjes së vet? A ka diçka më madheshtore, se kur një trim bie duke e mbrojtur bashkëluftëtarin e vet? A ka diçka më madhështore se kur një luftëtar bie në mbrojtje të dinjitetit të vet kombëtar, në mbrojtje të atdheut të vet? Akte të tilla, që i njej historia jonë, do të përsëriten edhe më vonë edhe nga të tjerët. Do të përsëriten edhe me Jasharajt e mëdhenj të Prekazit!

Tahir Meha ra duke e lënë të hapur rrugën e luftës për liri, të cilën më vonë do ta vazhdojnë me përkushtim bijtë e popullit

tonë, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata për t'i realizuar aspiratat shekullore dhe amanetin e qindra dëshmorëve, së bashku me ta edhe atë të Tahirit, vranë me pushkë robërinë e gjatë.

Trimat si Tahiri janë të rrallë. Të biesh për atdhe është një fat i madh. Ky fat nuk i buzëqesh çdonjërit. Ai u buzëqesh vetëm atyre që janë përjetësisht të përkushtuar ndaj çështjes së madhe të atdheut. Atyre që çdoherë janë në shërbim të kombit. Pra, ky fat i buzëqeshi edhe Tahir Mehës!



Tahir Meha, pas rënies heroike

VARRIMI I TAHIR DHE NEBIH MEHËS

Në mëngjesin e hershëm të 15 majit, pasi që organet e sigurimit kishin konstatuar vdekjen e Tahirit dhe të Nebihut, kishin urdhëruar familjarët e tyre që t'i varrosnin sa më shpejt, pa prani të njerëzve e pa rite fetare. Madje UDB-ja, kishte urdhëruar që të mos organizonin as pritje për ngushëllime!

Shokët, miqtë, dashamirët dhe bashkëfshatarët e tij nuk kishin ndejur duarkryq. Nuk e kishin përfillur ndalesën e organit të lartëpërmendur. Pos të afërmit e Tahirit, atë ditë për të marrë pjesë në ceremoninë e varrimit, kishin shkuar edhe Shaban Jashari me dy të bijtë, me Hamzën dhe me Ademin, Hajredin Celi, Bislam Bislimi e shumë të tjerë. Ata ishin të vendosur që të dy trimat t'i përcillnin në mënyrën më të mirë dhe më madhështore për në banesën e tyre të fundit – për te varrezat e Mehajve.

Po i pritnin njerëzit që vinin. Po i përgatitnin e arkivolet. Po përgatitej dreka që do të shtrohej për nderë të të rënëve. Kishin ftuar edhe hoxhën për të bërë ritet fetare. Ishin mbledhur rreth 60-70 burra që do t'i përcillnin martirët.

Në ballë të oxhakut si gjithëmonë ishte Shaban Jashari. Ai i printe bisedës së burrave në odë. "Ne kemi përjetuar mjaft,

por kështu nuk ka ndodhur as në kohën e Turkut. Të çohet në këmbë një hyqymet i tërë e të luftojë me dy veta, kjo nuk është dëgjuar ndonjëherë! Tahiri dhe Nebihu ishin njerëz të mirë. Ata gjatë gjithë jetës së tyre, askujt nuk i kanë bërë kurrë asnjë të keqe. Ky pushtet ia ka plagosur edhe vajzën dhe ia ka trenue familjen!" – e shprehte përnjëherësh urrejtjen dhe dhimbjen Shaban Jashari.

Vetë Shaban Jashari, me të dy bijtë, Ademin dhe Hamzën, e kishte marrë përsipër rregullimin e arkivoleve. Në fillim i nderuan trimat duke ndenjtur gatitu. Në prani të dhjetëra a më shumë burrave, Ademi, që në atë kohë i kishte vetëm njëzet e gjashtë pranvera, foli me zë para të gjithëve:

- "Ne do ta vazhdojmë rrugën e Tahir e Nebih Mehës. Do të hakmerremi dhjetë fish për ta. Do të hakmerremi për të gjitha të zezat që ky pushtet po i ushtron mbi ne!"

- Biro-o! Je i ri. Burrat nuk flasin para kohe – ia priti Shabani.

Ademi e pa babanë e vet me habi. Ishte shumë i mllfosur dhe nuk e fshihte dot urrejtjen.

- "Këtë do ta shohim!" – e përfundoi trimi dialogun duke marrë vendim të prerë në vete që ta vazhdonte rrugën për liri pa e marrë parasysh çmimin e saj.


Tahirin dhe Nebihun, me të gjitha nderimet e mundshme, i varrosën diku rreth orës 16 të asaj dite. Pas varrimit të pranishmit, të prekur thellë për këtë tragjedi, filluan të shpërndahen secili në drejtimin e vet.

Milicia vendosi çadrën në lëmën e kullës së Tahir Mehës ku do të qëndrojnë për një kohë të gjatë. Për gjashtë muaj të tërë u bënë ekspertiza të shumta. Në vendin e ngjarjes erdhi edhe vetë Franjo Herleviq. Ata nuk po gjenin shpjegim. Nuk mund të

besonin që nga kjo kullë një person t'i vriste të gjithë ata milicë! "Ku e ka kryer Tahiri shkollimin ushtarak?" "A mos ka qenë ndonjëherë ilegalisht në Shqipëri, për t'u stërvitur?" - pyesnin Franjo Herleviqi dhe milicët e pranishëm pa gjetur përgjigjen. As mjekësia ligjore nuk kishte përgjigje. Të gjitha vrasjet ishin bërë vetëm me nga një plumb të së njëjtës armë! Gjyqtari hetues i "rastit Mehaj" , Rexhep Kaçaniku, para një viti (më 2003) në një akademi përkujtimore, kushtuar Tahir Mehës pat thënë: "Tahir Meha nuk ka shtënë kurrë dy herë në të njëjtin milic!" ...

Pas shtatë muaj paraburgimi, në mungesë faktesh e provash, lirohen Mehmet dhe Beqir Meha. Organet e SPB-së i kishin thënë Beqirit që ta rrëzonte kullën e Tahirrit. "Pushteti do të ndihmojë që ta ngritësh një të re në vend të saj për t'i strehuar fëmijët e Tahirrit që kanë mbetur pa kulm mbi kokë!" -i kishin thënë Beqirit. "Ju ma keni vrarë vëllanë edhe babanë. Ma keni plagosur vajzën e vëllait,ia keni rrënuar shtëpinë dhe tani po kërkoni që unë ta vrasë kullën e Tahirrit për së dyti! Për këtë edhe do t'më paguani!... Kjo është ndihma që më ofroni ju mua! Si s'keni turp, mor të mjerë – ua kishte përplasur Beqiri mu në surrat.

Pushtuesit nuk kënaqeshin vetëm me vrasjen e Tahirrit e të Nebihut. Ata donin që t'i fshinin edhe gjurmët e asaj rezistence. Këta të mjerë harruan se populli ynë nuk i harron heroizmat e bijve të vet që lanë vullë të pashlyeshme në histori. Ata nuk mund ta kuptojnë se kjo kullë, si edhe ca kulla të tjera, që u goditën për shkatërrim nga tanku i tyre, i kanë themelet në zemër të popullit, ato nuk rrënohen kurrë. Kulla e Tahir Mehës do të mbetet përjetësisht si kullë-lëgjidë, ashtu siç ka mbetur kulla e Kamer Loshit, e Oso Kukës, e Azem Bejtës,dhe shumë kulla të tjera në tokat shqiptare-permendore të historisë sonë të lavdishme.



TAHIR MEHA HYRI NË KËNGË

Pa i përfillur kërcnimet e UDB-së, populli u solidarizua shpirtërisht me familjen Meha. Te varri i Tahirit dhe Nebihut me dhjetëra herë u vunë kurora lulesh dhe banderola me shkrimin: "Lavdi veprës dhe jetës së Tahir e Nebih Mehës!" U vunë flamuj mbi varrezat dhe mbi kullën e tyre legjendë. Në tërë Kosovën e më gjerë, në oda, në tubime, në dasma e ahengje apo edhe në rast mortit bisedohej me respekt për qëndresën heroike të Mehajve. Në veçanti vihej në spikamë jehona e pushkës së tyre përmes së cilës i trguan pushtuesit se shqiptarët për lirinë e vet janë të gatshëm ta përdorin edhe armën. Qëndresa heroike dhe akti i sakrificës e flijimit për liri u bënë motiv fymëzimi për rapsodët që nëpër oda me tingujt e çiftelisë, jo vetëm që e përjetësonin shembullin e tyre, por edhe e përcillnin mesazhin se si duhet të luftohet e të sakrifkohet për lirinë e atdheut:

*Babë e bir janë t'uj luftue,
Me flakë kulla asht mbulue.
Sa bajnë luftë, sa janë t'uj knue,
Kishe thanë se janë Drangue!
Shumë janë vra, s'po mujnë me i çue
Po dojnë tanë, ata me i farue!...*

Rapsodi popullor përshkruan luftën e pabarabartë të dy vetave, babë e bir, të cilët me një armatim krejt modest, luftojnë kundër një ushtrie që përpos armëve të tjera përdor edhe tankun:

*Kush po e ndez o pushkën flakë?
Tahir Meha me babën plak.
N'kullë të madhe o në malësi,
Ballë për ballë me një ushtri!
Po shkrijnë hekur babë e djalë,
S'po dorzohen për të gjallë
Tanksa e topa i kanë ndalë!...*

Në spikamë vihet, qëllimi i lartë, që e përligj luftën dhe sakrificën për liri, i personazheve të ngjarjes që shpeshherë marrin përmasa mitike:

*Luftuan trimat për liri,
Dogjën kullën rrafsh me tokë.
Gjakun dhanë ata për shqiptari,
S'durojnë rob me kanë nën Serbi...*

Krijuesi popullor na e përshkruan edhe vendin e kullës ku është pozicionuar Tahiri. Me dashuri flitet edhe për bashkëluftëtarin e tij Nebihun, "babën plak", i cili e kishte ndarë mendjen të luftonte me të birin kundër pushtuesit deri në vdekje. Lufta është e pabarabartë dhe e ashpër, por qëllimi i lartë fisnik dhe vendosmëria e dy vetave, bëjnë që numri i armiqve të vrarë të jetë tejet i madh:

*Tahir Meha n't' dytin kat,
Luftë po bënë me Beligrad,
Ka qëllu me babën plak,
Po donë kullën me djegë flakë
S'kanë vra shumë veç shtatëdhjetë e shtatë!...*

Luftëtari është i vetëdijshëm se e drejta është në anën e tij, andaj edhe pse është vetëm me babanë kundër një ushtrie, gjen forcë morale që të qëndrojë dhe të tregojë epërsi në atë luftë:

*Tahir Meha del n'frenji,
Kqyr ushtrinë ai me dyrbi
Po ma thërret babën e vet:
"Çinro babë e ban gajret,
As ni shka mos me na pshtue
kam ba njetin tanë me i farue!"...*

Moralisht, po aq lart, qëndron edhe babai i Tahirrit, Nebihu. Ai për as një çast nuk tërhiqet nga flakët e luftës. Nuk i dhimbet aspak jeta por shpreh kënaqësinë se e ka shpague veten shumëfish:

*Nebih Meha çka po thotë:
"O Tahir, o djali jem,
Baba vetëm o ty nuk t'lenë.
Ka vra baba kapetana,
A po i nien si po u shkon gjama!
Kemi kullën krejt prej guri,
S'po ia len as topi murit!
Po valon në kulm flamuri,
Shtatë deri tash ua ka lanë plumbi!
Se po vdes s'po më dhimet jeta,
Kapetanin mora, me shtatë veta!..."*

Tahir dhe Nebih Meha, me luftën e sakrificën për liri fitojnë admirimin e popullit që shprehet në vargjet shumë të popullarizuara të epikës sonë, që këngëtari i ka përshtatur edhe për këtë rast:

*Lumja kulla o kanë ka mrena
Tahir Mehën o me shtatë zemra...*

Rezistenca e Tahir Mehës u bë simbol i krenarisë sonë kombëtare. Jehona e pushkës së tij do të shoqërohet edhe me krismat e armëve të UÇK-së që arriti ta shporrë armatën jugosllave nga Kosova:

*Ajo pushka e Tahirit,
Nis e shkrep në dorë t'Beqirit.
Pushka e tij o nizat vjet
N'ballë armikun e godet.
Bashkë tre burra vijnë të varri,
Ni be bon Adem Jashari:
"Veç ky shteg e veç kjo udhë
Sjell lirinë o me flamurë!"...*

QËNDRESË KRENARE DHE SHPRESËDHËNËSE

Ngjarjet madhore të pranverës së vitit 1981, popullin tonë e zgjuan nga letargjia që e kishte kapluar. Demonstratat, në kuadër të saj edhe rezistenca e Tahir Mehës, e çorrën para botës maskën e "vëllazërim-bashkimit", nën të cilën serbët i fshihnin dhëmbët e urrejtjes patologjike kundër shqiptarëve.

Përkundër masave represive që i ndërmori pushteti shtypës, demonstratat e atij viti dhe qëndresa heroike e Tahir Mehës u mirëpritën nga populli dhe ngjallën krenarinë kombëtare. Qëndresa e Tahir Mehës, u ngrit në shkallë simboli dhe i dha zemër rinisë shqiptare. Rënia heroike e Tahir Mehës dëshmonte bindshëm se sakrificat për liri është akti më sublim në jetën e individit dhe të një populli. Qëndresa dhe sakrificat e tij, që forconin traditën e luftës për liri, rivërtetuan idenë se lufta për liri, bartëse e së cilës do të bëhet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, mund të realizohet me sukses pa marrë parasysh epërsinë e pushtuesit.

Për luftën dhe rënien e Tahirit shkruan gazetatat e shumta në Kosovë dhe jashtë saj. Parandjenja e Tahirit, të cilën e shprehte duke thënë: "Djema, kur të luftoj unë do të shkruajnë gazetatat!", u bë realitet. Lufta dhe akti i rënies së tij do të

shërbejnë si burim frymëzimi që të shkruhen sa e sa poezi, sa e sa libra dhe do të krijohen sa e sa e vepra në fushat e ndryshme të artit.

Ngjarjet e vitit 1981 dhe rënia e Tahir Mehës, në mbrojtje të dinjitetit personal e kombëtar, hynë edhe në fjalorin e analizave dhe polemikave të diplomatëve dhe instancave më të larta shtetërore. Ato trazuan edhe marrëdhëniet ndërshtetërore edhe ashtu të acarura, ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, mu për shkak të çështjes sonë kombëtare që kishte mbetur e pazgjidhur. Shqipëria, në atë kohë, e vetëdijshme se lufta për liri nuk do të ndalej me propagandë dhe me masa represive, i drejtohet Jugosllavisë me tonin më profetizues e më kërcënues: "Zotërinjë të Beogradit, mos luani me zjarrin se vetë do të digjeni në të!" Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Demonstarata e vitit 1981, aktet heroike si ato të Tahir e Nebih Mehës dhe lufta çlirimtare të UÇK-së, ia bënë varrin Jugosllavisë prej nga nuk arriti të dilte dot.

SIMBOL TRIMËRIE E SAKRIFICE PËR ATDHE

Shërbimi sekret i ish-Jugosllavisë, kishte punuar në Kosovë në mënyrë që sa më shumë shqiptarë t'i fuste në shërbim të vet. Këta të mjerë, që nuk ishin pak, spiunonin edhe nënën e tyre poqëse e zinin duke folur, apo duke punuar kundër pushtuesit, Jugosllavisë së Titos. Spiunët, tani me vepra konkrete, duhej ta tregonin besnikërinë ndaj Serbisë e Jugosllavis. Demonstaratat e atij viti dhe rezistenca si ajo e Tahir Mehës, nga pushtetmbajtësit, u zgjodhën si terren i përshtatshëm që t'i sprovonin shërbëtorët e vet. Duke i shfrytëzuar rezultatet e gjahut të tyre, regjimi i Beogradit arrestoi dhe burgosi një numër të madh shqiptarësh, sidomos të rinj, mbi të cilët u ushtruan dënime dhe tortura drakonike dhe filloi ta zbatojë procesin famëkeq të diferencimit ideo-politik.

Për ta dënuar Tahir Mehën dhe qëndresën e tij u organizua një fushatë e tërë propagandistike. U ngritën në këmbë të gjitha mekanizmat shtetërore. Përfaqësues të LSPP-së dhe të LKJ-së mbanin mbeldhje jo vetëm nëpër qendra, por edhe nëpër bashkësitë lokale të fshatrave të Kosovës. Nga ana e tyre, në ato takime, Tahiri etiketohej si armik, bandit, kriminel, ballist e bir ballisti. Kryetar i LSPP-së i asaj kohe për komunën e

Skënderajt në një intervistë që i kishte dhënë gazetës "Borba" dhe gazetave tjera të Beogradit, pasi i përsërit si papagall edhe një herë etiketat e mëparshme, përfundon se "Tahiri, bashkë me babën e tij, si armiq që ishin, e kishin merituar plumbin e pushtetit komunist të Jugosllavisë."

Përkundër fushatës propagandistike, përkundër arrestimeve të shumta, përkundër dënimeve dhe torturave më të egra populli as nuk mashtrohej e as nuk frikësohej. Ai e kishte të qartë se bartës të kësaj fushate ishin kumbarët e Miliç Kërstave, që me baballarë e gjyshër u kishin shërbyer të huajve. Sa më shumë që përpiqeshin për ta njollosur figurën e Tahir Mehës, ata para popullit po njollosnin veten e tyre, po bëhëshin sinonim i turpit, që mund të lahej vetëm me ndëshkimin që populli i bën tradhtisë.

Populli, Tahir Mehës dhe të gjithë atyre që ishin ngritur kundër padrejtësive dhe shtypjes, ua dha vendin e merituar duke u ngritur edhe këngë lavdie. Tahir Meha, me qëndrimin, luftën dhe rënien e tij, në ndërgjegjen tonë kombëtare po ngrihej në simbol trimërie e sakrifice për atdhe.

"BISHTI I SËPATËS MA SHPETOI JETËN !"

*(Intervistë e një milici të njësisë speciale që
plumbi i Tahir Mehës e kishte qëlluar në sy)*

Këtë intervistë e kam lexuar në një gazetë serbe të ilustruar në burgun "Zabela" të Pozharevcit. Titulli i intervistës ishte përafërsisht ky që është shënuar më lartë. Meqë nuk kam pasur mundësi ta ruaj intervistën apo ta gjejë më vonë, fragmentet që pasojnë i kam nxjerr nga memoria ime ku janë fiksuar e konzervuar deri në ditët e sotme:

"Diku në orët e mbrëmjes, pasi humbëm shumë shokë, vërtet nuk dinim më se si të vepronim. Kishim shtënë aq shumë sa që kishim përshtypjen se as mizat në kullë nuk kishin shpëtuar. U ndalëm. Pritëm nja 10-15 minuta. Nuk po shihej, nuk po dëgjohej asnjë levizje! E mora një sëpatë dhe me shumë kujdes u ofrova te dera e kullës. Fillova ta goditja derën. Pas çdo goditje fshihesha prapa murit. Kurrfarë reagimi nga brenda. Krijova bindjen se Tahiri ishte vvarë. Me qëllim që të futesha brenda, fillova të goditja derën pandërprerë. Në çast m'u duke sikur dëgjova ca hapa të lehtë dhe ndala. Prapë qetësi. Mendova

se më kishin mashtruar veshët. Përsëri vazhdova me goditje. Më befaskan dy të shtëna revoleje. "Oh nënë!" – bërtita dhe dhashë alarmin për ndihmë duke e mbajtur syrin me të dyja duart.

Në bazë të ekspertizës që është bërë më vonë është konstatuar se njëri plumb e ka goditur saktësisht bishtin e sëpatës që e ka bërë plumbin ta ndërrojë drejtimin. Pra, bishti i sëpatës ma shpetoi jetën! Plumbi tjetër me ka kapur në syrin e djathtë. Nuk e di se a do të më shpetoj syri?" – pohonte në atë intervistë milici serb nga Peja.

TAHIR MEHA E THEU MITIN E "PATHYESHMËRISË" SË JUGOSLLAVISË

Ishte krijuar përshtypja se jugosllavia ishte ndër shtetet më stabile në rajon e më gjerë. Ajo, madje, shtirej si shtet i painkuadruar dhe si vend ideal ku respektoheshin të drejtat e plota të përkatësive të ndryshme etnike. Propagandohej se edhe ushtarakisht ishte ndër shtetet më të forta në Evropë! Sa i përket respektimit të të drejtave, ishte e kundërta. Ajo, me të dyja këmbët, në veçanti po i shkilte të drejtat e shqiptarëve, pastaj të boshnjakëve, të romëve, të turqve e të popujve të tjerë që nuk ishin sllavë. Ishte shndërruar në një ferr të Ballkanit dhe Evropës, që për fat të keq bota këtë do ta vërejë shumë me vonesë. Mirëpo, edhe pse mjegulla e propagandës kishte errësuar qiellin, ajo do të shpërndahej me diellin e parë, që filloi të shndriste në Kosovë.

Përmes borxheve në formë kredie, Titoja, që e bindi botën se Jugosllavia ishte një shtet demokratik, mundi përkohësisht ta kalonte krizën ekonomike dhe të krijonte iluzione se ekonomia e këtij shteti edhe në të ardhmën do të kishte perspektivë. Por, borxhi prej 29 miliardë dollarësh, që zyrtarisht u pranua pas vdekjes së tij, eksploatimi i pasurisë së Kosovës dhe i regjioneve

të tjera për dekada me radhë dhe shkelja e të drejtave kombëtare, veçançërisht të atyre që nuk ishin sllavë, dhanë efekte të kundërta.

Demonstratat e fuqishme të pranverës së vitit 1981 dhe pushka e Tahir Mehës, që i dhanë një grusht të fortë propagandës false të Jugosllavisë, ia çorrën maskën faqe botës dhe e thyen mitin e rrejshëm për pathyeshmërinë e saj.

KULLAT DHE SHTATORET QË MUNGOJNË!

(Në vend të përfundimit)

Po binte një borë e dendur që ma dëshironte shpirti ta shikoja. Për një çast i harrova të gjitha brengat dhe rrëshqita në thëllësinë e mendimeve. Shkova në vitet e rinisë kur miklimi i flokëve të borës më mahniste, më bënte për vete dhe më joshte që të dilja e të shëtitja në natyrë. Vendosa të udhëtoja larg e më larg. Mora makinën dhe gati si në ekstazë po e ngisja nëpër rrugën gjarpërore të shiritit të zi të asfaltit. Në udhëtim e sipër, gropat e asfaltit më sollën në vete. Fillova të mendoja për infrastrukturën që mungon, për ekonominë dhe bujqësinë e pazhvilluar, për papunësinë e të rinjve, për problemet e shkollimit. . . Mendja më shkoi edhe të monumentet që tregojnë lashtësinë tonë, te shtatoret dhe te arkitektura jonë tradicionale e bashkohore që gjenden në gjendje më se të keqe.

Te një kthesë në të majtë e lash asfaltin e mplakur, të cilit koha ia kishte brejtur shtatin dhe mora rrugën krejt gropa në drejtim të Prekazit. M'u kujtuan shokët e burgut si: Afrim Zhitia, Fadil Vata, Bardhyl Mahmuti, Sherif Krasniqi, Nezir Myrta, Sami Kurteshi, Halil Selimi etj. Dhjetëra herë me ta kishim

biseduar se kur ta bëjmë shtetin tonë, kujdes të veçantë do t'u kushtonim dëshmorëve të kombit tonë. Që atëherë ka kaluar shumë kohë. Janë bërë shumë përpjekje. Është bërë edhe luftë, por aspiratat tona ende nuk janë realizuar. Ende nuk e kemi bërë shtetin! Prandaj na mungojnë kullat, na mungojnë shtatorët..., i mungon Prekazit një shirit asfalti, i cili do ta përshkonte atë mes për mes, që nga kulla e Ahmet Delisë e deri të kulla e Adem Jasharit. Më ra në sy Kompleksi i Jasharajve, ku punët për ndërtimin e tij kishin mbetur në fillimin e tyre!

Në hyrje të lagjes së parë të Prekazit, lagjes së Hasanajve, pashë disa fëmijë të cilët po loznin nëpër borë. Ata, as që donin ta dinin për ato që unë po mendoja. Ishin të lumtur. Ua pata zili. Ata si fëmijë duhet të luajnë e të rriten. Ata duhet t'i gëzohen të ardhmes, por që të kenë të ardhme të lumtur e të sigurt, duhet të dinë edhe për të kaluarën. Duhet të dinë për të gjithë ata që për të mirën e tyre kanë dhënë çdo gjë nga vetja e vet, madje edhe jetën.

Arrita te shkolla "Azem Bejta". Rruga, si edhe më parë, si mos më keq. Mungonte edhe uji, që për të gjithë, por për nxënësit në shkollë është më se i nevojshëm. Vazhdova rrugën. Jo shumë larg saj më ranë në sy muret gati të shembura të kullës së Tahir Mehës! Në mungesë të shtetit, sot, Derenicës e Kosovës, i mungojnë kullat e shtatorët e Ahmet Delisë, e Azem Bejtës, Shaqir Smakës, Nak Berishës, Kamer Loshit, Mehmet Delisë, Qerime Radishevës, Shaban Polluzhës, Mehmet Gradicës, Miftar Bajraktarit, Jetullah Rezallës, Shasivar Alisë, Tahir Mehës e plot e plot kulla të tjera, monumente historike e shtatore, nga të cilat këta fëmijë, por edhe të tjerët do të mësonin për të kalurën tonë të lavdishme.

Me kujtohet ishin ditët e sprovës së madhe, ditët kur

djemtë e radhitur në grupët e para të njësitëve të UÇK-së, po bënëin provat e para në teren. Isha me Zymer Mehën, po kalonim pranë varrezave të Mehajve për të parë se si i kishin rregulluar ato. Ishte një pranverë e hershme, Zymeri befasisht me pyeti:

"A thua rruga që e bënë shumë trima tanë e së bashku me ta edhe Tahiri, vetëm me kaq do të përfundojë?" Nga viti 1981 e deri atë kohë kur po bisedoja me Zymerin, sikur kishte kaluar një kohë dhe gjërat nuk po lëviznin me hapin e duhur, apo nuk po i vërenim ne? Ç'ti thonja Zymerit... Diçka po përgaditej, diçka po punohej, mirëpo për t'i thënë atij sikur ishte ca herët... Megjithatë i thashë: "Zymer, diçka është duke lëvizur, me kohë do ta shohim të gjithë, do të ketë punë dhe vend për angazhimin e të gjithë neve!" Edhe sot e gjithë ditën, pra edhe pas luftës ka vend që të angazhohemi që të gjithë, për sëndertimin e shtetit tonë për të cilin shumë dëshmorë tanë e së bashku me ta edhe Tahir Meha u martirizua në altarin e lirisë.

Me rastin e përvjetorit të dhjetë të rëniës së Tahir Mehës në Prekaz, Hamëz Jashari (tani dëshmor i kombit) në një bez me ngjyrë të kuqe, kishte shkruar:

**"LAVDI JETËS DHE VEPRËS SË
TAHIR E NEBIH MEHËS!"**

SHËNIME PËR AUTORIN

Mehmet Bislimi u lind me 24 mars 1958 në fshatin Prekaz i Epërm, në Denicë.

Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, kurse gjimnazin në Skënderaj. Në Univerzitetin e Prishtinës ka studijuar shkencat natyrore.

Në vitin 1981, për shkak të veprimtarisë atdhetare arrestohet dhe dënohet me burg. Pas daljes nga burgu më 1986, veprimtarinë kombëtare e ka vazhduar në LPK, ku ka pasur detyra të ndryshme me përgjegjësi.

Në vitin 1994, për t'i shpëtuar arrestimit, është strehuar në Zvicër, ku vepron dhe jeton me familjen e tij.

Gjatë luftës në Kosovë ishte bartës dhe propogandues i Fondit "Vendlindja Thërret". Gjatë mandatit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ka qenë përfaqësues i përgjithshëm për informim për mërgatën në kuadër të Ministrisë së Financave. Pas luftës, zgjedhet kryetar i degës së PDK-së për Zvicër në dy mandate.

Me krijimtari letrare ka filluar të merret që herët. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën "Bota e re" në Prishtinë, më vonë

në revistën " Alternativa" në Lubjanë dhe në disa numra të gazetës "Rilindja" që botohej në Zvicër. Disa vjet ka shkruar për organin e LPK-së "Zëri i Kosovës" që botohej në Zvicër dhe për të përkohshmen "Rruga jonë" - që dilte në Francë. Në "Zërin e Kosovës" dhe te "Rruga jonë" me vite është paraqitur në këndin e humorit me nofkat "Ngucakeqi" dhe "Gjemb". Kohë pas kohe shkrimet e tij kanë gjetur vend edhe në gazetën "Epoka e re". Veprimtaria e tij letrare përfshin shkrime publicistike, anekdota, humor e poezi si dhe mendime të urta. Deri me tani ka botuar katër libra:

1. "Anekdota popullore dhe satira autoriale" , Prishtinë 2002
2. "Trëndafila maji" – poezi, Prishtinë 2002
3. "Fjalë dhe gurë" – poezi, Prishtinë 2003
- "Këtu i thonë Drenicë", Tahir Meha - Monografi, është libri i tij i katërt

Zvicër, prill 2004

PASQYRA E LËNDËS

Mehmet Bislimi hap portat e biografisë së Tahir Mehës	7
Një borxh i kahmotshëm	12
Në vend të hyrjes	14
Vështrim historik	18
Drenica dhe bijtë e saj	23
Tradita luftarake e familjes Meha	35
Fëmijëria e Tahir Mehës	58
Rinia e Tahir Mehës	60
Tahiri në shërbim ushtarak	65
Martesa e Tahir Mehës	68
Tahiri dhe jeta e tij në kurbet	71
Takimet dhe bisedat e Tahirit me miq e shokë	75
Dashuria e Tahirit për armët	77
Më kujtohet... ..	80
Fisnikëria e Tahir Mehës	82
Tahiri e urrente pushtuesin dhe shërbëtorët e tij	87
Isha student	89
Ekceset e Tahirit me pushtuesin	91
Arrestimi apo kidnapimi i Tahir Mehës në Skënderaj	94

Për të gjallë më nuk dorëzohem	97
Tentimi i dytë për arrestim	100
Jeta prej ilegali	104
Qëndrimi i Tahir Mehës për demonstratat e viti 1981	108
Takimi i fundit	110
Diferencimet ideo-politike në Kosovë	112
Një dialog i ashpër dhe i prerë në kullën e Shaban Polluzhës	114
«Dosja Meha» e zbuluar 19 vite më vonë	119
Milicia e ka nënçmuar Tahirin	123
Kundërthëniet brenda «Dosjes Meha»	127
Në burg me Beqir Mehën	131
Strategjia e Tahir Mehës	133
Një e "fshehtë e hapur" pas 23 viteve	135
Cila është e vërteta e 13 majit 1981	140
Si u vra Tahir Meha	146
Rënie madhështore	148
Varrimi i Tahir dhe Nebih Mehës	150
Tahir Meha hyri në këngë	154
Qëndresë krenare dhe shpresëdhënëse	158
Simbol trimërie e sakrifice për atdhe	160
"Bishti i sëpatës ma shpetoi jetën!"	162
Tahir Meha e theu mitin e "pathyeshmërisë" së jugosllavisë	164
Kullat dhe shtatoret që mungojnë!	166
Shënime për autorin	169